**KOMUNA E PRISHTINËS**

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 1

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**31 maj**, në SHFMU "Zenel Hajdini", duke filluar nga ora **16:00 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale, si dhe lidhur me problematikat e lagjeve.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Alban Zogaj - Nënkryetar i Komunës
3. Vllaznim Osmani - Shef i Kabinetit
4. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
5. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit
6. Ilirik Musliu - Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
7. Florim Krasniqi – Shef i Sektorit për Planifikim

## 3. PROCESVERBALI

ALBAN ZOGAJ/Nënkryetar- Mirëdita, mirë se keni ardhë. Jemi në një proces shumë te rëndësishëm për ju dhe për lagjen tuaj. Siç e dini jemi duke punuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale. Ky proces kërkon angazhim maksimal dhe duhet të jetë gjithëpërfshirës, kjo është edhe qëllimi i takimit tonë sot, që bashkërisht ti bëjmë planet, e jo si në rastet tjera që planet të bëhen nëpër zyre e mandej të imponohen te qytetarët. Jemi duke bërë një seri takimesh me qytetarët e Prishtinës, kemi pasur një takim si ky sot në lagjen “Kalabria”, sot jemi me juve dhe do të vazhdojmë në çdo lagje të Prishtinës në mënyre që se bashku të punojmë në këtë dokument që quhet Plani Zhvillimor Komunal, e që është shumë me rëndësi për zhvillimin e qytetit, në aspektin urban, ekonomik e shoqëror. Kryetari do të na bashkangjitet pak më vonë, andaj ju lutem që sot të jeni të hapur ti jepni idetë, shqetësimet e kërkesat e juaja. Këtu me mua sot është Drejtori i Urbanizmit, shefi i Kabinetit të Kryetarit, janë arkitekte të angazhuar me neve, drejtoresha e Planifikimit, drejtorë të tjerë të Kabinetit, do të mundohemi me u përgjigj ne pyetjet e juaja. Për ato pyetje për të cilat nuk do të kemi përgjigje, do të marrim shënime dhe do të ju kthejmë përgjigje më vonë. Kemi filluar me këtë takim, por ky s’është takimi i fundit, është vetëm fillimi i bashkëpunimit tonë.

FLORIM KRASNIQI- para se të vazhdojmë tutje desha të ju qartësoj që ky takim do të ndahet në dy pjesë, pjesa e parë është pjesa e prezantimit që do të bëhet nga drejtorja e Planifikimit, do të vazhdoj me drejtorin e Urbanizmit, pjesa e dytë pason me një bashkëbisedim (workshop) të përbashkët, dhe krejt në fund vazhdojmë me një bashkëbisedim, pyetje dhe përgjigje, qe ti dëgjojmë nga afër ankesat, kërkesat dhe hallet e juaja.

MIMOZA SYLEJMANI-për ju që nuk me njihni, jam Mimoza Sylejmani- inxhiniere e arkitekturës, tani drejtore në Drejtorinë e Planifikimit. Këtu sot jemi bashkë me nënkryetarin, shefin e Kabinetit, drejtorin e Urbanizmit, e drejtorë të tjerë që kanë ardhur, faleminderit së pari që keni ardhur. Ne sot kemi ardhë që bashkërisht ti ndajmë kërkesat edhe idetë e juaja ,që ti inkorporojmë në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale i cili është një draft tashmë. Jemi në fazën e parë të procesit, jemi duke i trajtuar të gjitha problemet në çdo lagje. Siç tha edhe Florimi më herët së bashku do ta bëjmë edhe një punëtori ku i kemi të printuara të gjitha hartat e lagjes suaj, i kemi të ndara në dy pjesë, Kodra e Trimave 1 ku kemi plan rregullues që është votuar nga Kuvendi Komunal në 2015-tën, që ka sipërfaqe prej 340 hektar dhe e kemi Kodra e Trimave 2 që është në Planin Zhvillimor Urban por që nuk ka plan rregullues dhe shtrihet ne 245 hektar. Të dyja bashkë do të trajtohen ashtu siç e ka përmend edhe kryetari në fushatë që do të rigjenerohet Kodra e Trimave. Këtu ne ilustrimet mbrapa meje qe po i shihni(skica ne projektor) është një pjese e lagjes Kodra e Trimave, qysh mundemi me e trajtu p.sh. e di qe ka problematika shumë te mëdha sidomos rreth pronës, dhe që është brenga juaj kryesorja, por bashkërisht do ti zgjidhim, kështu që ju lutem çka do që keni na thuajeni sot. Me neve sot, si gjithmonë është edhe Kryetari i Asociacionit te Arkitektëve z. Masar Dushi, të cilin e falënderoj që është çdoherë me ne. Pa humbur kohe fjalën ia jap drejtorit te Urbanizmit z. Arbër Sadiki.

ARBËR SADIKI-unë po mundohem te them ato çka nuk u thanë, ato që pak a shumë i takojnë drejtorisë te cilën unë e përfaqësoj, Drejtoria e Urbanizmit. Vizionet e zhvillimeve te qyteteve ndërtohen prej vizioneve politike, i ndërton ai i cili e fiton një gare politike, ne këtë rast është Përparimi, ai i cili i ka shpalos disa vizione, se si don me e pa ai Prishtinën ne vitet sa do ta udhëheq, Drejtoria e Planifikimit i planifikon këto vizione dhe Drejtoria e Urbanizmit i implementon. Ideja pse ne po mundohemi me qene bashkë çdo kund është se qysh ne fazat e para te planifikimit po dojmë me pas plane te implementueshme. Ju e dini se ne lagjen e juaj ka bajagi probleme dhe qëllimi është qe ne sot te bashkëbisedojmë, te ju dëgjojmë juve sepse një plan i mirë mundet me qene i mirë veç në çoftë se i dëgjojmë mirë shfrytëzuesit e atij plani, qe janë njerëzit qe jetojnë ne atë pjese. Ne sot do te mundohemi qe me marr sa ma shumë informacione për lagjen e juaj nga ju, qe për me u kthy mandej me propozime ne mënyrë qe produkti përfundimtar me qene një marrëveshje, një kontratë e përbashkët mes neve qe planifikojmë dhe juve qe keni me i gëzu kualitetet e atij planifikimi. Këto diskutime janë te parapara edhe ne procedurat e planifikimit, por kjo s'është arsyeja pse ne jemi këtu. Ne po dojmë me i marr ato te dhëna te cilat neve na duhen jashtëzakonisht shumë qe ne te ardhmen me e pas një plan te mirëfilltë, çfarë edhe po dojmë me e ba. Faleminderit.

FLORIM KRASNIQI-vazhdojmë me diskutimin e përbashkët, çfarë do shqetësimi ankese apo kërkesë qe keni apo pyetje thuajeni këtu, do te mundohemi qe te përgjigjemi ne çdo pyetje tuajën pastaj se bashku e kemi pjesën e dytë te takimit qe është workshopi.

SHAIP HAJRIZI- banor i lagjes-kam ardhë te ju ne zyre shumë here, edhe kurgjo s'ka qe 4 muaj kurrfarë rregulli, a ka mundësi një stacion te autobusave me e ba, vendi është te stacioni i trenit i moqmi, edhe me i hek kerret prej stacioneve te autobusave edhe inspektorat me punu ma shumë ju rrogat po ju jepni, s'kanë çka lypin kerret me u ndal ne stacione te autobusave.

ARBËR SADIKI- atë çfarë jemi duke e bërë tani është një plan mobiliteti qe funksionon ne tërësi, sepse zgjidhja e vetëm një linjë, është zgjidhje vetëm aty për aty, vetëm për një pjese te lagjes dhe shpesh

ka gjeneru probleme edhe me te mëdhaja, këtu e kemi edhe Ilirikun i cili është ma shumë i kyçun ne pjesën e hartimit te dokumenteve qe lidhen me planifikimin e qytetit, për atë sot ne jemi këtu qe me i mbledh qeto shqetësime te juajat për me i pa si zgjidhje te integrume ne Planin Zhvillimor, a zgjidhje te a tek, vetëm për me i ia ba qejfin dikujt ne nuk i shohim si zgjidhje te shëndetshme për vizionin qe e kemi ne për qytetin. Unë e di qe shpesh ndoshta edhe është vepru kështu, prandaj ne e kemi këtë kualitet te cilin e kemi, sepse janë zgjidh problemet aty për aty pa u integru ne tërësinë e vet. Kjo mënyrë qysh po e mendojmë ne, vizioni jone merr me shumë kohe, por ne jemi te bindun qe kjo është rruga e vetme për me projektu diçka strategjikisht edhe për me pasë një kualitet më të mirë jetese.

Burim ABAZI- banor i lagjes-për me e ba një plan urbanistik këtu ne lagjen tonë është shumë lehte se s'ka bash kurgjo këtu, kështu qe duhet me u nis një plan prej fillimit, e për mu nis prej fillimit duhet qe se pari me u zgjidh çështja e pronave. Ku jemi me pronësi, ne çfarë mënyrë duhet me u zgjidh ky problem. Jemi mbet ku kemi mbet, por se pari çështjen e pronësisë edhe planin me e planifiku prej fillimit.

ARBËR SADIKI-ne e kemi bërë një analize te çështjeve pronësore  këtu, e kemi përpiluar një hartë e cila i përcakton saktë se ku janë pronat komunale, pronat te cilat i menaxhon AKP-ja, pronat privatë edhe pronat te cilat i ka Qeveria. Prapë po kthehem te ajo qe thash me pare, ideja për me planifiku mbi baze reale niset prej trajtimit te pronave, prej tokës, edhe puna e pare qe duhet me u qartësu është kjo, e ne rastin e juaj nuk është shumë e lehte, sepse ju e dini qe një mase jo e vogël e tokave janë toka jo privatë. Ne i kemi studiuar disa shembuj te vendeve tjera, po mundohemi qe me i shiku si mundet me funksionu për realitetin tonë, se si ta bëjmë një partneritet mes njerëzve qe e kanë shfrytëzuar atë toke me vite dhe poseduesit ligjor te asaj toke. Ne jemi tu e mendu një pilot-projekt se nuk ka mundësi kjo me u ba ne komplet lagjen përnjëherë, ka me u gjet një pjese e lagjes ne te cilën dominojnë me shumë hapësira te cilat janë jo privatë dhe ne atë pjese me e zhvillu një projekt e cila e kthen lagjen prej një lagje me banime individuale ne një lagje me ndërtesa shumë banesore qe me i kënaq edhe ata qe jetojnë ne at pjese edhe ata qe prej një prone te paligjshme me u kthy me një prone te ligjshme, edhe pjesa tjetër me u zhvillu me partneritetin publiko privat qe mendon Komuna e Prishtinës me e zhvillu. Këto janë forma te reja qe po zhvillohen ne Prishtinë por qe janë praktikë shumë e thjeshtë e qe vendet me dekada i zhvillojnë. Çdo gjë qe bëhet për here te pare, sado e thjeshtë te është për ne ka me qene  pak ma problematike por jemi te bindun qe ajo është e mundshme. Ne e kemi analizuar shumë, kemi edhe ekspertë qe i kemi angazhuar nga jashtë, Roberti është marre shumë me këtë, ai vjen nga Anglia, e këto praktika ata i kanë zbatuar shumë shpesh, edhe ne po mundohemi me i marr krejt këto praktika te mira, pa ju imponuar juve asgjë por duke i biseduar me juve, duke shkuar lagje për lagje, sepse secila lagje i ka specifikat e veta. Ne jemi ne hulumtim te lagjeve ne te cilat mundemi me e implementu këtë model me se miri edhe ne momentin qe implementohet njëherë mandej vazhdojmë me një lloj cikli ku prej lagjes ne lagje zhvillohet ne mënyrë te njëjte. Ne ndryshe nuk kemi mundësi me pasë hapësira publike ne lagjen e juaj pa i hyre një rigjenerimi te thellë, qe ne momentin qe planifikojmë diçka p.sh me e realizu shumë shpejt dhe shumë lehte.

KASTRIOT JUSUFI-banor i lagjes-lagjja jone ka shumë probleme, një prej tyre është rruga qe është e bllokuar prej parkimit te veturave vend e pa vend nga bizneset qe funksionojnë këtu, ose prej blerësve. Me pëlqeu ideja e Drejtorit te urbanizmit qe këtu te bëhet ndërtim banesor ,është shumë lehte se pjesa me thelle lagjes është krejt fushe, jo si ne lagjen B, por me hapësira te gjelbëruara , me parking te mirë.

FLORIM KRASNIQI-kjo pyetja juaj ndërlidhet me atë çka veç e tha më herët drejtori.

ARBËR SADIKI-vetëm një sqarim për atë qe thatë qe është shumë lehte me ba plan këtu se është fushe, unë nuk kisha me thane qe është lehte nëse i marrim qasjet e gabueshme, se fushe ka qene edhe Mati njëjte por sot ju e dini si duket.

XHAFER CAKOLLI- faleminderit qe keni ardhë për me e vizitu lagjen tonë, ne 2013 është prezentuar një plan zhvillimor, edhe s'është bërë asgjë, ne lagjen tonë mungojnë shkolla, çerdhe, nuk kemi hapësira te gjelbëruara, ne jemi te ngulfatur prej këtyre ndërtimeve me leje e pa leje, këto janë shqetësime qe ne ballafaqohemi çdo dite edhe ne presim qe ju te na jepni një pasqyre me reale për lagjen tonë.

MIMOZA SYLEJMANI- e kam një sqarim, ne këtë fazë ne jemi ne hartim te projektit, ne sot kemi ardhë me diskutu me juve për nevojat e shqetësimet te cilat ju i keni e ne me ju tregu se ne çfarë mënyrë po dojmë me e rigjeneru lagjen e juaj, kjo sot nuk është prezantim, se prezantim është tek kur miratohet ne Kuvendin Komunal dhe iniciohet për diskutim publik.

QERIM SHABANI-banor i lagjes- unë jetoj ne Kodrën e Trimave qe me shumë se 50 vjet, një prej problemeve me te mëdhaja qe e kemi shumica këtu është çështja e pronësisë, te na mundësohet legalizimi i pronës, e dyta, ka qene një projekt për nxemjen qendrore qe e ka përfshi edhe lagjen tonë, por kurrë asgjë nuk është bërë ne at drejtim, edhe e treta e kam propozu qe edhe spitali te hapet te unaza aty.

ARBËR SADIKI-për punën e nxemjes, është e vërtet qe ekziston projekti me Bankën Gjermane për Zhvillim qe përmes paneleve solare me u lidh tri lagjet kryesore te Prishtinës me nxemjen qendrore. Ai projekt është nënshkruar para 1 muaji ose 1 muaj e gjysme dhe është ne zhvillim e sipër. Ne jemi takuar disa here me drejtoren e Planifikimit me komunën e Obiliqit për shkak se parcelat ne te cilat shtrihet ky park solar është ne komunën e Obiliqit, edhe ne gjithë angazhimin tonë e kemi ba qe me i gjetë te gjitha format e kompensimit, qe me na leju neve qe me zhvillu këtë projekt. Kjo marrëveshje është kry, janë nënshkruar krejt kontratat është ne proces e sipër, tash ka me fillu me u implementu. A te pjesa e legalizimit, shumicën e problemeve ne qe i kemi ne legalizim jo veç te lagjja e juaj por edhe ne lagje tjera lidhen pikërisht me pronësinë. Ligji për legalizim nuk lejon me leshu certifikatë te pronës dikujt qe ka ndërtesë ne një toke qe e ka te paqarte pronësinë. Rigjenerimi i lagjes është e vetmja mënyrë për me e ba zgjidhjen e këtyre problemeve qe janë ne lagjen e juaj, e qe janë te ndryshme problemet e pronësisë këtu, ju e dini këtë dhe e vetmja mënyrë është nëse këto probleme i shohim dhe i trajtojmë ne plan me te gjerë.

FATMIR BEQIRI-banor i lagjes-ne rrugën tonë nuk mundesh me kalu prej erës se kanalizimit, kundërmon, ky problem nuk është vetëm tani po është qe moti, edhe askush nuk është marrë me këtë çështje, qe nuk me besoni hajdeni me mua edhe e shihni edhe vet.

ALBAN ZOGAJ- jemi duke u marre me edhe me pjesën e kanalizimit edhe te ujit, qe besa edhe me ndarjen a ujërave atmosferike e atyre fekale. Drejtoria e Investimeve Kapitale, drejtori Krenar Xhaferi është duke u marre me probleme andaj ju lutem adresoni këto kërkesa, na dërgoni me email ose me shkrim edhe na tregoni saktësisht për ku është problemi qe ne me i marr masat menjëherë.

FAHRI HOXHA-banor i lagjes-ne lagjen tonë mungon shumëçka, kemi mungese te fushave sportive, i kemi vetëm ato qe janë nëpër shkolla, kemi mungese te hapësirave te gjelbëruara, mungojnë qendra për te moshuar, është fol diçka për një Qendër sportive ne Bërnicë, ende asgjë.

ARBËR SADIKI- është duke u zhvillu plani për Qendrën Sportive ne Bërnicë, jemi ne diskutim me te njëjtën kompani qe do ta zhvilloje projektin kryesor, fondet janë ndare për këtë projekt, janë vetëm punët teknike qe kanë mbet me u kry, punët me te cilat ne çdo dite merremi. Projekti është, një projekt

gjigand qe kërkon kohe, dhe ajo çka është e sigurt është qe, është tu shku ne rrugën e duhur për te cilën edhe ka premtu kryetari, dhe është analizu ne kuptimin e termave urban, ku atje planifikohet me kalu unaza, është edhe pjesa e pishinës, d.m.th. gjithë ajo pjese do te zhvillohet për sporte dhe rekreativitet. A për atë qe thatë qe keni vetëm salla nëpër shkolla, desha te ju jap një informacion se nëpër bote edhe ne po dojmë atë praktike me e zhvillu edhe këtu, ku sallat e shkollave shfrytëzohen, te projektohen me hyrje te veçanta , me një pjese te gardërobave te veçanta qe me mujt me u përdor edhe prej komunitetit. Ne jemi duke punu edhe me departamente tjera edhe me drejtor te shkollave, me të gjithë ata qe menaxhojnë me këto asete me kuptu qe këto janë pjese e komunitetit dhe duhet me u shfrytëzu prej komunitetit.

ISA ILAZI-jemi 26 pronare ne një parcele, ne nuk mundemi as me e shite as me e përkthy, as me ndërtu, ne planin e mëhershëm Unaza , rruga kalon kah prona jone,

ARBËR SADIKI- probleme te kësaj natyre kemi shumë, e kam fjalën për problemin me pjesën e gjelbërimit qe as nuk shpronësohet as nuk ipet leja e ndërtimit, edhe ti me njëfarë mënyrë je peng. Kjo është ajo çka ne po mundohemi me e ba, qe ne Hartat Zonale qe do ti zhvillojmë tash e tutje, me e parapa saktë qe pjesët qe merren për gjelbërim me e pa mundësinë qe brenda atij blloku ku mundet me u ba kompensimi me te njëjtin koeficient ndërtimi. Ne po mundohemi me i kalkulu ne atë mënyrë qe këto hapësira qe janë për publik mos me i tejkalu 20% e tërësisë se bllokut qe mandej zgjidhja mos me u ba parciale por me gjithë bllokun, dhe të gjithë me e pasë te njëjtin benefit prej kësaj.

ISA ILAZI- përballe parcelës tonë është pjesa qe është e Komunës, pse nuk e kanë ba ne plan qe rruga me kalu andej, po ka prona jone.

ARBËR SADIKI-ne këtu nuk mundemi me ju dhënë përgjigje konkrete për raste konkrete, këtu jemi me ju tregu parimet se qysh kanë me u trajtu këto çështje, te jesh i sigurt qe edhe ajo pjesa e juaj ka me u trajtu me krejt mundësitë. Ne këto raste si rastin e juaj qe jeni shumë pronare, ne javët ne vazhdim ulemi dhe e diskutojmë e caktojmë një takim edhe e shohim se si mundemi me e trajtu.

SHAIP HAJRIZI- banor i lagjes qe 70 vite, faleminderit shumë për iniciativën për me ardhë ne vizite ne lagjen tonë, këtu kemi shumë probleme, kemi mungese te shkollave, te parqeve, çerdheve, kemi mungese te linjave te autobusave qe duhet me u shtu, kemi problem me kanalizim, me rruge. Këto probleme i kemi paraqit edhe te Kryetari gjatë fushatës dhe kemi besim te madh qe do te realizohen. Unë i kam 2 çështje qe kisha me i prek përveç këtyre qe i ceka me herët, kur do te filloje procesi i legalizimit dhe sa do te zgjasë, se pa u kry ky proces Plani nuk mundet me u realizu, edhe a e ka parapa Komuna nxemjen për Kodrën e Trimave.

ARBËR SADIKI- për panelet solare e thash qe një prej lagjeve qe është e parapame është lagjja e juaj, a për procesin, procesi ka fillu prej sot, ky diskutimi qe po e bëjmë sot është pjese e këtij procesi, ne po mundohemi qe përmes këtij transformimi urbanistik me e zgjidh edhe problemet e pronave. Rigjenerimi e ka këtë qellim me i zgjidh përmes planifikimit edhe probleme tjera. Ne duhet me hy lagje për lagje me e pa se cila është përqindja e pronave qe janë me probleme , cilat janë prona pa probleme edhe me pa propozimi konkret cili kish me qene ,qe me i zgjidh këto probleme përmes një rigjenerimi urban, ndryshe nuk ka zgjidhje.

BURIM AVDIU- banor i lagjes- Kodra e Trimave 1 a është ne plan zhvillimor.

MIMOZA SYLEJMANI- një plan rregullues ekziston por Harta Zonale e përfshin gjithë qytetin, s'ka me pas me ndarje, kur bëhet planifikimi Harta Zonale ka me qene e tërësishme e a rritet koeficienti a jo unë nuk mundem tani me te dhanë përgjigje, se është një grup i madh qe është duke punuar për hartimin e këtij projekti, e kur te vijmë ne atë pike ne prapë kemi me pas takime e diskutime, për

momentin po dua si informatë me ju dhanë qe Harta Zonale e përfshin gjithë Prishtinën po ashtu edhe fshatrat, siç e ka thënë edhe Kryetari ne fushatë qe do te bëhet ndërlidhja e zonës urbane me zonën rurale. Plane rregulluese te hollësishme ka me pas vetëm ne raste specifike kur dojmë me e trajtu një lagje p.sh.

VEDAT HAVOLLI-faleminderit për vizitën qe po i bëni lagjes tonë, ju kisha propozu qe me pas kujdes me koeficientin ne lagjen tonë, qe mos me shkatërru si pjesët e tjera te Prishtinës, edhe ju e dini qe Kodrën e Trimave e keni lënë shumë mbrapa, këtu ka nevoje për gjelbërim, ka nevoje për shkolla, për fusha sportive, nuk pajtohem qe u tha ma herët qe me u përdor sallat e shkollave, kur mundemi me i pas sallat tona.

FAHRIJE BEHA-banore e lagjes- kemi problem me kanalizim, sa here qe bie shi ka vërshime dhe krejt uji i kanalizimit na hyn ne shpi, ky problem është qe sa dhe ende nuk është zgjidh.

ILIRIK MUSLIU-ne jemi tu punu ne mënyrë paralele, ne te njëjtën kohe për rigjenerimin e lagjes te juaj dhe Planit Zhvillimor dhe Hartës Zonale, por normal qe këto problemet e përditshmërisë nuk mundemi me i neglizhu, pjesa e kanalizimit është çështje shumë urgjente qe duhet me u intervenu menjëherë, dhe ne e marrim përsipër kërkesën tende qe sot.

ELHAME KRASNIQI- nuk jam banore e lagjes por e kam një prone te rruga Koto Hoci, me herët s'ka qene e urbanizume , tani është e deshta me ju pyet a është ne plan ajo pjese a jo.

FLORIM KRASNIQI- unë ju kisha propozu qe ju me ardhë ne zyrën për Planifikimit ne Komunën e Re, te martën dhe te enjten ne i kemi takimet me pale, edhe e shohim saktësisht për ku bëhet fjale.

ZENEL VELIU-banor i lagjes rr. 27 Nëntori, ne kemi shumë telashe këtu, rrugën e kemi te paasfaltuar, por problemin kryesor e kemi çështjen e pronësisë, unë jetoj qe 50 vjet këtu edhe ende se kam legalizu pronën time.

EMINE HAXHOLLI- faleminderit qe keni ardhë për vizite, e para një ankese për organizimin, ne asgjë mbrapa nuk kemi ndëgju shkaku i zërimit, përpara se me fillu ju me Planin ju kisha lute qe te zgjidhni problemin e pronave, se pari mendoj qe prona duhet me pas titullar, ne Kodrën e Trimave nuk ka titullar te pronave. Ne kemi probleme shumë, me ujin me kanalizimin, ne rrugën tonë shiu i pare qe bjen na merr uji, edhe kurrë as edhe njëherë nuk është ba asnjë kompensim, edhe tatimi ne prone duhet te ndahet nuk mund te paguajmë njëjte si neve qe na merr uji njëjte si ai p.sh te Xhamia e Llapit qe sa ka at problem, ka shumë kërkesa, te asfaltohen rrugët dhe te lidhen fshatrat me transport, a si urgjencë ju kisha lut me u marr me çështjen e kanalizimeve.

ARBËR SADIKI-vazhdimisht po përmendet çështja e pronave, ne gjithë angazhimin tonë jemi duke e ba qe me u zgjidh problemet me pronat përmes mekanizmave te cilat janë ne dorën tonë, nëse mendoni qe problemet pronësore mundeni me i zgjidh ne kuptimin e titullarit te pronës atë ndarje Komuna nuk e ka, nuk ia jep ligji, për atë ne e kemi pa si mundësi qe përmes këtyre mekanizmave qe lidhen me planifikimin me e ba një zgjidhje gjithëpërfshirëse. Ne jemi këtu për te ju thane atë çka është e mundshme edhe çka është ne dorën e Komunës se Prishtinës

JETULLAH BEQIRI-banor i lagjes- ne sot po e qesim kërkesat tona, qe ju me i realizu për 4 vjet ose nëse nuk i realizoni do te na keni kundërshtarin me te madh. Unë vij prej komunitetit artistik, u thane shumica e shqetësimeve tona, po ne kemi mungese shollave, s'kemi çerdhe, s'kemi as edhe një qendër kulturore ne lagjen tonë, Kodra e Trimave i ka 70 mije banore. Një Qendër Kulturore është nis edhe është ndërpre puna, ata qe i ndërprejnë këto projekte duhet ne Gjyq me i qu. Për 20 vjet janë ndërru Kryetar e qeveri e mos me kanë ne gjendje 2 kacija beton me i qit e me e ndreq një çerdhe për fëmijë, ata njerëz kanë ba krim. Prishtina as edhe një vend nuk e ka për me e ba aktivitetin e vet kulturor.

Është mjerim elementaret mos me i pas, është momenti i fundit tani, te ju i kemi shpresat , për atë edhe votën ju kemi dhanë, faleminderit.

ARBËR SADIKI-plotësisht pajtohem me kërkesat e tua, edhe absolutisht jam dakord qe krejt çka i përmende duhet me i pas çdo komunitet jo vetëm ju këtu, por ne jemi me një pozicion qe po luftojmë se qysh munden me u ba krejt këto përmes rrugëve ligjore. Po ju jap një informatë shumë bazike, as edhe një fond, as prej ministrive tona as prej donacioneve nuk ipen pa qene te zgjidhura problemet juridiko-pronësore. Neve vazhdimisht nuk mundemi me i realizu edhe ato pak mjete qe here pas here i kemi për shkak te problemeve te lokacioneve. Rruga për me mujt me pas investime është me i zgjidh problemet edhe me pronat. E përmende Qendrën kulturore, nuk dua me i jep kredi vetes por ajo Qendër kulturore është nis prej meje , bashkë me studentat e mi e kemi analizu edhe propozu edhe e kemi pas përkrahjen e qeverisjes se atëhershme, qe nëse bahet investimi i pare kulturor bashkë me universitetin ku punoj unë, do te bëhet ne Kodrën e Trimave, edhe e kemi projektuar pa pagese at projekt, me shumë dëshirë e me shumë vullnet për me ndodh. Ka shku ne prokurim publik sipas procedurave edhe kanë ardhë oferta me gjysmën e çmimit te cilin na e kemi planifiku. Është nis puna edhe është ndërpre për shkak te ofertës me çmimin me te ulët. Rrugët për me u zgjidh problemet janë te precizuara me ligj me rregulla, edhe ne po mundohemi me e gjet rrugën qe me punu me ato kompetenca te cilat ne i kemi ne dore.

ISLAM ISLAMI-e kam një kërkesë, është një takse ne transaksion qe paguhet vetëm ne Prishtinë, ne asnjë qytet tjetër nuk paguhet vetëm këtu po.

ALBAN ZOGAJ- jemi marre me këtë teme dhe ka qene edhe propozim ne Kuvendin Komunal qe disa here me rradhe, qe te hiqet taksa, edhe ne në parim jemi dakord qe te hiqet, por vetëm jemi duke bërë disa analiza financiare qe me e pa çfarë efekti jep heqja e saj. Pas përfundimit te këtyre analizave besoj qe do te vijmë ne përfundim qe me e hek.

BESIM GERGURI- përshëndetje, vetëm një pyetje e kam, sa zgjat afati i legalizimi për aplikim.

ARBËR SADIKI- për punën e legalizimit 4 Shtatori është afati i fundit për aplikim, kështu qe unë ju kisha thane qe aplikoni, gjatë procedurës ekziston mundësia qe në çoftë se ti ndryshon diçka ne pronësi , ajo mundet me u plotësu mandej.

BEDRI KRASNIQI- 12 vite ka qeveris LDK-ja e as edhe një investim nuk e ka bërë ne Kodrën e Trimave, ka uzurpime, ku ka qene Komuna, pse s'ka ndërmarr asgjë, na jemi ne gjendje shumë te vështirë, as nuk kemi rruge , as kanalizime, as çerdhe as parqe, asnjë problem qe ballafaqohemi ne, nuk është zgjidh. Urgjent masa me ndërmarr.

MEHEDIN DINI-banor i lagjes, rr. Qeta e Llapit, është rruge gati 20 metra krejt balte është ju kisha lut qe ajo rruge te ndreqet, plus edhe kabllot e rrymës qe janë shumë rrezik aty, ju kisha lute qe te ndërmerrni diçka se qe sa vjet asgjë.

NEXHMI LLUMNICA- kemi problem me kabllot e rrymës, qe janë shumë ne rrezik për lagjen tonë.

ISMET BEQIRI- banor i lagjes (ish Kryetar i Komunës)- ju përshëndes të gjithëve, zoti Kryetar, përfaqësues, e juve pjesëmarrës, faleminderit shumë qe keni ardhë. Ne këtu jemi banoret e kësaj lagje, dikush jeton këtu qe 50 vite, dikush edhe ma shumë. Lagjja jone ka kaluar nëpër disa faza, faza e pasluftës ka qene faza emergjente, ne Kodrën e Trimave pas lufte janë se paku 70 rruge te shtruara. Edhe unë kam qene Kryetar, ka qene Isa ka qene Shpendi, tani është Përparimi për ne është me rëndësi me i realizu projektet. Faza emergjente ka kalu ne Kodrën e Trimave, edhe ne kohë e Isës është ba shkolla e re, është ba Qendra e mjekësisë familjare, është ba Qendra për punë sociale. Ajo çka ju kisha lutë juve është qe krejt këto projekte qe i keni ne plan ti realizoni, ne jemi lagje qe kemi sakrifikuar

shumë, kemi nevoje për gjelbërim, qendra rekreative, për një qendër kulturore, kemi nevoje për çerdhe edhe ju kisha lute qe koeficienti për lagjen tonë te jete me i larte, sepse është absurde qe lagjja jone me pas një koeficient te ulet. Unë e di qe zoti Rama është arkitekt, ka projekte, jo rastësisht nuk ka fituar, por kjo lagje e meriton me u trajtu me dinjitet dhe është koha e fundit për ta marre at qe e meriton. Faleminderit shumë.

ELMI DILI-banor i lagjes rr. 27 Nëntori, jemi gati 60 shtëpi ujë nuk kemi, kanalizimin e kemi nëpër oborre, para një jave u blloku qe kqyri duart qysh mu kanë ba, askush nuk u marre me neve, për kanalizim e kemi punën katastrofe.

ZAHIR HAJDINI- banor i lagjes- ardhja juaj këtu është me vonesë, mënyra qysh keni ardhë është gabim, nuk ka Plan Zhvillimor as zgjidhje te problemeve të pronës, edhe Kryetar e kam një pyetje Kodra e Trimave me 1500 vota diference pse nuk ka përfaqësues ne ndërmarrjet publike.

ALBAN ZOGAJ-me bindje e plote po ju them qe Kodra e Trimave është ne fokus te Kryetarit Rama, dhe me vete faktin qe ne jemi këtu me juve, qe po bashkëbisedojmë, po marrim pyetje e ankesa e ide tregon shumë, edhe atë menjëherë pas 4 muajve qe e kemi marre mandatin. E dyta për pyetjen e përfaqësimit ne Ndërmarrje Publike edhe pse është teme tjetër po du me tu përgjigj. Ne Ndërmarrje Publike përfaqësohen asamblistët e Kuvendit Komunal. Ne 10 Ndërmarrjet Publike ne i kemi dërguar aksionaret tonë qe janë aksionare te Kuvendit Komunal, edhe këtu po shoh asambleista qe janë te përfaqësuar ne ndërmarrje publike, qe p.sh Donjeta është këtu, Dasmori, drejtorat zgjidhen me konkurse publike, te gjitha do ta marrin kohë e vet.

FADIL ALIU-banor i lagjes- përshëndetje jam Fadil Aliu i përkas kësaj lagje edhe ballafaqohem me te njëjtat probleme sikur secili prej jush. Është e vërtetë qe Kryetari Rama gjatë fushatës e ka pasur moton ''Prishtina për të gjithë" nuk është  qe vetëm Kodra e Trimave e meriton qe me ja dhanë atë respektin qe e meriton, por me te vërtetë Kryetari Rama e ka at qasjen qe me e ba një barazi mes gjitha lagjeve, prandaj e kam një sugjerim për juve sot, ekipa është këtu andaj ju kisha lute qe me e shfrytëzu ekipën sot , me propozimet konkrete te cilat na prekin ,mos te dalim jashtë temave se kemi me pas kohe edhe ato me i prek, e ne baze te kërkesave e ankesave e ideve me zhvillu projektin për te cilin janë këtu.

ARBËR SADIKI-po lidhem me atë çka tha Fadili, ne sot këtu jemi për me bashkëbisedu për problemet qe lidhen me PZHK-ne dhe me Hartën Zonale sepse ato te dhëna teknike neve na duhen qe me i pas këto Plane me te prekshme dhe me te realizueshme.

MUSTAFE GASHI-banor i lagjes a ka me pas ndërtim te larte ne lagjen tonë.

SHABAN KRASNIQI-banor i lagjes- jemi qe 60 vite këtu a ka me pas legalizim te pronave për ata qe veç i kanë ndërtuar shtëpitë ne ato prona.

ARBËR SADIKI- arsyeja pse jemi sot këtu është pikërisht kjo teme.

KRYETARI RAMA- ju kërkoj falje qe nuk isha këtu prej fillimit për shkak te agjendës , i kemi nënshkruar një numër te madh te kontratave për zhvillimin e Komunës se Prishtinës, zhvillimin e gjelbër ne Kryeministri, te gjitha komunat ishim atje. Besoj qe veç jeni informuar nga ekipa, ideja e takimit me qytetaret është pikërisht për te punuar se bashku për transformimin e te gjitha zonave te Prishtinës ku jetojmë. Kodrën e Trimave e kemi pas dhe e kemi prioritet për arsye te problemeve te ndryshme nder ato kyçe është edhe aspekti i pronësisë, me shumë se 70% e kanë këtë problem. Ne kemi ardhë me bisedu me ju, edhe me ju tregu qe ky proces qe e kemi fillu nuk përfundon këtu, ky është vetëm fillimi, dhe jeni te mirëseardhur me qene pjese e këtij procesi edhe ne te ardhmen, nëpërmjet fuqizimit te bashkësive lokale tash, e kemi afruar Komunën e Prishtinës me afër qytetareve. Përmes Planit

Zhvillimor dhe Hartave Zonale vetëm kemi hy ne një proces te madh, por gjatë kësaj paralel ne duhet me zgjidh edhe një numër te madh te problemeve te vogla. Kemi biseduar edhe për vendkalime edhe për rethrrotullime, për te gjitha këto gjëra te vogla, fondet i kemi por ne duam me i zgjidh bashkë me komunitetin, se kush ma mirë se ju e din se çfarë i nevojitet Kodrës se Trimave. Jemi duke punuar edhe me institucione ndërkombëtare me Bankën Botërore, edhe me ekipet tona përbrenda Komunës por edhe me specialist nga jashtë për me na ndihmu gjatë këtij procesi, kështu qe ju falënderoj shumë qe jeni këtu sot me neve.

MUSTAFE GASHI-banor i lagjes a ka me pas ndërtim te larte ne lagjen tonë.

KRYETARI- po për te krijuar hapësira te gjelbëruara, shkolla çerdhe duhet te ngritemi lart qe te kemi këto hapësira qe na duhen.

SHABAN KRASNIQI-banor i lagjes- jemi qe 60 vite këtu a ka me pas legalizim te pronave për ata qe veç i kanë ndërtuar shtëpitë ne ato prona.

KRYEATRI- nëpërmes rigjenerimit urban ne tani jemi duke e zgjidh edhe problemin e pronësisë, p.sh nëse ju e keni ndërtuar shtëpinë qe 40,50 apo 60 vjet ne prone komunale atëherë procesi duhet me qene qe ajo prone me u legalizu përmes rigjenerimit, pra heket, zhvillohet por ne vendin ku je te ri është e jotja, kjo është ideja, jo me kiju probleme por me zgjidh probleme.

ARIAN MUSTAFA- magjistër i shkencave- dhe banor i lagjes, faleminderit qe keni ardhë, po e shoh qe e keni marre me seriozitet këtë punë, e problemet e kësaj lagje për me i zgjidh, unë vullnetarisht ju ofroj idetë, këshillat e sugjerimet për problemet e kësaj lagje. A e keni caktuar zonën ku do te filloni me projektin.

KRYETARI- jemi ne proces te punës.

ARIAN MUSTAFA- unë te gjitha i ndëgjova me vëmendje çka u tha deri me tani. Me përpara kjo pjese ka qene me e zhvillume ekonomikisht, ka pas dyqane ka pas biznese e tani për shkak te shumë kushteve pjesa me e madhe e biznese kanë ndërru lokacion p.sh ne Fushe Kosove. Mendoj qe kish me qene mirë me u kthy Stacioni i Autobusave qysh ka qene, pazari i kerreve, me pas ma shumë biznese.

KRYETARI- ne çdo proces te rigjenerimit baze është krijimi i vlerave shoqërore, krijimi i hapësirave te gjelbëra, rekreative, çerdhe, shkolla, parkingje, qendra mjekësore, jemi tu e planifiku ne Bërnicën e Poshtme ne shërbim te Kodrës se Trimave se është shumë afër, Kampusin e Sporteve me te gjitha mundësitë për zhvillimet sportive, zone komerciale gjithashtu, me këto elemente te rigjenerimit ne po mundohemi me e ndihmu Kodrën e Trimave, se procesi i regjenerimit është shumë i gjatë, ideja është qe me ba zgjidhje paralele te nevojave bashkë me juve, bashkë ta ndërtojmë.

SKENDER HALIMI- banor i lagjes- faleminderit qe keni ardhë , kësaj lagje i mungon shumëçka, i folëm deri tani te gjitha , por kisha pas dëshirë qe ne Planin e ardhshëm lagjja jone te mos bëhet si disa shembuj te keq te ndërtimit, kemi modele mjaft për te keq, po e them këtë edhe si gjeograf qe jam, jo vetëm si banor i lagjes, edhe si do te bëhet kompensimi.

KRYETARI- e kam përmend shumë aspektin e vlerës shoqërore, çka d.m.th-ne vlere shoqërore, nëse ne jetojmë ne zona ku kemi qasje ne hapësira te gjelbëra, ndihemi te sigurt me punu aty afër, ka shkolla, ka qendra për te moshuar, kemi zona sportive, kemi ku me parku kerrin, te gjitha këto kalkulohen si një zone e mirë për me jetu, mundësia për me lëvizë prej kësaj zone ne zonën tjetër lehtësisht, krejt këto janë zone e zhvilluar urbane. Secila zone është unike ne veti, secila prej tyne paraqet diçka te veçante ne vete, ne duhet me e njoftë e hulumtu çdo detaj qe e karakterizon secilën

zone ne veçanti. Por te ju e kemi një raste shumë te mirë qe me i qit ne pah karakteristikat e Kodrës se Trimave përmes regjenerimit.

BANOR I LAGJES- këtu probleme ne lagjen tonë ka shumë, po kisha pas dëshirë qe kjo lagje me u trajtu si tanësi, me krejt problemet e veta qe i ka, siç u tha edhe me herët këtu ka pas edhe biznese te shumta por shkaku i kushteve është dashtë me ndërru lokacion qe është e dëmshme edhe për Komunën e Prishtinës por ne rradhë te pare për neve qe jetojmë këtu.

KRYETARI-Plani Zhvillimor Komunal shihet si tanësi edhe ashtu dizajnohet e dimë qe Prishtina i ka 350 mije banore, ky numër pritet te rritet, e dimë qe kemi bukuri natyrore te malësisë se Gollakut e Llapit e ato janë si zhvillim i te ardhmes, për me e ndalu edhe migrimin, se kemi shkolla qe i kemi ndërtuar e qe janë thatë, kemi potencial te madh jo vetëm ne zonën urbane, këtë balanc e bëjmë duke analizuar krejt qytetin, nevojat e qytetareve edhe duke i pru ne pah elementet unike te zonës.

BANOR I LAGJES- po me intereson si do te bahet kompensimi, a me metër katror se ka njëri qe e ka ndërtu shtëpinë p.sh edhe e ka 200 ose 300 metra katrore tash a llogaritet edhe shtëpia, shpenzimet e shtëpisë apo vetëm sa ari është prona.

KRYETARI- ka probleme te shumta edhe te ndryshme te cilat duhet me i zgjidh gjatë procesit, duhet me i hi punës për me e pa qysh mundemi me i zgjidh ne mënyrën ma fer te mundur. Po e marr shembull p.sh ne Mal te Zi, ke zone qe e ka çmimin nga 10 mije euro për metrin katror edhe ke zonën qe është 200 metra me larg dhe është 1 mije euro metri katror. Tash çka pyesim çka e ka ngrit vlerën e asaj metre katror, funksionet qe i ofron ajo zone, mënyra e jetës, mundësitë e ndryshme e ngrisin vlerën, nuk është krejt te metri katror, ne shumë zona metri katror e mbyt çmimin, si ne rrugën B p.sh pjesën shtese çka e ka ndërtu e ka devalvu krejt zonën. Nuk duhet me e kqyr me metër katror, por duhet me e kqyr çfarë vlere po ndërton, do ta shihni kur te bëhet zhvillimi , nëse ne arrijmë përmes rigjenerimit urban me e ngrite vlerën e secilës shtëpi secilës familje ne jemi fitues, edhe ai është synimi, kur e ngritim nivelin e jetesës, ajo automatikisht e ngrit vlerën e zonës.

RRAHMAN HOTI- banor i lagjes- prej te gjitha lagjeve, lagja jone është me e diskriminuara, lagjja jone veç e ka historinë e vet, unë kërkoj nga ju qe me ja kthy dinjitetin kësaj zone,1) te klasifikohen zonat edhe sipas zonave te rritet koeficienti, 2) pronat e kontestuara t'ju jepni mundësinë qe te kalojnë ne pronësi te banoreve qe i shfrytëzojnë qe sa vite edhe 3) te ndërtohet një qendër për sportet luftarake, Kodra e Trimave i ka dhënë shumë sportit luftarak dhe mendojmë se e meritojmë një qendër te tille.

ELFIJE THAQI-banore e lagjes, ne lagjen tonë ka mungese te çerdheve, rrugët janë tmerr, një shi me ra na merr krejtve, nuk kemi park, mungon transporti qe na lidh me qendrën, edhe duhet te legalizohen pronat.

QAMIL HAJDINI- zoti Kryetar e kam vetëm një kërkesë qe me i jep prioritet Kodrës se Trimave, ngulfatja është këtu ne këtë zone, si për ndërtim si për gjelbërim, se është hapësirë shumë e madhe.

KRYETARI- procesi i rigjenerimit te kryeqytetit është prioritet, ne rigjenerim është Kodra e Trimave, Kolovica edhe Prishtina e Vjetër, këto zona janë prioritet, fillojmë prej Kodrën e Trimave se ne këto zona është densiteti i madh a urbanizmi katastrofe, ky është qëllimi i regjenerimit.

KRYEATRI- edhe për zonjën, zgjidhjen veç e përmenda me herët, është krejt ky procesi i regjenerimit, ne te cilin jemi duke punuar, ku bëhet edhe legalizimi i pronave, ti e merr p.sh ne ndërtim te ri me letra, je pronare edhe krijimi i hapësirave tjera krejt kjo është qëllimi me i kriju ato qe mungojnë ne këtë lagje, si pjese e kësaj bëhet edhe zhvillimi edhe ndërlidhja me zonat e tjera.

ISMET BEQIRI- kryetar faleminderit qe jeni këtu e na ndëgjuat, ne krejt shpresat i kemi te ti, edhe po shpresojmë qe ke me e trajtu këtë lagje ne mënyrën më të mirë te mundshme, se me te vërtetë është lagje e veçante kështu qe edhe nëse vonohemi pak, me mirë një lagje me plan se një lagje pa plan. Kjo lagje e meriton me u trajtu me dinjitet, kjo lagje i ka dhënë shumë këtij vendi, unë besoj qe punën qe e keni filluar do ta realizoni ne mënyrën më të mirë, edhe koeficientin me e ngrite do te krijoni mundësi me shumë për këtë lagje, faleminderit.

KRYETARI- ju faleminderit juve.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | FEIM SALIHU | 044/666-477 | [illegible] |
| 2 | Dibran REXHA | 044-247-564 | [illegible] |
| 3 | Ukshin Vllasa | 044-207 112 | [illegible] |
| 4 | | | |
| 5 | | | |
| 6 | | | |
| 7 | Thaçi Alem | 044/63173 | [illegible] |
| 8 | | | |
| 9 | Muhamet RAMA | 044.933191 | [illegible] |
| 10 | [illegible] Vitia | ~~[illegible]~~ | [illegible] |
| 11 | Vigan Vitija | | [illegible] |
| 12 | [illegible] | | [illegible] |
| 13 | | | [illegible] |
| 14 | [illegible] | | [illegible] |
| 15 | BEDRI KOSUMI | 045326509 | [illegible] |
| 16 | Muhamet Veliu | 044-554-868 | [illegible] |
| 17 | | | |
| 18 | Mrsar Dashi | 049-505-256 | [illegible] |
| 19 | [illegible] HAXAJ | | [illegible] |
| 20 | | | |
| 21 | HAFIZ [illegible] | | [illegible] |
| 22 | BURIM AVDIU | 044 358-121 | [illegible] |
| 23 | Fatmir Beqiri | | [illegible] |
| 24 | Ariamita Krasniqi | 045-637-923 | [illegible] |
| 25 | ILIR MURSELI | | [illegible] |
| 26 | SHPRIN BALA | 049.441474 | [illegible] |
| 27 | VAHIR KELMENDI | 044/457-580 | [illegible] |
| 28 | VIRTYT KRASNIQI | 044/121-146 | [illegible] |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ARMEND VITIJA | 044-394-289 | [illegible] |
| 2 | Fikret Havolli | 044 555 666 | [illegible] |
| 3 | Adem Sejdiu [illegible] | 044 890 140 | [illegible] |
| 4 | Kamadan Bulliqi | 049 304 983 | [illegible] |
| 5 | Vehbi[illegible] Begoli[illegible] | 049.838-838 | [illegible] |
| 6 | AVDYL BEGOLLI | 044.238 756 | [illegible] |
| 7 | SKENDER HALIMI | 044-421-172 | [illegible] |
| 8 | Vesa Vitija | 045-569-804 | [illegible] |
| 9 | [illegible] BILALLI | 045-532 00[illegible] | [illegible] |
| 10 | Abdyl Kadriu | 044/124-184 | [illegible] |
| 11 | Mehamedin vitija | 045 636 811 | [illegible] |
| 12 | GANIMETE EJUPI | 044 280 700 | [illegible] |
| 13 | Roland Peroj | 049 296 444 | [illegible] |
| 14 | KASTRIOT KOSUMI | 045 212259 | [illegible] |
| 15 | Egzon Pacolli | 049 606 432 | [illegible] |
| 16 | SOKOL KRASNIQI | | [illegible] |
| 17 | Arian Mustafa | | [illegible] |
| 18 | BEKIM G[illegible] | | [illegible] |
| 19 | [illegible] Bajmi | | [illegible] |
| 20 | RRUSTEM KRAZI | 044-114-125 | [illegible] |
| 21 | ZAHIR JETULLAHI | | [illegible] |
| 22 | MURAT DUSHULLOVCI | | [illegible] |
| 23 | Gani Ahmeti | 044 226 075 | [illegible] |
| 24 | Jeneta Bajraktari | 044 877 307 | [illegible] |
| 25 | Shadahir Begolli | 044 135 679 | [illegible] |
| 26 | Krahman Veliu | | [illegible] |
| 27 | Ahmet Probroza | 044-762 999 | [illegible] |
| 28 | Arim Mehjolli | | [illegible] |
| 29 | Alban Begu | | |
| 30 | Bedri Krasniqi | | [illegible] |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Feim Salihu | 044/666-447 | |
| 2 | Dibran Rexha | 044-247-564 | |
| 3 | Ukshin Vllasa | 044-207 112 | |
| 4 | | | |
| 5 | | | |
| 6 | | | |
| 7 | Thaçi Alen | 044/63173 | |
| 8 | | | |
| 9 | Muhamet Ramu | 044.933191 | |
| 10 | [illegible] Vitia | ~~[illegible]~~ | |
| 11 | Vigan Vitija | | |
| 12 | Hasim Vitija | | |
| 13 | | | |
| 14 | [illegible] | | |
| 15 | Bedri Kosumi | 045326509 | |
| 16 | Muhamet Veliu | 044-554-868 | |
| 17 | | | |
| 18 | Musar Dushi | 049-505-256 | |
| 19 | Rexhep Hyseni | | |
| 20 | | | |
| 21 | Hafiz Zeqiri | | |
| 22 | Burim Avdiu | 044 358-121 | |
| 23 | Fatmir Beqiri | | |
| 24 | Arianita Krasniqi | 045-637-923 | |
| 25 | Ilir Murseli | | |
| 26 | Shaban Bala | 044.441474 | |
| 27 | Vahir Kelani | 044/457-580 | |
| 28 | Virtyt Krasniqi | 044/121-146 | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Arian Sarraçi | 049 147-933 | [illegible] |
| 2 | Elvriedina Beka | – " – | [illegible] |
| 3 | Qamil Hajrizi | 044-114-118 | [illegible] |
| 4 | Elhame Nila | 049-841-110 | [illegible] |
| 5 | Agim Bullija | | [illegible] |
| 6 | KADRI STATOVCI | | [illegible] |
| 7 | LJOSA VITIJA | 045-650-478 | [illegible] |
| 8 | Bajram Vitija | | [illegible] |
| 9 | ZENEL VELIU | 044-810-591 | [illegible] |
| 10 | Anda Saliha | | [illegible] |
| 11 | Shaban Krasniqi | 044 425 491 | [illegible] |
| 12 | DASHON QVERISKI | | [illegible] |
| 13 | MUSTAFA GASHI | 044-197-046 | [illegible] |
| 14 | NEXHMI HADRIZI | 044 251 834 | [illegible] |
| 15 | [illegible] | | |
| 16 | BAHTIR MURTEZI | 044/233-110 | [illegible] |
| 17 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 18 | ISLAM ISLAMI | 044 112 133 | [illegible] |
| 19 | Donart Kaqandolli | 044 56 48 11 | [illegible] |
| 20 | SHABAN GASHI | 044 555 761 | [illegible] |
| 21 | Asllan Begiri | 044-340-572 | [illegible] |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Sraip Hajrizi | | [signature] |
| 2 | MUSTAF SADIKU | 044-262-762 | [signature] |
| 3 | Qazim Aliaj | 044-193-33 | [signature] |
| 4 | Fatmira Bairami | 045-222-62 | [signature] |
| 5 | Elfie Blaqici | 044.298 355 | [signature] |
| 6 | ABEDIN ISMAILI | 044 168 486 | [signature] |
| 7 | FAHRI HOXHA | 044-159 885 | [signature] |
| 8 | XHAFER ÇAVOLLI | 044-231-453 | [signature] |
| 9 | FERKI SYLEJMANI | 044 103 884 | [signature] |
| 10 | SHPEND BILALLI | 044440 065 | [signature] |
| 11 | NEXHMEDIN KRASNIQI | 044 785-160 | [signature] |
| 12 | ALI GRACA | 044880-626 | [signature] |
| 13 | Isa Ilazi | 044-361-694 | [signature] |
| 14 | ALI BRAJSHORI | 045-663-511 | [signature] |
| 15 | Donat Abazi | 049-668-909 | [signature] |
| 16 | ARMIR Gecaj | | [signature] |
| 17 | Emine Harhalli | | [signature] |
| 18 | Rafiq Shoqeni | | [signature] |
| 19 | ILIR BERISHA | 044 203035 | [signature] |
| 20 | AFERDITA ZENELI | 044 178-135 | [signature] |
| 21 | [illegible] | 049.361 685 | [signature] |
| 22 | AVNI MURTEZI | 045 615 618 | [signature] |
| 23 | FLAMUR ZEKA | 044151558 | [signature] |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Ariana Sorruqi | 049 141-933 | [illegible] |
| 2 | Elmedina Beka | – " – | [illegible] |
| 3 | Qamil Hajoli | 044-114-118 | [illegible] |
| 4 | Elmame Nila | 049-841-110 | [illegible] |
| 5 | Agim Bullija | | [illegible] |
| 6 | KADRI STATOVCI | | [illegible] |
| 7 | VJOSA VITIJA | 045-650-478 | [illegible] |
| 8 | Bajram Uitija | | [illegible] |
| 9 | ZENEL VELIU | 044-810-591 | [illegible] |
| 10 | Anda Saliha | | [illegible] |
| 11 | Shaban Krasniqi | 044 425 491 | [illegible] |
| 12 | DASHOR OVERISKI | | [illegible] |
| 13 | MUSTAFA GASHI | 044-197-046 | [illegible] |
| 14 | NEXHMI HADRIZI | 044 251 834 | [illegible] |
| 15 | [illegible] | | |
| 16 | BAHTIR MURTEZI | 044/233-110 | [illegible] |
| 17 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 18 | ISLAM ISLAMI | 044 112 133 | [illegible] |
| 19 | Donart Kajandelli | 044 56 48 11 | |
| 20 | SHABAN GASHI | 044555761 | [illegible] |
| 21 | Asllan Begiri | 044-340-572 | ABegiri |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | FEIM SALIHU | 044/666-447 | |
| 2 | Dibran REXHA | 044-247-564 | |
| 3 | Ukshin Vllasa | 044 207 112 | |
| 4 | | | |
| 5 | | | |
| 6 | | | |
| 7 | Thaçi Alun | 044163173 | |
| 8 | | | |
| 9 | Muhamet RAMA | 044.933191 | |
| 10 | [illegible] Vitia | [illegible] | |
| 11 | Vigan Vitija | | |
| 12 | [illegible] | | |
| 13 | | | |
| 14 | [illegible] | | |
| 15 | BEDRI KOSUMI | 045326509 | |
| 16 | Muhamet Veliu | 044-554-868 | |
| 17 | | | |
| 18 | Mosar Dashi | 049-505-256 | |
| 19 | [illegible] KRASNIQI | | |
| 20 | | | |
| 21 | Hafiz Zeqiri | | |
| 22 | BURIM AVDIU | 044 358-121 | |
| 23 | Fatmir Beqiri | | |
| 24 | Ariamita Krasniqi | 045-637-923 | |
| 25 | ILIR MURSELI | | |
| 26 | SHPRTIN BALA | 049.441474 | |
| 27 | VAHIR KELANI | 044/457-580 | |
| 28 | VIRTYT KRASNIQI | 044/121-146 | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Raip Hajrizi | | |
| 2 | MUSTAF SADIKU | 044-262-767 | |
| 3 | Qazim Aliaj | 044-193-33[illegible] | |
| 4 | [illegible] Bajrami | 045-222-02 | |
| 5 | Elfie Blegiri | 044.298 355 | |
| 6 | ABEDIN ISMAILI | 044 168 486 | |
| 7 | FAHRI HOXHA | 044-159 885 | |
| 8 | XHAFER ÇAVOLLI | 044-231-453 | |
| 9 | FERKI SYLEJMANI | 044 103 884 | |
| 10 | SHPEND BILALLI | 044440 065 | |
| 11 | NEXHMEDIN KRASNIQI | 044 785-160 | |
| 12 | ALI GRACA | 044 880-626 | |
| 13 | Isa Ilazi | 044-361-694 | |
| 14 | ALI BRAISHORI | 045-663-511 | |
| 15 | Donat Abazi | 049-668-909 | |
| 16 | ARMIR [illegible] | | |
| 17 | Emine Haxholli | | |
| 18 | [illegible] | | |
| 19 | ILIR BERISHA | 044 203035 | |
| 20 | AFERDITA ZEKAJ | 044 178-135 | |
| 21 | [illegible] R. Bejiqi | 049.381.685 | |
| 22 | AVNI MURTEZI | 045 615 618 | |
| 23 | FLAMUR ZEKA | 04415158 | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 31.05.2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Arbana Sorroqi | 049 147-933 | [illegible] |
| 2 | Elmedina Beka | — " — | [illegible] |
| 3 | Qamil Hajdini | 044-114-118 | [illegible] |
| 4 | Elhame Nila | 049-841-110 | [illegible] |
| 5 | Agim Bullija | | ABulliq |
| 6 | KADRI STTAFOVCI | | [illegible] |
| 7 | VJOSA VITIJA | 045-650-478 | [illegible] |
| 8 | Bajram Vitija | | [illegible] |
| 9 | ZENEL VELIU | 044-819-591 | [illegible] |
| 10 | Anda Saliha | | [illegible] |
| 11 | Shaban Kramiqi | 044 425 491 | [illegible] |
| 12 | DASHOX DUERISKI | | [illegible] |
| 13 | MUSTAFA GASHI | 045-197-046 | [illegible] |
| 14 | NEXHMI HADRIZI | 044 251 834 | NHadr. |
| 15 | [illegible] | | |
| 16 | BAHTIR MURTEZI | 044/233-110 | |
| 17 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 18 | ISLAM ISLAMI | 044 112 133 | [illegible] |
| 19 | Donart Kajtazholli | 044 96 48 11 | |
| 20 | SHABAN GASHI | 044555761 | [illegible] |
| 21 | Asllan Begiri | 044-340-572 | ABegiri |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

PRISHTINA

**KOMUNA E PRISHTINËS**

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 2

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**02 qershor**, në SHFMU "Elena Gjika ", duke filluar nga ora **16:00 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale, si dhe lidhur me problematikat e lagjeve.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Alban Zogaj - Nënkryetar i Komunës
3. Vllaznim Osmani - Shef i Kabinetit
4. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
5. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit
6. Donat Lushaku - Drejtor në Drejtorinë e Kadastrit
7. Florian Dushi - Drejtor në Drejtorinë e Inspekcionit

## 3. PROCESVERBALI

MIMOZA SYLEJMANI-mirëdita, mirë se keni ardhë, unë jam Mimoza Sylejmani drejtore ne Drejtorinë e Planifikimit, me mua sot është edhe nënkryetari i Komunës- Alban Zogaj, drejtori i Urbanizmit- Arbër Sadiki, shefi i Kabinetit- Vllaznim Osmani, drejtori i Kadastrit- Donat Lushaku , drejtori i Inspekcionit- Florian Dushi. Kemi ardhur sot me shumë te bëjmë një bashkëbisedim se sa te ju prezantojmë ndonjë plan qe e kemi bërë për lagjen e juaj, mirëpo ne pika te shkurta unë bashkë me Kryetarin dhe pjesën tjetër te ekipës do te përgjigjemi ne te gjitha pyetjet qe ju i keni. Për momentin jemi ne fazën qe jemi duke e bërë Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale. Plani zhvillimor Komunal për ata qe nuk e dine i përcakton kufijtë e Prishtinës bashkë me fshatra dhe Harta Zonale është hartë rregulluese siç ka qene me herët Plani rregullues, mirëpo tani nuk kemi plan rregullues por e kemi një hartë qe e përfshin gjithë territorin e Prishtinës, ku do te kemi edhe ndërlidhjen mes zonës urbane e rurale. Prishtina e vjetër përbëhet prej 38 hektarëve, te cilat janë ne zone te mbrojtur sipas Ministrisë se Kulturës dhe Institutit për mbrojtjen e monumenteve. Një hartë qe e kemi siguru se fundmi qe është miratuar ne vitin 2019 është një hartë kjo qe po e shihni( shfaqet ne projektor)këtu me vija te kuqe te erret është zona qe është e mbrojtur dhe kjo me te kuqe me te zbehte tregon zonën ne mbrojte te përkohshme. Ne lagjen e juaj siç po e shihni i kemi 4 objekte ne mbrojtje dhe 34 objekte ne mbrojtje te përkohshme. Sot i kemi thirre ne takim edhe lagjen Dodona pasi jeni ne kufi. Lagjja Dodona shtrihet ne 19.4 hektar,

e cila ka plan zhvillimor urban qe është miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës ne vitin 2005, e kemi edhe Planin 2004-2020 i cili ka skaduar, tani ne jemi ne zhvillim te Planit te ri qe po shpresoj qe deri ne fund te vitit siç edhe ka thënë Kryetari do ta kemi si dokument te gatshëm dhe do e propozojmë ne Kuvend për miratim. E kemi grupin punues qe deri tani ka punuar ne mënyrë te ndare, Ministria e Planifikimit, Ministria e Kulturës dhe Komuna, tani jemi duke tentuar qe te punojmë se bashku, e kemi edhe një grup punues i përbërë prej te gjitha drejtorive ku do ta trajtojmë komplet zonën e Prishtinës se vjetër, jemi tu u mundu qe mos te futet një zone kaq e madhe ne mbrojtje nëse nuk është e nevojshme. Një tjetër premtim i kryetarit ne te cilin edhe jemi duke punuar është ndërlidhja e sheshit me zonën e vjetër te qytetit. Tani siç edhe e keni pare është duke u restauruar xhamia, tani jemi ne diskutim me Bashkësinë Islame edhe me Muzeun e kryeqytetit edhe me Institutin për mbrojtjen e monumenteve qe mos te kemi mure mes vete po te ndërlidhemi, qe t'ia ngrisim vlerën kësaj zone. Ju me se miri e dini qe është lagjja e pare e kryeqytetit dhe i kemi ndërtesat e para qe janë ndërtuar nëse nuk gaboj ne vitin 1944, kështu qe jemi duke tentuar me e mbrojt trashëgiminë tonë. E keni pa qe jemi duke e restauruar edhe Sahat kullën, tani jemi ne diskutim për ta restauruar edhe Hamamin i cili ka mbete ne gjysme, gjithashtu edhe siç e ka thënë Kryetari, sa me shpejt qe është e mundshme ta rregullojmë edhe Tregun e qytetit. Ne këto ilustrimet qe po shihen(shfaqet ne projektor skica) këtu mund ta shihni si është i projektuar se si do te duket tregu, është i mbuluar dhe me standarde evropiane, me qene një treg siç i ka hije një kryeqyteti.

ARBËR SADIKI-Përshëndetje, unë jam Arbër Sadiki- drejtor ne Drejtorinë e Urbanizmit.do te mundohem pak a shumë me ju shpjegu se si funksionojmë ne, atë qe po mundohemi ta bëjmë ne lagjen e juaj, edhe ne takimet qe i kishim ne lagjet e tjera, është te ju prezantojmë vizionin qe e prezentoi edhe Kryetari ne fushatë se si e sheh ai kryeqytetin, e Drejtoria e planifikimit e harton këtë vizion, e ne si Urbanizëm e implementojmë. Ne jemi duke punuar ne këtë projekt por para se te vijmë me një Plan final, edhe ne takimet e mëhershme qe i kishim, edhe me ju sot këtu do te diskutojmë e bashkëbisedojmë për problematikat, shqetësimet e kërkesat e juaja si banor te kësaj lagjeje, qe se bashku te punojmë qe ne fund këtë Plan ta realizojmë ne mënyrën më të mirë e me te kënaqshme për ju se pari, dhe për kryeqytetin. Përafërsisht ne i dijmë se me çka ballafaqohet secila lagje por këto informata nuk janë te mjaftueshme për atë se çfarë ne po duam te bëjmë, e qëllimi ynë është qe te takohemi me banoret e secilës lagje e ti diskutojmë problematikat me juve, sepse ju me se mirë e dini se çka mungon e çka nevojitet për një jetese më të mirë ne lagjen e juaj. Secila lagje i ka karakteristikat e veta, e ne rastin e juaj, lagjja juaj i ka karakteristikat qe lidhen me trashëgiminë kulturore, e qe ne këtë rast nuk duhet te shihen si peng por si potencial për zhvillim. Sot nga ju presim qe te marrim ato çka neve po na duhen për këtë Plan, dhe ne te njëjtën kohe edhe ju te pyesni e kërkoni çka juve ju shqetëson, ju faleminderit.

FLORIAN DUSHI-ju faleminderit të gjithëve qe keni ardhë, zoti Kryetar faleminderit qe keni ardhë, është hera e pare qe kemi kësi lloj bashkëbisedimi te këtij formati. Siç e kemi biseduar edhe dhjetëra here për këtë pjese te qytetit e cila praktikisht ka mbete si zone qorre ne kuptimin e planifikimit dhe zhvillimit e qe është pjesa qendrore e qytetit te Prishtinës. E tha edhe Arbëri, e ka thënë edhe Kryetari gjatë takimeve e konsultave qe i kemi pas, qe ne këtë pjesën tonën d.m.th.-ne, monumentet historike dhe çdo gjë kulturore qe ndodhet ne këtë lagje, e konsiderojmë qe është me vlere, te ruhet por kërkesë e jona është qe ne mos te penalizohemi për këtë fakt. Te caktohen kufinjtë e saktë te këtyre zonave e ne anën tjetër pjesa tjetër, normal qe sipas karakteristikave dhe planeve te lejohet dhe te zhvillohet si lagjet tjera te qytetit. Kryetari gjithmonë ka pas mirëkuptim për një gjë te tille, e unë sot duke qene ne rol te dyfishte, edhe si pjese e ekipës se Kryetarit edhe si pjese e juaja qe jemi me gjenerata pjese e kësaj lagje, jemi jashtëzakonisht te kënaqur për qasjen dhe trajtimin ne përgjithësi qe ka kryetari ndaj kësaj zone te qytetit, ju faleminderit.

KRYETARI –faleminderit qe keni ardhë, kënaqësi me qene me juve sot edhe me diskutu rreth zhvillimit, rigjenerimit po e them te lagjes. Vizionin e transformimit te qytetit e kemi prezantu ne pika ndoshta te shkurta me herët, mirëpo tani jemi ne proces te planifikimit zhvillimor komunal, dhe hartave zonale dhe detalizimit te të gjitha zonave. Prishtina si kryeqytet ka një mundësi te hatashme për zhvillim, sot kemi mangësi te shumta ne kryeqytet, kemi një potencial i cili është i fshehur, potencial i trashëgimisë kulturore, arkitektonike, i cili është pikërisht ne këtë zone, dhe ne duhet me i qit ne pah, për te mirën e komunitetit, për zhvillimin e bizneseve për zhvillimin e mundësive për punësim, si hotele apo gastronomisë. Ne këtë proces te transformimit te Prishtinës duhet me e gjetë nja balanc mes këtyre elementeve te ndryshme. Parametri kryesor është mirëqenia juaj, krijimi i vlerave shoqërore. Ne nuk duhet te mendojmë vetëm për metra katror, por për vlerat shoqërore qe janë , shkollat, çerdhet, vende rekreative, vende te gjelbëruara, qendra te mjekësisë familjare, te mjaftueshme për densitetit qe po e bëjmë, po ashtu potencialin e ri te zhvillimit te turizmit, te zonës se tregut te gjelbër, mandej e kemi procesin e lidhjes se sheshit me Prishtinën e vjetër me nënkalim për këmbësorë, me parkingje nëntokësore, për me e liru ose me e qit ne pah pjesën e trashëgimisë kulturore. E kemi shkollën " Elena Gjika" qe mundemi me kriju hapësira te sigurta përreth. Veç e kemi fillu këtë proces. Shumë fëmijë e prind te kësaj shkolle kanë qene pjese e këtij procesi dhe e kanë pa qe me një intervenim te thjeshtë dhe te vogël mundet me u kriju një siguri shumë ma e madhe për ta. Mandej e kemi pjesën e trashëgimisë kulturore, monumenteve te mbrojtura qe ndodhen brenda ne këtë zone, kjo nuk do te thotë qe ne nuk mund te zhvillohemi ne këtë zone, por duhet te punojmë me një seriozitet te shtuar se si ta trajtojmë këtë zone. Duke e pas parasysh gjendjen ekzistuese te kësaj zone, ku kemi një numër te madh te ndërtimeve, kemi problem me trotuare, kemi problem me hapësirat e gjelbëra, me kanalizimet, me vende rekreative e shumë elemente tjera, dhe duke i marre parasysh krejt këto jemi ne proces për me kriju një projekt-propozim, një zhvillim te mirëfillte ku secili prej nesh, e gjithë lagjja përfitojnë si rezultat i zhvillimit. Sot kam dëshirë me ju ndëgju, me bashkëbisedu me juve, qe me i qit ne pah elementet qe ju mungojnë ose mendoni qe duhet me i pasë ne përditshmërinë e juaj. Ne nuk jemi këtu për me e dëmtu askënd, ato zona qe vendosim p.sh për me i hap, për me i ba hapësira publike, kompensimi kalon ne ndërtim ne zonat ku ndërtohet me te njëjtin koeficient, kjo është ideja qe mos me e pësu askush, por të gjithë te jemi te kënaqur ne transformimin e kësaj zone historike, e kësaj zone te veçante qe mos me e lënë siç tha Floriani me herët zone qorre, por me qene zone atraktive për ju, për turista, edhe me u zgjidh edhe problemet e tjera qe ballafaqoheni ju ne përditshmëri. Këto ne pika te shkurta janë te gjitha parametrat qe ne ende jemi duke i shqyrtu, por sot dëshiroj te bashkëbisedoj me ju, te ju ndëgjoj juve çka keni për me na thane ,por jo vetëm sot, nga sot po fillojmë rrugëtimin tonë te përbashkët, marrim informata, i marrim parasysh te gjitha pikat qe ju i keni cek dhe herën tjetër kur te vijmë do te punojmë se bashku ne projekt , ne vizatime, me rëndësi është qe ju ta ndieni veten te lire me kërkesat, shqetësimet dhe prezentimet e juaja, ose ato mungesat qe juve kishin me ju përmirësu jetën e përditshme, kështu qe se bashku me e ngrit vlerën e sigurisë, vetëbesimit e mirëqenies shoqërore. Ju faleminderit.

SHAIP FAZLIU- banor i lagjes- cilat rruge janë te mbrojtura, ose cila pjese e lagjes është e mbrojtur, apo bahet fjale vetëm por monumente ku ato ndodhen.

ARBËR SADIKI- kufinjtë e zonave te mbrojtura i cakton Ministria e Kulturës, atë qe ne po mundohemi me e ba tash është qe me u përfshi edhe Komuna e Prishtinës ne rishikim jo vetëm te kufinjve, sepse kur bëhet një kufi nuk do te thotë qe nuk mundet me u ndërtu, por janë rregullat qe parashihet se si do te zhvillohet ajo pjese. Për atë ne jemi angazhu disa here me Ministrinë e Kulturës për ti rishiku edhe kufinjtë edhe rregullat. Ju thash edhe me herët qe secila pjese e qytetit i ka karakteristikat e veta dhe ne nuk mund ti neglizhojmë ato, atë çka ne mund te bëjmë, është te bëjmë më të mirën qe secilës zone me ia rujt elementet e karakteristikat e veta dhe te njëjtën kohe edhe me zhvillu atë pjese.

BRAHIM ABAZI-faleminderit Kryetar, faleminderit të gjithëve- me këta kufinj, ky plan a është afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë, ju faleminderit.

LUMNIJE TERDANI-ju përshëndes, jetoj ne rrugën Edmond Hoxha, tash e kanë ndërru prapë, nuk e shoh te arsyeshme qe po i ndërrojnë emrat e rrugëve shpesh. Rruga jone është ne kufi me Velaninë, ne jemi me Dodonën, Velania po zhvillohet Dodona ka mbet, ishalla ju po mbeteni ne histori qe ju keni kthy Prishtinës se vjetër, se kjo zone ka mbet ne gjendje shumë te keqe, rrugët e ngushta, mandej parcelat janë te vogla qe investitori e ka problem, jemi mbet tepër keq, kanalizimi tmerr, ka shtëpi te uzurpume, ka shtëpi te palegalizume, ka shtëpi qe janë djegë gjatë luftës edhe e rrezikon jetën e qytetarit. Unë kam qene ne Inspektorat jam ankuar gojarisht disa here, por asgjë. Në zonën tonë bash kurrfarë investimi kisha pas qef me e dite për rrugën tonë çfarë plani keni, aty unë kisha propozu ndërtime kolektive e jo individuale.

MEMLI PAJAZITI-përshëndetje Kryetar, përshëndetje të gjithëve, jam pronar këtu dhe gjithashtu edhe ndërtues, po flas për pronën time qe ndodhet ne këtë pjesën(tregon ne skice ne projektor) qe është ne mes e rrethohet nga Muzeu, Xhamia pak me lart, Gjykata, me poshtë është shtëpia e familjes Riza, na kemi marr disa pëlqime prej Ministrisë për ndërtim, pëlqimi i fundit është i vitit 2018. Nuk mendoj qe paraqet ndonjë problem për monumentet e mbrojtura, do te ju siguroj edhe dokumente na Ministria e Kulturës.

DONJETA MEJTANI-ne jemi një nder familjet e shumta qe janë dëmtu ne lagjen Dodona. Ne vitin 2011 shtëpia jone e shumë tjera janë rrënu, neve na është bërë padrejtësi, është ide e cila ka rrjedhe prej vet Komunës. Atë kohe ne qeverisje e ka pas Isa Mustafën i cili vet i mbledh pronaret për këtë plan, ka qene e kontraktuar Lesna Ndërtimi, mirëpo lejen Komuna nuk e ka leshu, njëherë i kanë rrëzu shpijat pa nxjerr leje e mandej kanë dal probleme me këto objektet qe janë ne mbrojtje kulturore, jo nuk bën kinse me ndërtu deri ne 50 metra afërsi, e krejt këto Komuna ka pandeh qe nuk i ka dite, e qysh është e mundur qe Komuna vet mos me i dite rregullat, te cilat rregulla ajo duhet me ju tregu qytetareve, e jo me ju rrëzu shpijat e tani jo janë rregullat. Kështu ne zonën tonë nuk lejohet me u ndërtu se është Xhamia, edhe nuk bën me kalu ndërtimi përmbi kupolë, kështu qe parimisht koeficienti i cili ka qenë ne 4.8 ka zbritë ne 2.2. Lesna ndërtimi është ndare e pakënaqur me këtë gjë dhe i ndërprenë te gjitha obligimet kontraktore qe i ka pas me neve dhe pronaret e tjerët aty. Mandej vjen qeverisja 8 vjeçare e Shpend Ahmetit, i cili njëherë thotë qe nuk mundeni me vazhdu pa plan te ri rregullativ mandej pa plan te ri zhvillimor mandej pa harta zonale. Në mandatin e tij te dytë Shpend Ahmeti bashkë me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, e japin dritën e gjelbër qe me vazhdu ndërtimet, por akoma nuk kanë fillu edhe nuk i kanë vazhdu ndonjëherë. E ne krejt këtë pronaret e shtëpive jo vetëm qe kanë pasë dëme materiale, por këtu duhet me e pas parasysh demin emocional, psikologjik qe është shkaktu.

MIMOZA SYLEJMANI-një sqarim, nuk e ka jep Ministria dritën jeshile për me fillu me ndërtim por është iniciuar ne Kuvend Komunal për me fillu për planin e hollësishëm te lagjes Dodona. Tani ministria është duke i kthyer mbrapsht te gjitha dokumentet se po thotë tash pasi po e hartoni Planin Zhvillimor e Hartën Zonale. Te gjitha këto probleme qe ju i ceket tash, nuk kanë me u trajtu me Hartë Zonale.

DONJETA MEJTANI- kur kryhen Këto Plane

MIMOZA SYLEJMANI-nëse me keni ndëgjuar me herët qe e thashë se brenda vitit duhet me e përfundu Hartën Zonale.

MEMLI PAJAZTI- ne PZHU kanë qenë edhe pëlqimet e Ministrisë se Kulturës, ato ekzistojnë, a mundet Ministria çdo dite me qite pëlqime te reja për monumentet se faktikisht qe 20 vjet tu punu me ato pëlqime, se dikush ka ble toke këtu p.sh.

ARBËR SADIKI- plani urbanistik atë qe e përmende PZHU-ja, është dokumenti baze ne baze te cilit ne lëshojmë leje ndërtimore, por jo i vetmi. Ne momentin kur ne e kemi ne Planin Zhvillimor Urbanistik një zone qe është zone brenda kufinjve te mbrojtur, ne jemi te obliguar ne raste te tilla me ju referu edhe dokumenteve tjera te cilat ne këtë rast i harton Ministria e Kulturës, dhe ne nuk mund te bëjmë shkelje ligjore, nëse një ndërtim brenda asaj zone procesohet vetëm me Plan Zhvillimor Urbanistik por jemi te detyruar qe me ju bind edhe kritereve qe përcaktohen nga dokumente tjera. Kjo është ajo çka e thash me herët qe jemi ne koordinim me Ministrinë qe këto mospërputhje, siç e thatë edhe ju me herët qe ka shtëpi qe nuk ekzistojnë më por janë ne mbrojtje ose ka zona për disa lumenj p.sh qe janë ne mbrojtje te cilët vetëm lumenj me nuk janë, e kemi edhe plot zona tjera qe është vështirë me i mbajt peng, me i lanë pa zhvillu, pa i hy diskutimit pak me thelle. Kjo është ajo çka ne po përpiqemi me e ba me Hartat zonale, qe te kemi një dokument ne te cilin do te jene te gjitha informacionet. Ne tash jemi ne proces te hartimit te GIZ-it, për ata qe nuk e dine GIZ është një program i cili ta mundëson qe me një data baze me një klik me i pas krejt hartat njëra mbi tjetrën qe ti minimizojmë këto lloj problemesh qe ne te njëjtën zone mund te këtë trajtime te ndryshme te zhvillimit te asaj zone. E ju qe i keni këto probleme te kësaj natyre qe i keni peng me vite, e leme e takohemi një dite edhe i diskutojmë te gjitha.

SHKELZEN GJËVORI-përshëndetje të gjithëve, jam njëri nga tre përfaqësuesit e zonës saktësisht rr. Antigona Fazliu, ne rrugën tonë ka ndërtime 6+2, 7+2, ata kanë mujt me ndërtu, kurse pjesa tjetër nuk është lejuar, dhe koeficienti qe ka qene i përcaktuar ne zonën tonë është 1.2, ne nuk jemi për me caktu koeficient, atë e bëni ju, por kërkojmë qe mos te jemi te diskriminuar, ne planin e ri po shpresoj qe te bëni një balancim ne ndërtime ne zonën tonë, edhe te mirret ne konsideratë vlera e tokës, ne jemi për ndërtim, por asnjëherë për te bërë shëmtim te zonës, apo për ti ja ulur vlerat siç ka ndodh me objektet qe veç janë ndërtuar.

ARBËR SADIKI-sikur edhe zonat edhe ne këtë zone ne do ti marrim parasysh te gjitha, asnjë zone e qytetit nuk do te trajtohet pa e marr parasysh vlerën e tokës, ne e kuptojnë qe një pronar e ka vlere atë se e ka fitu me mund, ne çfarë do propozimi qe do ta bajme ne do ta marrim për baze, por duke e balancuar edhe me interesat publike, mundësitë reale, dhe kjo bëhet vetëm me rigjenerim komplet te asaj zone, si tërësi urbane, duheni edhe me e kuptu qe arsyeja pse ekziston një Komunë është qe ta mbroje interesin publik dhe ne jemi këtu qe me e balancu interesin publik me interesin privat pa e shkel asnjërën pale.

EKREM ISMAILI-banor i lagjes, rruga rreth parkut ish Adriatiku, na jemi mbet ne këtë pjese te qytetit si n' humnere, problemet ma te mëdhaja qe 20 vjet mbas lutës i ka pas kjo pjese, si për investime, kanalizim, ujësjellës, ndriçim rruge, trotuare, me dal me kalu ne mbrëmje p.sh mbas orës 18 këtu e ke terr komplet, mandej ku është siguria e fëmijëve qe shkojnë ne shkolle. Hartat zonale është problemi ma i fundit, se pari primare duhet te jete mirëqenia e banoreve. E kisha lut Kryetarin e drejtorin e Urbanizmit qe te bëjnë zgjidhje se paku për fëmijët tanë.

KRYETARI- faleminderit, e përmenda edhe me herët qe rritja e sigurisë, mirëqenia, për ne është elementi kyç. Plani Zhvillimor Urbanistik merr kohe por ne, në ndërkohë duhet sanuar problemet e përditshme qe e vështirësojnë jetën e qytetareve. Për atë edhe jemi këtu, qe ti ndëgjojmë, edhe me herët u tha qe me vite ballafaqoheni me problemet e njëjta, këto janë primare sidomos siguria e fëmijëve, jemi ne proces duke i testuar, analizuar shumë rruge sidomos ato afër shkollave me mundësi te bëhen njëkahëshe, te kemi trotuare te lira për këmbësorët, te intervenohet ne ndriçim e ne shumë mangësi tjera. Edhe ju kisha lut qe me herët qe u tha për problemet me pronat qe i keni me vite, ne e caktojmë një takim edhe i diskutojmë se bashku, ju faleminderit.

GANI LLUGA-sociolog, banor lagjes rr. Demir Vitia, ndërrimi i emrave te rrugëve pa nevoje, ne e kemi propozuar qe rruga jone te quhet Jusuf Gërvalla, i kam disa kërkesa 1) ne Planet juaja qe janë ne proces te jene pjesëmarrës ne vendimmarrje qytetaret, 2)kabllot e rrymës nuk e di a jeni përgjegjës ju a Keds-i, i kanë lënë ne gjysme punën, 3) gjatë procesit te Planit ju kisha lut qe te gjitha informacionet te i hidhni ne webfaqe qe me pas qasje edhe ne qytetaret, ju faleminderit.

FEHMI VESELI-ekonomist, banor i lagjes, ish Adriatiku, Keds ,kanë punuar me rrymën dhe rrugën e kanë ba tmerr, te ndreqen kubëzat, emrat e rrugëve ndërrohen tere kohë edhe ndriçimi ne këtë rruge urgjent duhet te ndreqet, edhe po me intereson çka do te bahet me rrugën ish Moravës, aty shtëpitë janë te vjetra gati ne shembje e fëmijët andej kalojnë, nuk ka siguri andej.

PËRIHAN UKA-kabllot e rrymës janë kapun ne ballkonit tim, ato janë krejt te hapuna, mandej është rrezik gjatë dimrit ,a keni ndërmend me i ndreq, edhe veturat qarkullimi dhe parkimi i tyre është kaos, ne nuk kemi kah me lëviz.

ARBËR SADIKI-përgjegjës për punimet me rrjetin elektrik është Keds-i , sa e di projekti parasheh qe deri ne vitin 2023-2024 asnjë kabllo te mos jete ne sipërfaqe te gjitha te jene nen.

ILIR MORINA-banor i lagjes rr. Hamdi Morina, rruga është njëkahëshe nuk ka shenjë, edhe mandej bllokohen kerret në rrugë, edhe unë ne pronën time nuk mund te ndërtoj, kjo nuk është në rregull, ose le te me lejohet ndërtimi ose me tregoni se çka keni ne plan për rrugën tonë, mos na mbani peng.

KRYETARI-drejtoresha e përmendi ne fillim qe këtë vit e përfundojmë Planin Zhvillimor dhe Hartat Zonale, po synojmë qe deri ne shtator, por do te kemi edhe diskutime shtese e deri ne fund te vitit te finalizojmë. Vlefshmëria e këtij plani është 8 vite e pas 8 viteve prapë duhet me e rishiku e me u ridizajnu.

KADRI ZYLFIU-banor i lagjes, rr. Antigona Fazliu, ne i kemi dërguar 99 nënshkrime te banoreve te rrugës tonë. Unë posedoj 1000 m katror, përballe meje është objekti 7 kat pa asnjë hapësirë gjelbërimi, tjetri 6 kate, me poshtë është objekti 9 kat, ne po ndihemi te diskriminuar, unë nuk kisha dasht me ndërtu ashtu, por me gjelbërim, e jo me shëmtu rrugën, kërkesa qe te na lejohet ndërtimi, a ne rrugën tonë ka ndërtime edhe pa leje, ne po ndihemi te diskriminuar, sepse nuk po na lejohet ndërtimi, unë jam pronar i parcelës me 1000 metra katror.

KRYETARI- procesi i rigjenerimit i merr parasysh te gjitha këto pika, te gjitha këto probleme urbane për me i trajtu qytetaret barabarte, bëhen analiza, dihet gjendja ekzistuese, cilat janë mangësitë edhe cilat janë mundësitë, te gjitha tokat do te trajtohen njëjte, nëse p.sh ne token tende parashihet gjelbërim, koeficienti qe është parapare për ndërtim e gëzoni te drejtën edhe ju ne atë zone. Askush nuk humb ne këtë proces, do te krijojmë vlera, dhe do ti zgjidhim problemet qe janë prezente.

SHAIP- para 10 viteve kemi bërë një peticion për ndërtim te larte me koeficient 4, a do te pranohet kërkesa , ne zonën tonë ka edhe ndërtime pa leje, edhe kufinjtë si dhe qysh do te përcaktohen, a do te ndryshojnë.

KRYETARI-kufinjtë qe po shihen tani, nuk i kemi vendosur ne, por janë te vendosura prej vitit 2019,e kemi formu grupin punues, ne jemi ne bashkëpunim me të gjithë me UN Habitat, edhe me Ministrinë e Kulturës qe me i rishiku këta kufinj, por siç e cekem edhe me herët kufinjtë nuk do te thotë qe ajo pjese nuk mundet me u zhvillu, a sa i përket pyetjes për ndërtimin e larte, nëse duam te krijojmë hapësira te gjelbëra, rekreative, me e zhvillu atë pjese ne duhet gjithsesi me e ngrit lartësinë, qe me liru hapësirë, normal qe balancohet ne gjithë zonën, jemi ne proces duke punuar.

EDITA GASHI-banore e lagjes, Blloku i parë, unë e kam dorëzuar edhe me email kërkesën time, ka qene për fasadën e bllokave, faleminderit qe me jeni përgjigj. Siç e dini Kryetar Bllokat janë ndërtesat e para te Prishtinës, janë ne gjendje te mjerueshme, kush ka mujt i ka rregullu, një pjese nuk është, NPB-ja i ka rinovuar vetëm 2 hymje, ju kisha lut qe ne Planin e juaj rregullues ti keni parasysh. Kam disa kërkesa, te rrënohet shtëpia e vjetër sepse është rrezik për kalimtaret andej, një inspektor ka qene e ka pa, e ku ka mbet puna nuk e di, tjetri problem është qe mundësisht rrugët te bëhen njëkahëshe, është urgjencë, mandej problemi me bërrlogun, dhe për qentë endacake, besoj qe ato ju veç i dini, ju faleminderit.

VLLAZNIM OSMANI-ju kisha propozu qe ju të gjithë banoret e bllokave te bëni një kërkesë te NPB-ja për rinovimin e hymjeve tjera, mendoj qe me mirë është ta bëni kërkesën se bashku se individualisht, se me te vërtetë bllokat duken shumë keq.

FLORIAN DUSHI-po është rasti qe kemi dal me inspektu menjëherë pas lajmërimit, inspektorët me siguri janë ne përgatitje te procesit, bëhet fjale për një prone te Komunës, qe unë do te thoja qe i plotëson te gjitha kushtet e rrezikshmërisë, duhet me u rrënu, besoj qe shumë shpejt do te kryhet edhe kjo.

AGIM RAIFI-banor i lagjes rr. Bajram Kelmendi, nuk ka shporta për mbeturina edhe ne rrugën tonë ndodhen 4 supermarketa qe furnizimet i kanë pa kurrfarë orari edhe e bllokojnë rrugën, plus mandej i kemi edhe veturat qe parkohen vend e pavend.

MIMOZA SYLEJMANI-është duke u bërë rregullorja për furnizuesit, së shpejti do te aprovohet qe furnizuesit do kenë kohë e caktuar për furnizim.

ARBËN BYTYQI-banor i lagjes rr. Zenel Salihu, shkaku i kushteve, dhe qe nuk me është lejuar ndërtimi unë e kam pronën por nuk mundem me e shfrytëzu, a ka me pas Plan zhvillimor edhe për zonën tonë.

RAMIZ COCAJ- jetoj ne rrugën qe na ndan nga Parku i Qytetit, kemi mungese te ndriçimit, i kanë pre dritat, ju e dini qe ne Park ka varreza te vjetra, ato janë hapur edhe shihen kafkat e njerëzve dhe eshtrat, unë e kam lajmëruar rastin, ende asgjë, mandej kanalizimi ne lagjen tonë është tmerr, ka vërshime.

ARBNOR ZIBERI- banor i lagjes rr. Bajram Kelmendi, ne rrugën tonë janë ende disa shtëpi ekzistuese me balte , qe janë ne rrezik dhe gati për shembje, zona jone ka mbet e diskriminuar, ka ndërtime qe janë lejuar, dhe janë ndërtim i larte, ka ndërtime pa leje, gjithashtu ka edhe raste qe nuk u lejohet ndërtimi.

BUJAR SHEFIKI, banor i lagjes rruga te Xhamia e Çarshisë, a do te kemi dalje ne si banor te lagjes kur te bëhet nënkalimi.

RRON MORINA-banor i lagjes, rr. Hamdi Mramori te 4 Llullat, pse nuk po lejohet ndërtimi ne rrugën tonë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ZANA ALAJ | | [signature] |
| 2 | OSMAN VITIA | | [signature] |
| 3 | Shqipe Fazlei | | [signature] |
| 4 | BUJAR SHERIFI | | [signature] |
| 5 | XHEMAL GELAVICA | | [signature] |
| 6 | ALI DIBRA | | [signature] |
| 7 | DRITON KOMONI | dritonkomoni@hotmail.com | [signature] |
| 8 | Donjeta Mejtani | donjetamejtani@gmail.com | [signature] |
| 9 | Shegajdin Mejtani | shmejtani58@gmail.com | [signature] |
| 10 | Shpresa Mejtani-Qollaku | | [signature] |
| 11 | Fishnik Osmani | fishnik.o@gmail.com | [signature] |
| 12 | Arbnor Ziberi | aziberi@hotmail.com | [signature] |
| 13 | ILMIJE AHMETI | | [signature] |
| 14 | SHKELZEN BERISHA | SHKELZENBERISHA@GMAIL.COM | [signature] |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muhamed Zeqiri | | |
| 2 | PETRIT MORINA | PETRIT.SH.MORINA@GMAIL.COM | |
| 3 | Lavdim Zylfiu | lavdim.zylfiu@gmail.com | |
| 4 | Lumnij [illegible] | [illegible] | |
| 5 | [illegible] | 044344849 | |
| 6 | Andi Ismajli | 045-676-705 | |
| 7 | [illegible] | 044/923-873 | |
| 8 | [illegible] | 049 116-592 | |
| 9 | Betim Navakazi | 043-770-484 | |
| 10 | KEMAL ADIZI | 044-181 552 | |
| 11 | QAZIM RASHTI | 044 235 391 | |
| 12 | FEDZULLAH RASHITI | 044 776 529 | |
| 13 | CEZIM DUSHI | 043 207351 | |
| 14 | Safija Besemi | 044257787 | |
| 15 | Ahmet Nuta | 044-933-277 | |
| 16 | AGUC SALLIHU | 044 114480 | |
| 17 | FITIM PULLOSHKA | 049 306030 | |
| 18 | FEHMI VESELI | 044 368714 | |
| 19 | FATOS HOTI | 049-850-180 | |
| 20 | | | |
| 21 | AFERDITA YMERI | 049 709 410 | |
| 22 | RAMIZ GOGAJ. | 044260232 | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muhamed Demiri | | |
| 2 | PETRIT MORINA | PETRIT.SH.MORINA@GMAIL.COM | |
| 3 | Lavdim Zylfiu | lavdim.zylfiu@gmail.com | |
| 4 | Lumnije [illegible] | | |
| 5 | Rrahim Haddadi | 044344849 | |
| 6 | Andi Ismajli | 045-676-705 | |
| 7 | [illegible] | 044/923-873 | |
| 8 | Faik Prapaniku | 049 116-592 | |
| 9 | Betim Navakazi | 043-770-484 | |
| 10 | KEMAL ADILI | 044-181 552 | |
| 11 | QAZIM RASHITI | 044 235 391 | |
| 12 | FEDZULLAH RASHITI | 044 776 529 | |
| 13 | CEZIM DUSHI | 043 207351 | |
| 14 | Safije Beseni | 044257781 | |
| 15 | Ahmet Nuta | 044-933-277 | |
| 16 | AGRON SALIHU | 044 114 80 | |
| 17 | FITIM POLLOSHKA | 043 306030 | |
| 18 | FEHMI VESELI | 044 368 714 | |
| 19 | FATOS HOTI | 049-850-186 | |
| 20 | | | |
| 21 | AFERDITA YMERI | 049 709 410 | |
| 22 | RAMIZ GOGAJ. | 044 260232 | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | EKREM ISMAILI | kemos.rks.gmail.com | 044841135 |
| 2 | Ismet Jashari | | |
| 3 | MEMLI PAJAZITI | Memlipajaziti@gmail.com | |
| 4 | Jusuf Ibrahimi | | |
| 5 | AFSRIJ Fatmi | 044-191-352 | |
| 6 | RON MORINA | 049 330-331 | |
| 7 | Jakup Bickaj | 044-533-745 | |
| 8 | Hoxhë Veliu | 044/115-383 | |
| 9 | JETA RAFUNA | 044/990058 | |
| 10 | Gëzim Pula | 045 100 501 | |
| 11 | QENDRIM Sofi | 044 240 517 | |
| 12 | FRU GJIN... | | |
| 13 | BASIR ISMAILI | 044 221-704 | |
| 14 | ARDIAN KONUSHEVCI | 044 150-096 | |
| 15 | Fadil Ismajli | 044 500 625 | |
| 16 | BASRI BERISHA | 044/214-508 basriberisha@hotmail.com | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | SHKELZEN GJEVORI | 044 - 111 - 009 | |
| 2 | KADRI ZYLFIU | 044 160-979 | |
| 3 | [illegible] HIRIJANI | 044188251 | |
| 4 | AFRIM TAFARSHIKU | 044452221 | |
| 5 | FATMIR QAZIMI | 044673775 | |
| 6 | Y PLLANA | | |
| 7 | NASER KRAMDARI | 049 790307 | |
| 8 | Ibrahim Kolmend. | 049 115-153 | |
| 9 | Orhan Nocerada | 044 495 439 | |
| 10 | Gjap Pllana | 045/424192 | |
| 11 | BESIM NAVAKAZI | 044-114-018 | |
| 12 | EDITA KUGINXHA GASHI | 049 126-020 | |
| 13 | RAMIZ SHALA | 04827035 | |
| 14 | ZINETA NIKOCEVIQ | 045 290 431 | |
| 15 | Arta Nuzei | artanuzza@hotmail.com | |
| 16 | [illegible] NUZA | | |
| 17 | KIMETE FALLU | 044135428 | |
| 18 | Agnesa R. Glloboder | 043663874 | |
| 19 | Ibrahim Kromiqi | 049 656-215 | |
| 20 | Arta Pllana | 044 151-812 | |
| 21 | IFETA NIKOCEVIQ | 049 146 926 | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muhamed Demiri | | [signature] |
| 2 | PETRIT MORINA | PETRIT.SH.MORINA@GMAIL.COM | [signature] |
| 3 | Lavdim Jylfiu | lavdim.zylfiu@gmail.com | [signature] |
| 4 | Lumnije [illegible] | [illegible] | [signature] |
| 5 | Rrahim Ibrahimi | 044344849 | [signature] |
| 6 | Andi Ismajli | 045-676-705 | [signature] |
| 7 | [illegible] | 044/973-873 | [signature] |
| 8 | Fatiz Prapashtica | 049 116-582 | [signature] |
| 9 | Betim Navakazi | 043-770-484 | [signature] |
| 10 | KEMAL ADILI | 044-181 552 | [signature] |
| 11 | QAZIM RASATI | 044 235 391 | [signature] |
| 12 | FEDZULLAH RASHITI | 044 776 529 | [signature] |
| 13 | CEZIM DUSHI | 043 207351 | [signature] |
| 14 | Safija Besemi | 044 257 781 | [signature] |
| 15 | Memet Nuta | 044-933-277 | [signature] |
| 16 | AGIM C SALLIHU | 044 114 480 | [signature] |
| 17 | FITIM POLLOSHKA | 049 306030 | [signature] |
| 18 | FEHMI VESELI | 044 368 714 | [signature] |
| 19 | FATOS HOXHA | 049-850-186 | [signature] |
| 20 | | | |
| 21 | AFERDITA YMERI | 049 709 410 | [signature] |
| 22 | RAMIZ GOGAJ. | 044 260 232 | [signature] |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | EKREM ISMAILI | kamos.rks.gmail.com | 044841135 |
| 2 | Xhemt Jashari | | |
| 3 | MEMLI PAJAZITI | Memlipajaziti@gmail.com | |
| 4 | Jusuf Ibrahimi | | |
| 5 | HYSEN [illegible] | 044-191-352 | |
| 6 | RON MURINA | 049 330-331 | |
| 7 | Jakup Bickaj | 044-533-745 | |
| 8 | [illegible] | 044/115-383 | |
| 9 | JETA RAFUNA | 044/990050 | |
| 10 | Gëzim Pula | 045 100 501 | |
| 11 | QENDRIM Sofi | 044 240 517 | |
| 12 | [illegible] | | |
| 13 | RASIM ISMAILI | 044 221-704 | |
| 14 | ARDIAN KONUSHEVCI | 044 150-096 | |
| 15 | Fadil Ismajli | 044 500 625 | |
| 16 | BASRI BERISHA | 044/214-508 / basriberisha@hotmail.com | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 02/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | SHPËTIM GJEVORI | 044 - 111 - 009 | |
| 2 | KADRI ZYLFIU | 044 160-979 | |
| 3 | AVNI MAHMUT HRIJANI | 044188251 | |
| 4 | AFRIM TAFARSHIKU | 044452221 | |
| 5 | FATMIR QAZIMI | 044673775 | |
| 6 | V PLLANA | | |
| 7 | NASER KRAMPAZI | 049 700307 | |
| 8 | Ibrahim Kolmend. | 049 115-153 | |
| 9 | Orhan Nagevda | 044 495 439 | |
| 10 | Gjup Pllana | 045/4241 92 | |
| 11 | BESIM KAVAKAZI | 044-114-018 | |
| 12 | EDITA KUQNXHA GASHI | 049 120-020 | |
| 13 | RAMIZ SHALA | 049827035 | |
| 14 | ZINETA NIKOQEVIQ | 045 290 431 | |
| 15 | Arta Nuzei | artanuzea@hotmail.com | |
| 16 | DRITON NUZA | | |
| 17 | KIMETE FAZLIU | 044135428 | |
| 18 | Agnesa R. Qylbadeli | 049663974 | |
| 19 | Ibrahim Kryemiq | 049 656-215 | |
| 20 | Arta Pllana | 044 151-812 | |
| 21 | IFETA NIKOQEVIQ | 049 146 926 | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**KOMUNA E PRISHTINËS**

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 3

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**06 qershor**, në SHFMU "Shkolla e Gjelbër", duke filluar nga ora **16:00 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale, si dhe lidhur me problematikat e lagjeve.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
3. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit

## 3. PROCESVERBALI

ARBËR SADIKI-përshëndetje të gjithëve, ne kemi filluar siç e keni pa edhe ne lagje tjera me debate te hapura qe gjithë ky proces i hartimit te Planit Zhvillimor dhe Hartave Zonale me fillu duke i marre te hyrat bazike nga vet banoret e asaj lagje ku jetojnë. Ne jemi te bindun qe gabimi ne hartimin e deritanishëm te dokumenteve planore ka qene se është shkuar menjëherë ne propozim.

KRYETARI-ju kërkoj falje por me duhet te largohem nga takimi , shkaku i erërave motit ka ndodh një aksident, ju kërkoj falje, jeni me Arbërin e Mimozën te cilët do e vazhdojnë.

ARBËR SADIKI-deri sot planet me reale dhe me lehte te implementueshme janë planet qe pikërisht fillojnë me diskutime qe ne fazën e parë. Fillimisht mirren te dhëna prej qytetareve, analizohen, normalisht qe planet nuk janë vetëm dëshira te pronareve te tokave, qytetareve, ndërtuesve por janë ne një mënyrë një lloj kompromisi mes dy palëve, qe me i balancu këto lloj interesash. Ideja pse ne sot kemi ardhë tek ju është qe edhe te marrim informatat qe na duhen nga ju por edhe për te prezantuar problemet qe ne i kemi, ne trashëgojmë një mori planesh qe ekzistojnë për lagjen e juaj por qe janë me shumë mangësi. Ne procedurën e hartimit te dokumenteve planore ne kemi probleme me komplet territorin e Republikës, pastaj ne lagje te caktuara kjo shprehet me shumë, për fat te keq ne lagjen e juaj dhe Kodrën e trimave, dy lagjet me më shumë problematika pikërisht për shkak te mospërputhjes te shumë dokumenteve paraprake qe duhen për me u realizu një planifikim i mirë. Për shembull nëse e shihni këtu( tregohen skicat ne projektor)këtu janë me vija te ndryshme te prezantuara, zonat kadastrale qe i takojnë njësisë se juaj, bashkësitë lokale dhe lagjja si është e zhvilluar realisht. Asnjëra me tjetrën nuk përputhen, me një planifikim te mirëfillte këto gjëra ish

dashtë me u përputh njëra me tjetrën. Atë qe ne po mundohemi me e ba tani është pikërisht duke fillu me një riorganizim te kufinjve te bashkësisë lokale pastaj te njëjtit kufinj me u përputh edhe me Hartat Zonale qe po dojmë me i zhvillu tash e tutje. Problematikat me pronësitë janë gjithandej te shprehuna brenda territorit te Komunës. Kemi lloj-lloj problemesh me pronësi qe edhe ju jeni ne dijeni për to, dhe pikërisht për këto probleme ka mbet lagjja e pazhvillume ,atë qe e ne po mendojmë me e ba këtu dhe qe është e mundshme dhe qe është varianti me i mirë, është qe përmes asaj qe ne po e quajmë rigjenerim urban ,nuk është një plan qe e kemi shpik ne po ka funksionuar ne shumë vende ane e mbanë botes me probleme te ngjashme, qe përmes një riformatimi te lagjeve te banimit ku përgjithësisht ka parcela te vogla te cilat nuk mund te zhvillohen, te bashkohen te rishikohen, edhe te kthehen prej një zone për banim individual ne një zone shumë banesore e tipit te mesëm, duke i balancuar koeficientet me hapësirën publike qe do te krijohen. Ne shumë lagje qe i kemi vizituar zakonisht janë problematikat e njëjta, shqetësimet, ankesat kërkesat. Qellim i yni është qe ne te bashkëpunojmë se bashku, ne çdo gjë, te jemi si dy partnere ne këtë projekt dhe te mos dëmtohet askush, së bashku te krijojmë një ambient te jetueshëm, dhe me vlera. Ky projekt i madh është vizion i Kryetarit i cili edhe është shpalosur gjatë fushatës, do te planifikohet nga drejtoria e Planifikimit, këtu me ne është drejtoresha Mimoza, dhe do te implementohet nga drejtoria e Urbanizmit. Këtu me ne është edhe Afërdita e cila është eksperte ne punimin e Hartave Zonale, ju kisha lute qe për çdo gjë qe juve ju shqetëson për lagjen e juaj, kërkesat qe i keni, mos hezitoni thuajeni, jemi këtu për te ju dëgjuar, dhe për te biseduar për te gjitha.

BAJRAM MEQANI-kam bërë kërkesë disa here, rruga jone është rruge me banime te reja, jemi 10 familje por rruga ende nuk është e shtruar, edhe normal me pas edhe emër për rruge.

ARBËR SADIKI-për punën e rrugëve te reja, asfaltimin, nuk mund te jap përgjigje konkrete këtu, është Drejtoria e Investimeve Kapitale e cila e ka një liste te gjatë te rrugëve qe kanë me u asfaltu gjatë vitit, por unë ju kisha propozu qe te vini ne Komunën e Re, ne këtë drejtori me një kërkesë ose edhe vetëm me u informu a është edhe kjo rruge ne listën e rrugëve qe do te asfaltohen.

BAJRAM MEQANI- na qe 4 vjet kemi ba kërkesën për rrugën tonë.

ARBËR SADIKI-pa dashtë me gjuajt faje, ne po flasim për këto 6 muajt e fundit prej kur ne kemi fillu me u marr, mos harroni qe ne Planin e Investimeve veç e kemi gjetë, ai i cili ka qene i aprovum, ne gjithçka qe jemi tu punu , jemi tu u përpjek me ridestinime te buxhetit me i rregullu gjanat, përndryshe procedura është e tille qe buxheti është aprovuar ne fund vitin qe shkoi. Unë këtu po e them atë qe është vullnet dhe orientim i joni, ne në çdo rruge qe nuk ka probleme me shpronësim jemi te interesuar qe në afat sa me te shkurte me interventu. Edhe për emërim te rrugës bëhet kërkesa dhe shkon përmes Kuvendit Komunal, por gjithashtu është bërë një komision qe i trajton rrugët qe janë pa emra, prapë ju lutem te vini dhe te na takoni edhe e diskutojmë ne Komunë këtë çështje.

AVNI BERISHA- përshëndetje të gjithëve, pata dëshirë qe te ishte Kryetari këtu.

ARBËR SADIKI-lirisht thuaje se te gjitha do ti përcillen Kryetarit, jemi duke mbajtur proces verbal.

AVNI BERISHA- krejt telashet me ndërtim, me prona, për këtë gjendje qe është lagjja jone, me herët e përmende edhe Vranjevcin e ka LDK-ja. Personi qe është Kryetar e përfaqëson kryeqytetin apo. Jemi nder lagjet me te vjetra ne Prishtinë dhe jemi lagjja qe nuk kemi transport publik. Aty ku banoj unë qarkullon linja 7, deri 22 ka autobus, prej Kolovice deri te Teatri bën 25 minuta me autobus, ditën e shtunë ka një here ne 2 ore autobus, ditën e diel nuk qarkullon asnjë autobus. Edhe për fat te keq numrin me te madh te votave çdo Kryetar e merr nga Kolovica. Diskriminim për mua është kur linjat publike te Komunës te shtunën e te dielën e bajnë qarkullimin pa bilete, a lagjja jone nuk ka as transport. Lagjja jone këtë nuk e ka meritu, është turp, na e dijmë qe vetëm ato 2 mandatë qe i ka pas

Shpend Ahmeti, krejt mandatet tjera i ka pas LDK-ja, ne të gjithë i kemi votu dhe sot nuk kemi as transport publik. Tjetra ne ndriçim publik qe 9 muaj nuk kemi, mas orës 19 nuk ka transport ,unë kam bërë ankese para 5 viteve se s'kemi autobusa, edhe marr përgjigje qe inspekcioni ka dal dhe ka konstatu qe të gjithë autobusat e linjës 7 qarkullojnë rregullisht edhe te dieleve. Inspektorat e autobusave te linjës 7 i ke të gjithë te korruptuar, inspektorat qe mirren me kontrollimin e artikujve ushqimore të gjithë janë te korruptuar, unë di raste e raste qe vijnë i shohin artikujt edhe asgjë. Tjetra, bashkëpunimi i Komunës, ujësjellësit dhe KEDS-it, pse nuk ka bashkëpunim, secili për veti vjen e punon e e len qashtu, a dilni ju ndonjëherë si Komunë ne vend te ngjarjes edhe me e pa çka bajnë, a e shihni rrugën qysh u ba, me dal me ec prej Plepave ta merr menja qe vullkanë ka përfundi. Është turp p.sh nesër me ardhë një kryetar prej Zagrebi, Ljubljanës, Tiranës edhe e sheh atë rruge, a dilni ju përtej sheshit te Prishtinës ndonjëherë me pa, ne lagjen Kolovica a dilni me pa  p.sh fëmija jem a ka ku luan, a muj unë p.sh. te shtunën apo te dielen me i hyp autobusit e me shku dikund. Ju jeni tu ba eksperimente me qytetaret e Kosovës, pse vjen një kryeministër ju e bllokoni krejt Prishtinën, vdes njëri n'kerr edhe nuk ka kah shkon. Tjetra anej ka qendra janë ba do vende për me dal me bicikell, a unë me dashtë me dal me bicikell duhet me marr bicikllen ne krah se s'kam kah me ec, me dal me fëmijë me karroce nuk ki ka me ec, se s'ka trotuar se është i bllokuar, a keni inspektor ju, bashkëpunim me policinë, autobusi te na, e ndal autobusin ku te don. Lagjja jone s'ka çerdhe, s'ka qendra për te moshuar, s'ka qendra sportive, s'kemi trotuare, ambulanten e keni ndërtuar por s'ka mjek aty, qe 23 vjet mas luftës nuk i kemi legalizu shtëpitë. Mu me vjen turp me i thane dikujt qe jetoj ne kryeqytet, Kolovicën e keni lanë anash shumë, nuk mbahet Prishtina veç me 2 lagje, edhe bashkëpunoni pak ma shumë. Faleminderit shumë.

MIMOZA SYLEJMANI-do te mundohem me tu përgjigj me aq sa kam informata për drejtoritë tjera se ne takohemi 2 here ne jave te gjitha drejtoritë, do te mundohem me i përmbledh te gjitha ne mungese te Kryetarit, Kryetari e dha arsyen pse shkoi, edhe pse ka pas shumë dëshirë te jete këtu se vet ka qene iniciativa e tij për këto takime. Vet fakti pse jemi këtu pas zgjedhjeve jemi ardhë për me ju ndëgju juve, për sa i përket transportit publik ke te drejte, bashkë me BERZH, Komuna e Prishtinës është duke i ridizajnu te gjitha linjat e trafikut urban, shumë shpejt do ti kemi edhe 30 autobusa shtese, tash i kemi edhe aksionaret e rinj, do te zgjidhet edhe bordi, shumë shpejt do te fillojmë me linjat e reja Për ndriçimin publik edhe këtu keni te drejte, i takon drejtorisë për Shërbime Publike, e cila qe 2 vite është ne OSHP, unë nuk e di a jeni të gjithë te informuar por OSHP-ja qe 2 vite nuk ka bord dhe Komuna te gjitha mjetet i ka te bllokuara. Prej 19 janarit unë, Arbëri dhe Kryetari e kemi marre mandatin dhe po mundohemi, për atë edhe jemi këtu, qe kur te ridizajnohet lagjja e juaj mos me ju qite juve para aktit te kryer, por ne jemi duke tentuar qe me i marrë te gjitha informacionet, shqetësimet nga ju për lagjen e juaj dhe mandej me fillu ne këtë proces. Drejtoria e Shërbimeve Publike bashkë me Prokurimin e kanë marre një hap qe te rishpallim tenderin e ri, se jo vetëm Kolovica por shumica e Prishtinës është ne terr për shkak te OSHP-se, sepse OSHP-ja zgjidhet ne nivel qendror. E dimë qe nuk ka çerdhe, por sot po ju jap një lajm qe ngjitur me shkollën "Eqrem Qabej", tashme është ne tender çerdhja e pare qe do te ndërtohet këtu. Gjithashtu një tjetër çerdhe qe është ne plan ne fushën e Pajtimi, projekti edhe gati, por ujësjellësi nuk i ka përkthyer tokat ende Komunës se Prishtinës, edhe këtë jemi duke tentuar me ba marrëveshje. E ceke edhe për bashkëpunimin jo te mirë me KEDS-in dhe ujësjellësin, drejtori i Investimeve Kapitale, Krenari është duke u takuar me ata ne baza ditore kisha me thane ne mënyrë qe ti koordinojmë punët qe deri ne 2023 mos te kemi këto lloj telashe te këtyre natyrave, kemi raste kur Komuna e ka shtruar rrugën dhe KEDS-i pas 3 javëve ka shku pa leje dhe e ka prish rrugën, ka punu aty, kjo nuk është në rregull se është taksa e juaj aty, taksa jone. Për policinë qe e ceket, Kryetari ka pas takim me ministrin Xhelal Sveçla, jemi ne bisedime, ne jemi te vetëdijshëm se sa inspektor i ka Komuna, është një numër jashtëzakonisht i vogël dhe është e pamundshme me i kontrrollu te gjitha, gjithashtu nuk kemi polici komunale siç e ka Tirana, Kryetari është duke u

përpjekur shumë, unë e di qe keni prite shumë, jemi te vetëdijshëm se edhe unë jetoj ne Prishtinë dhe përballem me te njëjtat shqetësime si te juajat.

IMER RRAHMANI-kryetar i bashkësisë lokale, dhe banor i lagjes-qytetaret e lagjes tonë ballafaqohen me shumë probleme, një prej tyre është rregullimi i çështjes pronësore, por për rregullimin e kësaj çështje Komuna e Prishtinës, një prej komunave te vetme e aplikon taksen e transaksionit dhe kjo e rëndon ekonominë familjare dhe është pengese për rregullimin e pronës. Për çudi njëjte paguan takse për një njësi 150 euro, dhe njëjte për pronën e trashëguar nga gjyshi si trashëgimtar i dorës se dytë, kjo është shkelje e te drejtave te njeriut. Me këtë standard qe jetojmë kjo takse është e larte dhe duhet te hiqet. Ne lagjen ku unë jetoj, Kolovica e Re 70% e banoreve jetojnë ne prona te trashëguara, e tash nipat e mbesat duhet te paguajnë taksen. Ju e dini qe këto probleme me pronësinë janë qëmoti, njerëzit kanë toke por nuk kanë mundur ta legalizojnë pronën, edhe ende këto probleme kanë mbet pa u zgjidhur, tani është barre edhe taksa e transaksionit. Nuk mund ti gëzojmë disa te drejta, nëse nuk jam pronar, nuk mund te realizoj te drejtën e pasurisë time. Ne rast se largohet taksa kjo ju jep mundësi qytetareve qe te bëhet rregullimi i pronave dhe krijon stabilitet.

ARBËR SADIKI-këtu e kemi edhe njërin nga asambleistët qe e kanë propozuar heqjen e taksës se transaksionit, ky ka qene një propozim qe është përkrahur prej të gjithëve, por ka mbet për çështje procedurale pa u vazhdu, dhe nuk është vetëm Prishtina qe e ka një takse te tille.

FISNIKU- përshëndetje të gjithëve unë ja Fisniku jam asambleist nga rradhët e LDK-se ne Kuvendin Komunal, problematiken e çështjes se taksës ne transaksion e kemi ngrit ne tri mbledhje rradhazi, ne takimin e fundit te asamblesë kemi kërkuar nga drejtoria e financave, e cila do ta trajtoj, analizoj dhe pasi ta bej një analize te saktë financiare do ta sjell ne Kuvend për miratim, ne jemi te interesuar shumë qe ti përkrahim interesat e qytetareve, ju faleminderit.

MUHAMET JAHIRI-përshëndetje të gjithëve, po shpresoj qe këto çka po i thuani te bëhen realitet, ai plani për çerdhen pothuajse është folur, unë lirisht muj me thane qe ka qe 10 vite qe nuk është investu as edhe një cent prej Komunës. Ky plani i çerdhes është nise shumë moti ne fushën e Pajtimit , ku është premtuar edhe një park, që nuk ka ndodh as njëra e as tjetra, aty shumë here bëhet deponi e mbeturinave, dhe gjithnjë rrezikohemi prej qenve endacak. Për sa i përket transportit urban unë pajtohem me parafolësin se janë gjëra reale, autobusët qe përdoren për linjën 7 janë te viteve te 70ta qe as nuk përdoren për me bajt ushqim te kafshëve e jo me transportu njerëz. Kur i sheh aktivitetet e Komunës se Prishtinës te mbushet mendja qe Prishtina e ka vetëm një emër e qe është Muharrem Fejza., ne jemi totalisht te përjashtuar. Sa i përket KEDS-it është një dukuri, përveç këtyre punimeve qe s'ka koordinim e qe janë dëmtuar shumë rruge, ata nuk janë te dakorduar as me kabllovik. Tjetri problem këtu është uzurpimi i hapësirave publike, problem qe duhet me u zgjidh prej Komunës, nëse s'mundeni me ju ba zgjidhje parcelave privatë se paku parcelave te juaja mundeni me ju ba zgjidhje, unë besoj qe edhe ky vendi ku ka qene pjese e ujësjellësit por ka arrite me u ba marrëveshje dhe është ndërtuar kjo shkolle, prandaj mos te neglizhojmë e te gjejmë arsyetime, e ne mandatë kur te premtoni qe bëni çerdhe ta bëni, e jo ne te shkojmë për çerdhe ne lagje tjera e me i lute qe ma na pranu fëmijët atje. Këto çka po i themi janë gjëra emergjente a sa i përket planit urbanistik besoj qe ndërtohet prej politikave brenda Komunës por te paktën këto gjana ti merrni si prioritet, ju faleminderit.

MIMOZA SYLEJMANI- për çerdhen ne fushën e Pajtimit ju thashë qe jemi ne proces te marrëveshjes, a për çerdhen këtu është ne tender, ju siguroj qe shumë shpejt do te bëhet. Ne e dijmë, jemi duke e diskutuar qe sa me Ministrinë e Arsimit, për mungesën e çerdhes këtu.

ARBËR SADIKI-desha me u lidh me punën e transportit, ju thamë me herët qe ne jemi ne proces shumë serioz me BERZH-in për punën e transportit, që nuk është i integruar ne krejt qytetin e Prishtinës,

transporti nuk funksion linjë pas linjë, nuk është krijuar ende plani i mobilitetit. Aty ku jetoj unë është e njëjta gjë, hypni te 6shi dhe e shihni qe nuk është ndryshe nga linja e juaj, është autobus qe ja ki friken me e pa ne rruge e jo me hyp ne të. Por këto nuk bëhen brenda ditës, janë te rralla linjat edhe për pjesën e Arbërisë, është lagjja ku jetoj edhe unë vet, e kemi te njëjtin hall, ne jemi ajo kategori e drejtoreve qe nuk jetojmë ne far luksi, jetojmë bashkë me juve, njëjte si ju, ne po përpiqemi me i zgjidh hallet te cilat na preokupojnë edhe vet neve. Por ne po mundohemi me i zgjidh këto probleme ne tërësi, ne mënyrë te integrume ,edhe pikërisht mendojmë se ne i kemi këto probleme sepse janë zgjidhur aty për aty, pa analize, dhe një problem i vogël i zgjidhur i ka krijuar edhe 15 probleme tjera. Nuk jemi duke shpik ndonjë te re, ashtu siç funksionojnë te gjitha qytetet qe ju i përmendet, Zagreb e Lubljanë qe janë qytete qe ne vazhdimisht jemi ne kontakt për ti marre praktikat e tyne më të mira qe me funksionu edhe ne si gjithë vendet tjera, por nuk po duam te improvizojmë , qe për shkak te nxitimit me ba projekte qe nuk kanë sens, e  ne ciklin e madh duhet me u lidhë qe me funksionu qyteti ne tërësi.

FITIM JUSUFI- banor i lagjes, rr. Haxhi Zeka, kjo pjesa jone ka mbet as andej as këndej, ne planin rregullativ te cilin e keni ne plan me e ba, përveç këtyre problemeve qe i cekën banoret e tjerë, a keni ndonjë ide se çka do te bahet apo jeni ne fazën fillestare, ju folët edhe për koeficientet, normal qe është interes i juaji se jemi me afër qendrës, por saktësisht a keni ndonjë propozim. Na jemi si ne mes, jetoj 500 metra prej shkollës teknike, edhe s'kemi as hapësira publike, s'kemi kurgjo edhe ne krejt banoret e kësaj pjese jemi te interesuar për atë zhvillimin qe ju e përmendni, se lagjes sonë i mungon shumëçka, po i shohim lagjet tjera jashtë Prishtinës qe i kanë te gjitha, plus jemi me afër qendrës edhe jemi mbet me koeficienta qe normal ne s'kemi llogari me ba diçka. Unë mendoj qe është zgjidhje me u ba ndërtim i larte.

ARBËR SADIKI- qëllimi i shfrytëzimit te një zone te caktuar, duhet me u pa ne mënyrë te integrume, jo ndamas, ju vet e thatë qe po zhvillohet periferia e Prishtinës , por jo qendra, pikërisht për arsye se është punuar ne mënyrë parciale, planet rregullative te cilat i kemi ne fuqi janë me kufinj rigoroz, shpesh aty ky përfundon një plan rregullativ  dhe fillon një plan i ri ndarjet dhe dallimet janë aq te mëdhaja sa nuk kanë kurrfarë sensi për shkak se janë hartuar ne kohe te ndryshme, ne vite te ndryshme e për interesa te ndryshme etj. etj. Hartën Zonale qe ne po e përmendim është një hartë qe është e integrume për gjithë qytetin, ajo kur hartohet, hartohet brenda gjithë kufinjve te zonës urbane ekzistuese. Arsyeja pse bahen te tilla është pikërisht për me i balancu lagjet qe janë afër njëra tjetrës e jo me i nda, normal qe secila lagje i ka karakteristikat e veta, se s'mundet gjithë Prishtina me e pas një koeficient. Arsyeja pse ne jemi këtu është për me e vlerësu token si kapital, nuk jemi këtu për me ju thane se këtu kemi me e ba gjelbërim edhe ty qeshtu te ka ra edhe bën çka te duash, jo, nëse ne plan përcaktohet një zone gjelbëruese ose një çerdhe apo shkolle, me u llogarit se pjesa e asaj toke kompensohet me koeficientin e njëjte. Ky është plani ekzistues urbanistik i Prishtinës (tregon hartën) aty ki me shumë se 100 p.sh. pika te theksume ku kemi me vendos shkolla dhe çerdhe, kur duam te investojmë p.sh. nuk e ke as edhe një vend te lire, për shkak se veç është qite një shenjë, kurrë nuk është analizu se si mundet ajo pjese me u shpronësu, edhe ne sot kemi mjete edhe te nivelit qendror edhe prej donatoreve edhe s'kemi vend për me e ba shkollën, e sikur te ish punu ne mënyrë te integrume ne tere territorin e komunës kish qene shumë me lehtë me i balancu këto problematika.

FITIM JUSUFI-unë mendoj qe jemi te diskriminuar, me qene 500 metra larg qendrës edhe me mbet kështu, s'di, për atë e thash me herët qe ndërtimi i larte kish me liru hapësira për me i pas krejt edhe ne, çerdhe e hapësira te gjelbërume , rruge me te gjëra, për atë e bana pyetjen po me qeto çka i pash prapë njëjte doni me na lanë prapë qeshtu.

ARBËR SADIKI- për me ju lanë qeshtu atëherë pse kemi ardhë sot, ne jemi zyrtare te Komunës qe kemi obligim ndaj secilit, s'kemi ardhë as me ba politike, as fushatë, kemi ardhë me i pa problemet reale, te

dytë këtu jemi persona ne cilësinë e ekspertave, te dytë jemi inxhiniera te arkitekturës, qe pretendojmë qe e kemi një ekspertizë qe mundemi me e nda me tjerët, e për me nda ne duhet me i pas informacionet e sakta qe me mujt me e zhvillu, nuk ka me pas plane te veçanta për lagje te veçanta. Harta Zonale parashihet me ligjin për planifikim urban prej 2013-tës dhe sot jemi ne 2022-tën dhe ato akoma nuk janë bërë. Për me i zhduk Këto parregullësi mes një plani rregullativ me një plan rregullativ tjetër, parashihet  Harta zonale e cila e trajton gjithë territorin urban dhe rural.

GEZIM KRASNIQI- rruga për fshatin Butofc është e prishur, pse nuk po shtrohet rruga andej.

ARBËR SADIKI-kjo është pyetje qe i takon Drejtorisë për Investime Kapitale, e thash edhe me herët, por e di qe Kryetari e ka ne plan edhe pjesën e Butofcit, e kemi thënë edhe me herët qe plani është qe edhe fshatrat te jene te përfshira, vendbanime qe e pasurojnë jetën e qytetit, e sidomos Butofci qe pozicionin e ka te tille qe është jashtëzakonisht premtues.

AVDULLAH DUSHI-banor i lagjes, halle kemi të gjithë, po ne këtu kemi shumë, qe 60 vite jetoj këtu , kam aplikuar 2 here për leje urbanistike. I kam 30 ari oborr, bashkë me djem te axhallarëve gati 500 ari, tash me një koeficient 1.2 s’po di, me një koeficient më të mirë p.sh 1.8 ndoshta ishim marre vesh, Ramën për qata e kemi votu, se është inxhinier e ndoshta me atë mundemi me bashkëpunu.

NAZIM DEMOLLI- po e shoh qe problemi me i madh ne tere këto çka folëm është te shpronësimi, çka do te ndërmerrni ju për qellim për dallim prej qeverive tjera ne këtë pike.

ARBËR SADIKI-kur flasim për rigjenerim urban, nevoja për rigjenerim urban ka lind pikërisht ne ato lagje ku kanë pas problem me pronën. Komuna nuk e bën rregullimin e çështjeve te pronës, atë e rregullon ligji për kadastër ne nivelin qendror qe e sheh saktë se si bartet prona prej njërit te tjetri, ne jemi këtu për me ju thane qe me mekanizmat qe i lejohen pushtetit komunal me i zgjidh këto probleme. Këto mekanizma kanë te bëjnë me rigjenerimin urban, ku ti merr një zone p.sh. komplet, bashkohen të gjithë ata bashkë për një interes te përbashkët dhe grumbullohen në njësi banesore kur e realizojnë atë interes por si pronare me letra, me interesin shtese i cili mund te diskutohet deri ne masën kur e cenon interesin publik. Sot veç është fillimi i takimeve, herës tjetër kemi me ardhë me projekt, me harta me i diskutu me secilin pronar, edhe ulemi dhe bëjmë një zgjidhje duke i kalkuluar te gjitha këto, gjithmonë me një bashkëpunim mes veti.

PETRIT AVDULLAHU-banor i lagjes, prezantimin qe e thatë me herët thatë qe i keni 3 plane, cila do te jete Kolovica ne te ardhmen.

ARBËR SADIKI-ne po flasim për Kolovicën e cila është brenda planit urbanistik zhvillimor momental qe është kjo këtu(tregon hartën)

PETRIT AVDULLAHU- desha te pyes edhe për unazën, ka lëvizje ne Kolovice ka do ti bjen.

ARBËR SADIKI-unaza deri tash ka qene vetëm një gjurme e qitne në hartë prej 2006-tes edhe me kurrë nuk është bërë projekt. Jemi duke e bërë projektin bashkë me BERZH-in projektin zbatues për unazën, gjurmën pothuajse e kemi përcaktuar fiks, tash për tash një prej daljeve është pikërisht ne Kolovice, këtu( tregon hartën), gjurma ka me mbete andej nga ka qene, mirëpo dalja i jep jashtëzakonisht shumë zhvillim Kolovicës.

PETRIT AVDULLAHU-spitali i qyteti është përmend edhe ne fushatë, a është ndonjë ne plan ne Kolovice

ARBËR SADIKI-janë tri lokacione për spitalin e qytetit, një nder to është edhe Kolovica por nuk është ende e definuar saktë. Janë ne diskutime.

PETRIT AVDULLAHU-edhe stacionet e autobusit ne Kolovice te gjitha janë ndalesa ne rruge, nuk ka vend te destinuar për stacion.

ARBËR SADIKI-e thash edhe me herët, mjetet janë por nuk i japin pa u rregullu këto çështje, në momentin që ne, me një plan te saktë i përmbushim këto çështje, pjesë e këtij mobiliteti qe jemi duke e bërë me Bankën Botërore është edhe rishikimi i stacioneve te autobusit. Çdo ndryshim ne fillim te prek ne mënyrën e përditshme qysh jemi mësuar te jetojmë por me kalimin e kohës e sheh qe ka me qene shumë ma mirë.

MASAR DUSHI-arkitekt me profesion, e përfaqësoj Shoqatën e Arkitektëve te Kosovës. E vlerësoj shumë nivelin e debatit qe është duke u bërë. Ne e përfaqësojmë mendimin kritik, mendimin e trete këtu. Plani zhvillimor komunal është dokumenti kryesor i Komunës se Prishtinës. Kolovica ka shumë emërues te përbashkët me Kodrën e Trimave, prona te ngjashme, bile unë kisha sygjëru qe te trajtohen bashkarish këto dy lagje. U cek edhe spitali, unë jam kundër asaj qe spitali te jete afër qendrës, se ideja është qe te shkarkohet qendra jo te ngarkohet. Ky plan qe po e shihni ka qene pak para aprovimit, mirë qe nuk aprovuar. Rivlerësimi dhe rishikimi i kësaj kjo është metoda me e mira nga baza, sa me shumë qe ka debate e përplasje këtu me pak do te këtë telashe ne te ardhmen. Këto gjëra lypin kohe dhe durim për me dal diçka e bukur ne fund. Ju faleminderit.

MIMOZA SYLEJMANI- ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen, ju kërkoj falje edhe njëherë ne emër te Kryetarit, me kaq po e mbyllim, shihemi ne takimet e radhës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 06/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Avdullah [illegible] | 045 402 499 | [signature] |
| 2 | | | |
| 3 | | | |
| 4 | | | |
| 5 | | | |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 06/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muharrem Zeka | 049 821 986 | [signature] |
| 2 | MASAR DUSHI [illegible] | 049-505-256 | [signature] |
| 3 | Nazim Demolli | 044 721 463 | [signature] |
| 4 | Muhamet Jahiri | 044686682 | [signature] |
| 5 | Alban Merkulaj | 049605380 | [signature] |
| 6 | Kastriot Krasniqi | 044106568 | [signature] |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 06/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | AUNI BERISHA | 045 693 683 | [signature] |
| 2 | [illegible] | 044 627 560 | [signature] |
| 3 | Petrit [illegible] | 049 747 008 | Shegiri |
| 4 | Abdullah Shegiri | | [signature] |
| 5 | Serdail Gashi | 044 5747 20 | [signature] |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 06/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | NAZIMI HYSENI | NAZIMI.HYSEN.QRKS-... | |
| 2 | Mustafë Krasniqi. | m.krasniqi62@gmail.com | |
| 3 | HABIB KRASNIQI | 044-202691 | |
| 4 | LULZIM BUNJAKU | 044500707 | |
| 5 | Atdhe Demolli | 049 870 445 | |
| 6 | FISNIK OSMANI | 044 270 440 | |
| 7 | ILIR DUSHI | 044 260 996 | |
| 8 | Fitim Jusufaj | 049 424 382 | |
| 9 | GEZIM KRASNIQI | 044 233-458 | |
| 10 | Ylli Demolli | 044 977 690 | |
| 11 | Miftar Mazgani | 045524740 | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

PRISHTINA

**KOMUNA E PRISHTINËS**

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 4

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**09 qershor**, në SHFMU “Mitrush Kuteli”, duke filluar nga ora **16:00 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale, si dhe lidhur me problematikat e lagjeve.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Donjeta Sahatçiu - Nënkryetare e Komunës
3. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
4. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit

## 3. PROCESVERBALI

ARBËR SADIKI-përshëndetje të gjithëve, jemi në proces te rihartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimit të Hartës Zonale për Komunën e Prishtinës. Ju e dini qe Harta Zonale është një dokument planor qe për here te pare po bëhet edhe pse e sheh Ligji për Planifikim prej vitit 2013. Kusht për me e hartu një Hartë Zonale është fillimisht te aprovohet Plani Zhvillimor Komunal i riu. Jemi ne proces, edhe ligji për planifikim e parasheh edhe disa manuale qe janë zhvilluar me USAID-in e mbështesin, qe Plani Zhvillimor dhe Harta Zonale me u zhvillu ne te njëjtën kohe, sepse njëra- tjetrën pak a shumë e plotësojnë. Jemi këtu me juve jo vetëm pse edhe e parasheh ligji por jemi këtu sepse mendojmë qe diskutimi publik nuk është vetëm çështje protokollare por është çështje përmbajtësore. Sot po e fillojmë dhe mendojmë me ardhë edhe shumë here te tjera deri ne përpilimin e këtij drafti, me diskutu realisht për problemet qe ekzistojnë dhe me i diskutu bashkë mundësitë se si mundemi me i zgjidh ato. Edhe ne takimet e mëparshme kemi pas ndoshta ankesa se pse s'kemi ardhë me një propozim. Ne mendojmë qe pikërisht gabimet janë bërë, qe hapi i pare i diskutimit ka qene me propozimet qe kanë ardhë prej vet Komunës. Planet e mira bëhen kur baza, problematikat te gjitha ato çështje qe duhet te trajtohen duhet te vijnë fillimisht prej diskutimeve me publikun. Për atë ndihuni te lire për çka do qe ju mendoni se ne duhet me e dite ne këtë proces te bërjes se këtyre dokumenteve. Zona e juaj e dini edhe ju vet se çfarë problematikash ka, ndoshta jo veç për shkak te planit qe ka ekzistu por me shumë për shkak te mënyrës se si është implementu, qe ja këtu p.sh(tregon hartën) Mati 1 e precizon saktë qe çdo bllok urbanistik me u zhvillu ne tërësi. Kjo nuk ka ndodh dhe ka fillu me u zhvillu ne mënyre pjesore dhe ky zhvillim mandej e ka kriju këtë kualitet te cilin ne e kemi momentalisht ne

Mat. Shumicën e rasteve janë dhënë leje ndërtimore duke marre parasysh edhe rrugën e planifikuar edhe rrugën ekzistuese, edhe tani kjo pjese vlon nga rrugët sepse duke u zhvilluar pjesërisht është dashtë me lënë funksionale edhe rrugën qe është ne terren e qe është dashtë me u mbyll ne momentin qe kryhet blloku edhe ne anën tjetër është dashtë me lënë sipërfaqe edhe për rrugën e planifikume, dhe kjo mandej e ka zvogëlu hapësirën për gjelbërim e për gjithçka. Nuk kisha vazhdu me shumë se ju veç i dini këto, sot ne kemi ardhë me shumë me ndëgju, e ne takimet e radhës ne do te vijmë me letra me harta te shtypura me mundësi qe me e diskutu secilën pjese konkretisht dhe cilat kanë me qene skenarët e zhvillimit.

BEHAR SELMANI-banor i lagjes, arkitekt- përshëndetje të gjithëve, ne këtë rast unë prezantoj jo vetëm pronën time ku banoj ne Matin 2 por i përfaqësoj edhe pronaret e një sipërfaqe prej 5 hektarëve. Deri tani ne kemi qene te diskriminuar duke na lënë me një koeficient shumë të ulët. Me një vendim te ish-kryetarit Shpend Ahmeti, pjesa e Matit 2 është lënë me koeficient 1.2 e deri te ky përrua (tregon në hartë) që e ndan kufirin me Matin 1 dhe Matin 2, ndërsa koeficienti sipas planit rregullativ në Matin 1 është 2.4. Në të gjitha takimet qe i kemi pasur me zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit na është thënë arsyetimi se nuk dojnë me i ndërpre vizurat që janë drejt Zllatarit, ama për ironi si të dalim në rrugën kryesore ato vizura i prish Marigona Hill-i me ndërtesat e larta qe kanë filluar me u ndërtu, andaj ne banorët e Matit 2 kërkojmë që të rishqyrtohet, dhe të bëhet rritja e këtij koeficienti sepse ekziston infrastruktura, ekziston edhe infrastruktura sociale duke përfshirë shkolla, çerdhe mandej edhe Qendra te mjekësisë Familjare dhe urojme qe do te ndëgjohet zëri ynë edhe nuk do te bëhen gabime siç janë bërë nga udhëheqësit paraprake, faleminderit.

ISMET HAZIRI-banor i lagjes, sekretar i Bashkësie Lokale VII/2, unë po i paraqes kërkesat e banoreve, kemi te bëjmë me shumë me banoret e Zllatarit dhe Matiqanit. Unë si sekretar kam përgatitur me shkrim qëndrimet tona. Problemet qe i ka bashkësia e VII/2 lokale janë evidente nga vet fakti se ka një shtrirje te gjerë me numër te madh te banoreve, me shtrirje te shumta infrastrukturore, e te kërkesave te mëdha sociale e shoqërore. Kemi rruge te ngushta me kapacitete te vogla kanalizimi dhe pa kanalizim fare, furnizim te dobët me ujë te pijshëm dhe pa ujë fare, transport jo te mirë publik qe është Zllatari, mungese te shkollave qe është Mati 1, mungese te çerdheve. Po filloj me Zllatar , pas shtrirjes se rrjetit te ujësjellësit mbetem pa rruge , fatmirësisht jemi ne proces te ndërtimit te rrugës, dhe shtimit te rrjetit te ujësjellësit, por duhet te përmend bujarinë e pronareve te tokave ,nga restorant Panorama deri te restorant Kulla e Shqiponjave te cilët e kanë dhënë token e vet pa kurrfarë kompensimi. E kemi edhe një problem me legalizimin te varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre, kemi një kërkesë nga banoret me një çezme, qe quhet çezmja e Zllatarit qe te kthehet ne funksion, te sistemohet gjelbërimi dhe te kthehet rekreacioni, pushimi ne atë zone. Kemi problemin e gjerësisë se rrugës nga shkolla ku jemi tani, deri te Panorama qe është vetëm 5.5 metra qe pengon qarkullimin e automjeteve me tonazha te larta.

NAFIJE GASHI-jam këtu si përfaqësuese e Këshillit te Prindërve te shkollës ILIRIA. Para 1 muaji ka ndodh një aksident ku është lënduar një fëmijë, e kemi një kërkesë për Kryetarin qe te bëhet sinjalizimi rreth shkollës, mundësisht ndalimin e parkingjeve rreth shkollës dhe vendosja e rrethojës. Gjithashtu shkolla ka qene ne program për renovim dhe qe 10 vite nuk ka as edhe një investim ne shkollën tonë, një problem shumë i madh për fëmijët qe e frekuentojnë shkollën tonë është edhe linja 4 e autobusit e cila kalon ne një pike shumë te ngushte me shkollën e shpeshherë nuk mund te kthehet dhe kjo shkakton edhe aksidentin. Pothuajse çdo muaj autobusi linja 4 te shkolla" Iliria" e ka nga një aksident. Ju kisha lutë juve qe rrugën B ta vazhdoni, te rrethi te xhamia , aty janë vetëm 800 metra pa shpronësu edhe kish me e liru një fyt te ngushte qe bëhet rreth shkollës edhe për gjithë banoret kish me qene një akses shumë i mirë. Ju faleminderit.

NAILE GASHI- stomatologe- po i ndëgjoj me vëmendje diskutimet, arkitekti ne fjale doli dhe foli me herët për punën e koeficienteve qe me u ngrit ne Matin 2, edhe unë jam banore e Matit 2 dhe ne nuk jemi te pajtimit me u ngrit, tek ne është e lejume 1.2, jemi te mendimit qe te vazhdohet me atë koeficient, janë lagje te banueshme me shpija private, ne jemi popull qe kemi ik prej qytetit prej tollovisë prej ndërtimeve te larta e me ardhë e me u ngulfat këtu prapë nuk po me duket e drejtë, Edhe një shqetësim tjetër e kam, lagjja qe është ne ndërtim e sipër qe është Kodra, që lidhet me Sofalinë ka dëmtuar kogja shumë, gjithë dheun që e kanë shkarku aty te Kodra dhe e kanë bërë kogja njëfarë ndotje, dhjetëra here inspektorati është lajmëruar dhe kanë leju një veprim te tille, çka mua me intereson mos është qellim apo projekti i Komunës, qe Kodra me u vazhdu edhe me dëmtu deri ne at mase duke e ditur qe ato janë mushkëritë e Prishtinës.

LUMNIJE GASHI- arkitekte, koeficienti te mos mbetet dëshirë e qytetareve, ta trajtoni profesionalisht çështjen e koeficientit, kam disa kërkesa, këto kërkesa i kam dorëzuar edhe me shkrim ne forme peticioni qeverisjes se mëparshme, po i paraqes edhe këtu,1)te bëhet ndriçimi publik ne rrugën “Mitrush Kuteli” se po kemi problem mandej edhe me qentë endacak, 2)rregullimi i ndalesave te autobusit, stacioneve, 3)te kemi gjelbërim përgjatë rrugës, ne pjesët ku mundet me u ba.

NASER GASHI- për vazhdimin e rrugës B, është rruge jetësore për Matin dhe një pjese te Prishtinës, e kam edhe një porosi prej banoreve te Butovcit, qe te caktoni një datë, për një takim kur te doni ju. Faleminderit për mënyrën se si po punoni, qe po i merrni ne konsideratë kërkesat e qytetarëve, ju faleminderit.

NEXHAT HAPAJ-banor ne rrugën Zara kam aplikuar për legalizim te pronës, e kam paguar taksen, urbanizmi e ka lëshuar certifikatën e legalizimit, mirëpo kadastri nuk ka dite me e regjistru një pjese tarracë te shfrytëzueshme. Qe 2 vite nuk ka asgjë, kam qene ne Ministri te Ambientit, kam qene ne Urbanizëm qe sipas atyre çdo gjë është në rregull, tash m’ka ardhë një letër qe thotë qe duhet me i shenju linjat, qe nuk kalojnë ne pronën time, shihet edhe ne fotografi, dhe me kanë thënë me e heke tarracën, e kam një afat kohor 60 ditor. Kam shkruajtur shumë emaila, kam lyp shumë here takime, nuk është zgjidhur ky problem. A ka Komuna ne plan me i rregullu këto çështje te tarracave te shfrytëzueshme.

KADRUSH LATIFI-jam përfaqësues i banoreve kompleksi ARKOS te shkolla Mileniumi. Kompleksi ARKOS është i pajisur me leje ndërtimore, dhe me pranim teknik. Parcela ku është ndërtuar kompleksi ka qene dikund 78 ari, 34 ari janë pajisur me leje ndërtimore ndërsa 43 ari kanë mbete jashtë parcelës ndërtimore. Banorët qe disa here kanë dale dhe e kanë thurur atë pjesën e mbetur jashtë parcelës ndërtimore. Me Plan rregullativ thuhet që ajo pjesë me leje dhe kushte ndërtimore i takon infrastrukturës, ose pjesës se rrugëve. Ne kemi bërë kërkesë pranë drejtorisë se Urbanizmit, drejtori i Urbanizimit bashkë me banoret kanë pasur një takim, ku pronaret kanë thënë qe nëse shpronësohet parcela jashtë tokës ndërtimore ne do ta bllokojmë përsëri , edhe vazhdohet vazhdimisht , edhe pjesa rreth ndërtesës ka mbet si ishull dhe është e bllokuar prej banoreve. Ju kisha lutë qe pasi ne përgjigjën prej drejtorit te Urbanizmit qe kjo pjese i takon drejtorisë se Pronës për shpronësim, është shumë e vërtete, por ju kisha lutë qe urgjentisht ta zgjidhni këtë çështje, qe ne te mos kemi probleme.

FATMIR AZEMI-unë kisha pas dëshirë me ju pyet të gjithëve këtu cila lagje i plotëson kushtet e banimit, këtu, asnjë, ku me jetu, secili kërkesat ne veti, unë kam një kërkesë qe te ndërtohet por ti kemi kushtet elementare për një jete te shëndetshme, jo vetëm koeficient, por vlera. Ne Prishtinë nuk ke ku me jetu.

NEHAT TOLAJ-unë jetoj ne rrugën Loshi, te ai prroi i vogël afër lagjes qe po ndërtohet Kodrina, kanalizimet aty te gjitha janë ne sipërfaqe, kundërmojnë tere kohës, një grope qe e kanë hapur ata qe

po ndërtojnë, është e pamundur jetesa për ne qe i kemi shtëpitë aty. Tani po flas si kryetar i këshillit te shkollës, lagjja Matiqani nuk e ka as edhe një vend ky fëmijët tanë munden me luajt, është një salle e mbyllur qe përdoret nga nxënësit kur janë ne shkolle, është edhe një fushe jashtë, edhe rreth asaj fushe ka hapësirë te Komunës qe mundet me u kthy ne park e pjese me lodra për fëmijë. Për ne qe jetojmë në Matiqan rrugët i shfrytëzojmë për me ec edhe për me lujte, pra ju kisha lutë qe te e bëni një zgjidhje qe edhe fëmijët tanë te kenë një pjese ku mund te argëtohen..

HALIL GASHI-ne pjesën ku jemi ne 500m 1 km( afër ambulantes) jemi banoret me te vjetër te Matiqanit dikund 150 vjet. Tokat tona qe i kemi pas janë kanë kah rruga B, krejt janë shitur, edhe atje sa kam kuptuar është lejuar ndërtimi i larte, pse neve këndej nuk po na lejohet, edhe ne duhet me pas diçka ne krahasim me tjerët, kemi mbet nëpër do shpija te vjetra, kisha me e lutë Kryetarin qe kur ti bëni Harta Zonale e Planin te na keni parasysh, ju faleminderit.

HYSEN SHILLOVA-banor i ZLLATARIT- kam vetëm një pyetje çka po ndodh me Zllatar, e fillojnë një punë e nuk e kryejnë, nuk kemi ujë, gypi është edhe nuk lidhemi, kush po e stagnon punën andej, as s'kemi autobus ,as ujë e as rruge, kurgjo , edhe ne jemi banor te këtij vendi, faleminderit.

ABDULLAH KRASNIQI-kryetar i bashkësisë lokale VII/2, kisha me u lidh me Zllatar , kryetar nëse ju kujtohet qe keni qene ne Zllatar, e keni pa edhe keni thënë qe rruga e Zllatarit vetëm për njerëz nuk qenka, kërkesat tjera veç i tha sekretari i bashkësisë lokale, unë vetëm te përgëzoj për punën edhe vazhdo kështu.

SHERIF VRAJOLLI-unë ndëgjova shumë këtu, jam adhurues i sportit, kemi shumë te rinj këtu, ju kisha lutë qe te investoni ne një fushe sportive, ju faleminderit.

ENDRIT GASHI-kamionat e kompanisë se ndërtimit Pozhegu e kanë dëmtuar rrugën shumë, ju kisha lutë qe rruga te rregullohet dhe te shtrohet deri ne Butofc.

AGIM MALIQI- banor i Mati 1, koeficienti me plan rregullativ me del qe është 2.4, kështu kur ti dorëzoj dokumentet është 1.2 ose 1.6, qe tri vite asnjëherë nuk m'del me shumë, po du me e dite ku është problemi dhe kur rregullohet kjo, ju faleminderit.

MELOS MORINA- kam toke këtu dhe ju keni thënë gjatë fushatës qe për 9 muaj do te bëhet Harta Zonale dhe Plani rregullativ, a ka diçka, a jeni afër se prona ime është 20 ari dhe ka mbet krejt gjelbërim, a përreth është ndërtuar.

BESIM SELIMI- banor i Mati 2,rruga C qe vazhdon deri te rruga A, jemi si ne mes, ka ndërtesa deri ne 12 kat a neve nuk na lejohet ndërtimi.

BLEAR SELMANAJ-banor i lagjes, kemi problem me leje te ndërtimit, jemi peng i një vendimi qe është lëshuar, sepse me plan rregullativ lejohet vetëm ndërtim i mesëm, edhe po ndihemi te diskriminuar. Jam duke folur ne emër te pronareve te 5 hektar toke aty, qe shtrihen ne pjesën e pare te rruga Sokol Copi.

ISMAIL AJVAZI- banor ne Mati 2, ju kisha lute qe koeficienti 1,2 te rritet, kam bërë eshë kërkesë me shkrim,( te bashkëlidhur e gjeni kërkesën me shkrim, dhe peticionin)kam qene disa here edhe ne Komunë dhe jam takuar me zyrtaret kompetent por ende asgjë.

ISMET HAZIRI- rruga Afërdita është afër kësaj lagjes qe po ndërtohet City Hall, dhe shtrihet tërësisht ne pronën time, unë nuk e kam penguar qarkullimin e njerëzve andej, unë nuk jam i interesuar për shpronësim por për këmbim.

HALIL GASHI- kërkesë, kryetaret e bashkësive lokale te rizgjidhen, qe 9 vite janë kryetaret e njëjte.

ARBËR SADIKI- u përmend rruga B ,për vazhdimin e rrugës B jemi ne takim me pronaret e tokave, qe ajo rruge me u lidh deri te pjesa e Xhamisë , është marre edhe një vendim i veçante nga Kryetari qe me u shpronësu deri ne 35% te hapësirës qe mirret për rruge qe me pas mundësi me u zhvillu rruga, se përndryshe me vendimin ekzistues ne 20% është e pamundur me u rregullu. Për sa i përket koeficientit, po ju jap vetëm një statistike qe e kemi kalkuluar prej se kemi filluar me u marr me thellësisht, nëse realizohet PZHU-ja ekzistuese me gjithë koeficientet qe i parasheh, parashihet me i pas 54 milion metra katror banim, po ta pjesëtosh me 45 m katror sa është mesatarja për Bashkimin Evropian i bie qe Prishtina të jetë me 1 200 000 banore, dhe ne e dijmë qe asnjë projeksion nuk na qon në ato drejtime. Për atë edhe jemi këtu qe me diskutu me juve, me i analizu qe me ba plane reale për zhvillimin e Prishtinës e jo me funksionu vetëm mbi bazën e koeficientit. Për sa i përket legalizimit, mundeni me ardhë çdo te marte dhe te enjte ne Komunë me i diskutu, edhe pse ne rastin konkret kisha dashtë me ju përgjigj qe nuk është ne kompetence te Komunës, për fat te keq kur është bërë ligji për legalizim i parasheh vetëm 2 lloje te funksioneve qe është afarizëm dhe banim, jemi duke punuar ne këtë drejtim qe edhe këto nënkategori me u fut ne kadastër se edhe ato janë pjese e pronës. Problemi i Arkosit situata aty ku pjese te rrugës te cilat nuk kanë mujt me u bart te koeficienti i ndërtimit për shkak te 20% qe është si kufizues, rruga ka mbet edhe e pa shpronesume edhe e parealizueme si koeficient. Ne jemi duke punuar se bashku me drejtorinë e Pronës qe me i shpronësu këto pjese te rrugës. Mundësitë e shpronësimit janë dy, ose duke i vlerësu dhe pagu ose duke ia dhënë mundësinë me ndërtu dikund tjetër. U fol edhe për autobusat, ne jemi ne hartim te një plani te mobilitetit bashkë me Bankën Botërore qe kjo zgjidhje me u ba ne tërësi ne krejt Prishtinën, e jo pjesë-pjesë, për një rezultat më të mirë. Për sa i përket mospërputhjes se koeficienteve mes PZHU-se dhe Planit rregullativ, i kemi te përditshme këto probleme, pikërisht për atë po duam me i pasë Hartat Zonale qe kishin me i rregullu këto parregullësi.

KRYETARI- ju faleminderit të gjithëve qe keni ardhë qe se bashku mendojmë për me e ndërtu te ardhmen e kryeqytetit. Prej aspektit profesional unë mendoj qe ne duhet me e zhvillu dhe ndërtu Prishtinën duke krijuar vlere shoqërore. Vlere shoqërore është hapësira ku ne jetojmë, duhet me na mundësu kushtet e mira për jetese, duke filluar nga ambienti ku jetojmë deri te hapësira qe na rrethon, çerdhja shkolla, rrugët, parqet, qendrat e mjekësisë familjare, qendrat rekreative, qendrat për te moshuar te gjitha këto. Nëse e marrim vetëm koeficientin si parametër nuk na qon askund, janë bërë gabime gjatë zhvillimit te Prishtinës p.sh rruga B është një pjese ku është stërngarku dhe tani njerëzit dojnë me ik prej aty për shkak te pamundësive për me e ba një jete te mirë, nuk i plotëson kushtet bazike për jetese. Ne zonën këtu te Matit ende kemi mundësi për zhvillim, për me kriju një hapësirë te mirëfillte me vlera shoqërore. Koeficienti ta jep metrin katror por nuk ta jep vlerën. Metrit katror i rritet vlera ne relacion me kontekstin ne relacion me shërbimet qe ofron ai vend. Ne momentin qe ne e zhvillojmë këtë pjese, e bëjmë vend te jetueshëm e me vlera, këto janë elementet kyçe, parametrat qe ne jemi duke i marre parasysh qe ne, tani e tutje te krijojmë vlere e jo vetëm metra katror. E kur krijojmë vlere ai metër katror bënë shumë me shtrenjtë se dikund ku koeficienti është 2.4 p.sh, vlera e mund koeficientin. E përmendi edhe drejtori me herët, qe ka aq shumë metër katror sa qe planifikohet për 1.2 milion banore. Mund ta marrim shembull Detroit ne Amerike, ka vdek qyteti, d.m.th.-ne vdes qyteti dhe mundësia investive, se e ki koeficientin por s'ka ekonomi, s'ka vlere. Kemi edhe plot shembuj te tjerë qe janë planifikuar apo dizajnuar ne atë mënyrë qe nuk janë plotësuar kushtet, edhe kanë ik njerëzit. Për këtë arsye po them qe jemi për koeficient aty ku ka sens ai koeficient mirëpo se pari jemi për vlera shoqërore për me e kriju një jetese më të mirë për të gjithë ne. Kur e krijojmë dendësinë duhet te krijojmë edhe vlerat, çerdhen, shkollën parqet, fushat sportive, qendrën e mjekësisë familjare e shumë e shumë nevoja tjera për një kualitet te mirëfillte te jetesës. Nëse ju e shihni vetëm koeficient i kemi dikund rreth 15.000 apartamente te pashitura, si blen askush. Ne duhet me qene shumë te vetëdijshëm qe te punojmë se bashku për krijimin e një vlere, te një balancimi te

mirëfillte ku Prishtina te vazhdoj te bëhet një kryeqytet qe i josh njerëzit me qëndru brenda e jo me ik. Takimi ynë sot është me ju ndëgju juve, me i marr te gjitha pikat edhe ne, me ekipet profesionale me fillu me propozime, dhe prapë me i rishiku me juve. Ideja është qe ne këtë proces askush mos me humb por me fitu, dhe mundemi me e ba.

Banor i lagjes-u përmend Plani zhvillimor dhe Plani rregullues, ju e dini qe krejt Planet qe i ka Komuna e Prishtinës janë ba me fontanë dëshirash, e ke Prishtinën e re, Mati 2 ku absurdi me i madh është qe te gjitha zonat publike janë ndërtu me 15 kat kurse pronat privatë janë shëndrru ne gjelbërim, ku është drejtësia këtu. Mua ma keni pamundësu me materializu at prone me vite te tera, nuk kam qasje fare ne te, një pjese e keni shëndrru ne gjelbërim, një pjese ndërtim te ulet, ju e dini qe Mati 2 qe sa vite është i bllokuar dhe askush nuk din me te dhanë përgjigje, unë i kam tri kërkesa për kushte ndërtimore, dhe te tri kërkesat prej departamentit te juaj i kam te ndryshme. Se pari për kufi a është kufiri me prockën qe është lum a është me rrugën qe është ne punë, 2)- ne këtë faze ju keni parapa me tërheq lumin e me qu përreth rrugës A, nuk e di a e keni analizuar, a studiuar,3) e ke rastin e Kodrinës, një rruge e keqe e ndan Matin 1 me Matin 2 ku koeficienti është 1.2, ndërsa Kodrina jo qe e ka 3, po ndoshta edhe 4, edhe me çfarë logjike tokat tona me u marr me u lënë mbi 70-80% parqe, e ai zotëria e ka materializu, e shet krejt e ata banore kanë me e shfrytëzu këtë gjelbërim. Këto gjëra unë mendoj qe janë te padrejta, dhe te papranueshme.

MIMOZA SYLEJMANI- ne të gjithë e dijmë, edhe ju si pronar te tokave se ka dallim midis Planit rregullues dhe Planit Zhvillimor Komunal, prandaj sipas ligjit te planifikimit bëhet Plani zhvillimor komunal dhe Harta Zonale. Harta Zonale nuk ka me pas kufinj, d.m.th.-ne trajtohet ne tërësi krejt komuna e Prishtinës, pa dallim do te bëhet ndërlidhja e zonës urbane me rurale, nuk do te këtë plane rregulluese te lagjeve, do te kemi vetëm plane rregulluese te hollësishme për raste specifike.

KRYETARI- pikërisht për arsye qe ekzistojnë dhe ka pas probleme te tilla dhe vazhdojmë me pas, pajtohem me juve plotësisht qe nuk është fer qe toka juaj privatë me u ba park publik, ndërsa zonat tjera me u ndërtu, e ceka edhe me herët qe ne aspektin e shpronësimit apo shkëmbimit trajtohen njësoj. A sa i përket koeficientit pse dikund 1.2 e dikun 2.4 ish dashtë me pas një analize te mirëfillte për gjithë zonën qe me pas arsyetim pse është vendosur ashtu. Ma herët ju thashë qe ne këtë proces nuk do te dëmtohet askush, edhe gjatë këtij procesi mundet me fillu negocimi me Komunën.

DONJETA SAHATCIU-përshëndetje të gjithëve, faleminderit për pjesëmarrjen, do ta marrim parasysh propozimin qe takimet ti bëjmë prej orës 17 tash e tutje, faleminderit shumë zonjës, përfaqësueses se këshillit te prindërve te shkollës “Iliria”, bashkëndjej me to .Kam pasur takim me herët edhe vizite ne shkolle, deshta me ju informu qe jemi te njoftuar, edhe Drejtoria e Arsimit për planin qe ka qene, veç i kemi nis procedurat për renovimin e shkollës, sa i përket pjesës se ndriçimit, mungesës se sinjalizimit rreth shkollës janë dy kontrata te cilat kanë qene te bllokuara nen Organin Shqyrtues te Prokurimit, për shkak te bllokimit ne nuk kemi pas mundësi me vazhdu me kontraktor te tjerë, ne i kemi nise kontratat e reja tash dhe brenda 2-3 javëve mirëpresim qe nuk ka ankesa, dhe do te vazhdojmë me nënshkrimin e kontratave ne mënyrë qe te nisim punën ne sinjalizim dhe ndriçim. Dikush e përmendi edhe tensioni e larte ne lagjen e juaj, kjo nuk është ne kompetence te Komunës por çka është përgjegjësi e jona është qe fjalët dhe kërkesat e juaja me i bart te Institucionet përgjegjëse, ne mundemi me e ba një kërkesë dhe ankese te KEDS-i qe është përgjegjës për ato, qe me e trajtu sa ma shpejt problemin. Ne lidhje me rrethimin e shkollës, nuk e di a e keni pa te rruga Tirana, përgjatë hekurudhës janë vendosur disa rrethoja/mburoja, te tilla kemi ne kontratë, mundemi me i shfrytëzu me i vendos rreth e rreth shkollës, qe përkohësisht me e ndalu parkimin dhe uzurpimin e trotuareve qe janë rreth shkollës “Iliria”. Veç kemi fillu me i trajtu hapësirat përreth shkollave, e kemi nis me e trajtu si koncept te shkolla ‘Elena Gjika” ku mbyllet komplet qarkullimi i veturave pranë shkollës ne dy rruge, te njëjtin koncept jemi duke fillu me e trajtu edhe te shkollat e tjera. Jemi duke

e analizuar, i kemi personat ne terren qe po mirren me këtë punë. Gjithashtu jam shumë e lumtur me e përmend qe ne këtë diskutim publik ka edhe shumë gra pjesëmarrëse, dhe kisha deshtë qe me vazhdu me i ftu edhe te tjera gra qe me marr pjese ne këto takime, ju faleminderit.

KRYETARI- desha me e përmend edhe për bashkësitë lokale, bashkësitë lokale janë jetike dhe me rëndësi shumë te madhe për qytetaret, se nëpërmes bashkësisë lokale Komuna është me afër qytetareve, tani ne kemi marr vendim dhe zgjedhjet janë ne proces, do te lajmëroheni shumë shpejt.

ISMET HAZIRI- unë po ju njoftoj qe për rrugën e Zllatarit kanë kontribuar të gjithë fshataret, por këtu kemi një përfaqësues te familjes Tahiri, Alija, qe kanë kontribuar me se shumti dhe kur e kthen ne vlerën monetare kontributin e tij është përmbi 200 mije euro, faleminderit Ali dhe familjes Tahiri.

LAURA KATONA-banore e lagjes ne kompleksin Relax 5 te rruga B, kemi problem me ujërat e zeza qe tre vite, te cilat depërtojnë ne podrum dhe ne garazha. Jeta aty është ba e padurueshme, për shkak te erës, Problemi është qe nuk ke drenazhe rruga ku është objekti dhe sistemi i vjetër i kanalizimit( banorja i dorëzon disa foto) foto te cilat i janë përcjelle Drejtorisë se Investimeve Kapitale.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ISMET HAZIRI | B.L. VII/2 | [signature] |
| 2 | AVDULLA KRASNIQI | B.L VII/2 | [signature] |
| 3 | ISMAIL SHILLOVA | | [signature] |
| 4 | XHELAL CIMANI | 044 193-122 | [signature] |
| 5 | Selami Latifi | selaptk@gmail.com | [signature] |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | BUJAR IMSIRI | | |
| 2 | Kujtim Bërbatovci | 044 294600 | |
| 3 | AGON SAGU | 044-925-311 | |
| 4 | FATON QIREZI | 044 274 589 | |
| 5 | FADIL XHEMAJI | 044 171484 | |
| 6 | Efmire Aliaj Fexha | 044 556 776 | |
| 7 | AMIR LIMNICA | — | |
| 8 | Hysen Shillova | | |
| 9 | Violeta Sahiti | 044 553 444 | |
| 10 | BIDA RAMA | 044 355-296 | |
| 11 | FLAMUR IMERI | 044 116 201 | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ARTA METAJ - GOVORI | 044 175 183 | [illegible] |
| 2 | JETON GOVORI | 044 215 768 | [illegible] |
| 3 | Egzona Isufi | 044/823/924 | [illegible] |
| 4 | SHERIF VRAJOLLI | 045 777 077 | [illegible] |
| 5 | AMIR GASHI | 045-991-998 | [illegible] |
| 6 | ASTRIT GASHI | 044 200 533 | [illegible] |
| 7 | Shkelzen Sejdiu | 045/418-175 | [illegible] |
| 8 | Naile Gashi | 0038272153 | [illegible] |
| 9 | RIZADIN RAMADANI | 044 206 - 805 | [illegible] |
| 10 | Visar Kroshiqi | 044999558 | [illegible] |
| 11 | ARIANIT ABAZI | 044 220 - 375 | [illegible] |
| 12 | Fatmir Azemi | 043/777 200 | [illegible] |
| 13 | Fatmir Sefuna | 044/947 785 | Sefuna |
| 14 | Ferat Sefuna | 045 845 105 | [illegible] |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | NGADHNJIM KASTRATI | ngadhnjimkastrati@yahoo.com | [signature] |
| 2 | ASTRIT GASHI | astritgashi@abu.bg. | [signature] |
| 3 | Besmir Pula | besmir.alkogroup@gmail. | [signature] |
| 4 | BLEART SELMANAJ | bsa.shpk.@gmail.co | [signature] |
| 5 | ARTON DEMOLLI | ARTON-DEMOLLI@hot.com | [signature] |
| 6 | AGIM MALIQI | 044 370 332 | [signature] |
| 7 | MOLOS MORINA | 044 337 557 | [signature] molos-orin |
| 8 | NAFIJE GASHI | 045/555 985 | [signature] |
| 9 | BESIM SELIMI | 044 677 654 | [signature] |
| 10 | FATOS ALIU | 049-424-880 | [signature] |
| 11 | Aljia Tahiri | 044 846 282 | [signature] |
| 12 | VISAR KRASNIQI | 049 50 9077 | [signature] |
| 13 | Laura Katona | 044 133 563 | [signature] |
| 14 | VALON ZYGERI | 048-40 1111 | [signature] |
| 15 | Bekim Rulleku | 045 300 305 | [signature] |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muhamet Bajrami | 044-714829 | [signature] |
| 2 | Minire Mehmeti | 044-465-131 | [signature] |
| 3 | KADRUSH LATIFI | 045-664477 | [signature] |
| 4 | Milot Makolli | 045888803 | [signature] |
| 5 | Fatlum Fetahu | 045 631 283 | [signature] |
| 6 | Shaban Fetahu | 045 677 134 | [signature] |
| 7 | Shemsi Rashiti | 044 120 908 | [signature] |
| 8 | [illegible] | 044 240 681 | [signature] |
| 9 | [illegible] | 044-469-680 | [signature] |
| 10 | Merita [illegible] | 049-650-353 | [signature] |
| 11 | MEHMA AVAZI | 044-225-654 | [signature] |
| 12 | Isuf Arifi | 044145052 | [signature] |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ISMET HAZIRI | B.L. VII/2 | [signature] |
| 2 | AVDULLA KRASNIQI | B.L VII/2 | [signature] |
| 3 | ISMAIL SHILLOVA | | [signature] |
| 4 | XHELAL LIMANI | 044 193-122 | [signature] |
| 5 | Selami Latifi | selaptk@gmail.com | [signature] |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ARTA METAJ - GOVORI | 044 175 183 | [illegible] |
| 2 | JETON GOVORI | 044 215 768 | [illegible] |
| 3 | Egzona Isufi | 044/823/924 | [illegible] |
| 4 | SHERIF VRAJOLLI | 045 777-077 | [illegible] |
| 5 | AMIR GASHI | 045-991-998 | [illegible] |
| 6 | ASTRIT GASHI | 044 200 533 | [illegible] |
| 7 | Shkelqim Sejdiu | 045/418-175 | [illegible] |
| 8 | Naile Gashi | 10038172153 | [illegible] |
| 9 | ZIJADIN RAMADANI | 044 206 - 805 | [illegible] |
| 10 | Visar Kroshiqi | 044999958 | [illegible] |
| 11 | ARIANIT ABAZI | 049 220 - 375 | [illegible] |
| 12 | Fatmir Azemi | 043/777 200 | [illegible] |
| 13 | Fatmir Sofuna | 044/947 785 | [illegible] |
| 14 | Ferat Sofuna | 045 845 105 | [illegible] |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | BUJAR IMASIRI | | |
| 2 | Kujtim Bërbatovci | 044 294600 | |
| 3 | Agron Sagu | 044-925-311 | |
| 4 | FATON QIREZI | 044 274 589 | |
| 5 | FADIL XHEMAJLI | 044 171484 | |
| 6 | Efmire Aliaj Fexha | 044 556 776 | |
| 7 | AMIR LIMNICA | — | |
| 8 | Hysen Shillova | | |
| 9 | Violeta Sahiti | 044 553 444 | |
| 10 | BIDA RAMA | 044 355-296 | |
| 11 | FLAMUR IMERI | 044 116 201 | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 09/06/2022

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | E-maili dhe tel. | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Muhamet Bajrami | 044-714829 | |
| 2 | Minire Mehmeti | 044-465-131 | |
| 3 | KADRUSH LATIFI | 045-664477 | |
| 4 | Milot Makolli | 045888803 | |
| 5 | Fatlum Fetahu | 045 631 283 | |
| 6 | Shaban Fetahu | 045 677 134 | |
| 7 | Shemsi Rashiti | 044 120 908 | |
| 8 | [illegible] | 044 240 681 | |
| 9 | [illegible] Imeri | 044-469-680 | |
| 10 | Merita Hoti | 049-650-353 | |
| 11 | [illegible] AVAZI | 044-225-654 | |
| 12 | Isuf Hasani | 044145052 | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |

KOMUNA E PRISHTINËS

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 5

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**14 korrik**, në SHFMU "Mehmet Gjevori", duke filluar nga ora **16:30 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale, si dhe lidhur me problematikat e lagjeve.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Vllaznim Osmani - Shef i Kabinetit
3. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
4. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit
5. Ilirik Musliu - Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

## 3. PROCESVERBALI

MIMOZA SYLEJMANI-Përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhë, për ata qe nuk me njohin jam arkitekte e ndërtimtarisë me profesion tani jam drejtore ne Drejtorinë e Planifikimit. Ju e dini qe jemi duke punuar ne Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale, sot kemi ardhë këtu me diskutu me ju, jo me ju prezentu ndonjë ide, por me ju ndëgju juve, kërkesat, ankesat e idetë e juaja te cilat do te na ndihmojnë shumë për këtë draft dokument, edhe çfarëdo qe keni sot, paqartësi, pyetje, sugjerim, mundeni me na u drejtu lirisht, pe ratë edhe jemi këtu. Siç e dini edhe ju Arbëria 1 dhe 2 nuk kanë plan rregullues, janë me planin e vjetër qe ka ekzistu, e kemi planin rregullues vetëm për Arbëria 3 dhe pjesën ekonomike qe e përfshin gjysmën e fshatit Shkabaj. Jemi duke punuar, siç edhe e ka cek Kryetari ne programin e tij për kryeqytetin, qe pjesën ekonomike ne Shkabaj jemi duke e bart edhe ne pjesën tjetër dhe një pjesë te Bërnicës së Poshtme. Këtu do te jete një salle gjigante multifunksionale e cila ka qene me projekt te Stacioni i autobusëve, gjithashtu edhe stadioni, jemi duke e zhvilluar këtë pjese pak me shumë sepse do te shtrihet krejt Kampusi Sportiv. Për Arbëria 3 jemi duke punuar për pjesën te Ambulanta qe është një pjese e pyllëzuar, por jo shumë, mungojnë ndarjet aty, aty kemi ne plan edhe për një çerdhe. Për me shumë ia jap fjalën Arbër Sadikit, drejtorit te Urbanizmit.

ARBËR SADIKI-përshëndetje të gjithëve, unë jam Arbër Sadiki, drejtor ne Drejtorinë e Urbanizmit, ne momentalisht jemi duke punuar me planet e vjetra qe i kemi gjetë, qe është Plani Zhvillimor Urbanistik

qe përfshin komplet territorin e Prishtinës dhe janë Planet Rregullative qe përfshijnë pjese te caktuara. Atë qe ne po bëjmë tash edhe qe na obligon edhe ligji i planifikimit i vitit 2013, e qe për fat te keq deri sot nuk është aprovu asnjë hartë zonale, e një numër shumë i madh i problemeve zgjidhen përmes hartave zonale. Pse nuk janë bërë deri tani është sepse nuk është punuar ne atë drejtim, edhe ne kur kemi ardhë e kemi analizu edhe është e mundshme me u ba brenda një punë 6 mujore edhe ne kuptimin teorik edhe praktik. Ne kemi filluar te gjitha procedurat edhe mendojmë qe brenda një afati te caktuar kohor sa ma te shpejte me i përmbyll këto harta zonale. Harta zonale pastaj e përfshin gjithë territorin e kryeqytetit. Hartat zonale nuk munden me u ba pa u aprovu (rishiku) fillimisht Plani Zhvillimor Komunal ekzistues. Sipas ligjit për planifikim ekzistojnë tri lloje te dokumenteve planore. I pari është Plani zhvillimor komunal te cilin po e rishikojmë tash, ne baze te tij tani bëhet Harta Zonale dhe hartat zonale mandej e precizojnë se ku mund te bëhen plane rregullative te hollësishme. Jo krejt territori i Prishtinës ka nevoje për plan te hollësishëm rregullativ, mirëpo krejt territori i Prishtinës ka nevoje me u përfshi me një hartë zonale e cili mandej është dokumenti i vetëm ne baze te cilit edhe lëshohen kushtet ndërtimore, edhe lejet ndërtimore. Ne po përpiqemi tash qe te gjitha ato pakjartësi , ju e dini shumë mirë qe mes planeve te caktuara ku shpesh për te njëjtën zone kanë dhënë koeficienta te ndryshëm, këto me i balancu, me i përafru ne kuptimin e një zhvillimi te qëndrueshme te qytetit te Prishtinës, e këtë nuk mund ta bëjmë pa i marre informacionet edhe prej terrenit dhe pa e analizu mirë gjendjen reale, faktike siç është. Kështu qe sot ndihuni te lire për çfarëdo lloj kërkesë, ankese apo sugjerimi me e nda këtu me ne.

KRYETARI- Faleminderit, mirë se keni ardhë të gjithë. Vizionin e përgjithshëm te kryeqytetit ne pika te shkurta veç e tha Mimoza dhe Arbëri, unë dua te flas me ne përgjithësi ne aspektin e zhvillimit te përgjithshëm te kryeqytetit tu u ndërlidhë me zonat për te cilat jemi këtu sot, Arbërinë dhe Shkabaj. Gjatë fushatës i kam evidentuar pikat kyçe qe janë më se te nevojshme, ndërlidhja e Arbërisë me zonën qendër nëpërmjet investimeve kapitale te mëdhaja. Është një projekt multifunksional qe e ka platformën e gjelbër qe e lidhë qendrën me Arbërinë por që e ka edhe ndërtesën e operas dhe baletit, dhe pjesa e parkingjeve nëntokësore, zonës komerciale. Projekt tjetër madhor e kemi edhe kampusin e sporteve qe e përfshin Arbërinë një pjese te Shkabaj. E dimë qe është më se e nevojshme qe për një zhvillim te mirëfillte te çdo qyteti te kemi fokusin e zhvillimit te qendrave sportive, rekreative te cilat i kemi ne mungese shumë. Projekt tjetër madhor e kemi edhe Solar for Kosovo është një investim i Bankës Gjermane me Ministrinë e Investimeve Kapitale ne bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Obiliqit, projekti me i madh ne Evrope i këtij lloji, ku 35 megavolt energji elektrike krijohet nëpërmjet paneleve solare qe lidhet me Termokos dhe që mundëson një ngrohje te mirëfillte ambientale. I kemi edhe disa iniciativa te përbashkëta me Bankën gjermane ne planin zhvillimor qe edhe nëpër shtëpi privatë te ndërrohet sistemi i vjetër i ngrohjes me një sistem te ri Eco disagn qe mundëson zbritjen e ndotjes se ajrit deri ne 95%. Gjithashtu përveç projekteve madhore janë te parapara edhe problematikat e përditshme qe ballafaqoheni ju, si ndriçimi, rrugët, trotuaret, parkingjet, pjesët e gjelbëruara, te gjitha këto te përfshihen dhe te rregullohen. Për mos me e zgjatë me shumë ne sot jemi këtu qe me i shkëmby idetë tona te përbashkëta me juve, me ju ndëgju juve dhe te gjitha këto ti bëjmë pjese te Planeve zhvillimore.

Banor i lagjes Shkabaj- mendoj qe duhet te hapen Bashkësi lokale sa me shumë dhe shumë punë Komuna kish me i kry përmes Bashkësive lokale, edhe kish me funksionu me mirë e me lehte.

KRYETARI- Ndoshta e keni pa që veç e kemi filluar edhe e kemi pikë kyçe fuqizimin dhe rihapjen e Bashkësive lokale qe kanë qene te mbyllura një kohe te gjatë, jemi ne proces te hapjes se pikave tjera qe Komuna me qene sa me afër me qytetaret përmes Bashkësive lokale.

SELATIN GASHI- ne lagjen tonë kemi shumë probleme, probleme bazike për jetese, kemi problem me ujin e pijshëm, nuk ka shtypje, nuk kemi ndriçim, mungon transporti publik dhe kemi problem me qentë endacake.

RAGIP RUGOVA –banor i rrugës Ismail Qemali, prej mbas luftës na e kanë ba qasjen ne rrugën Nelson Mandela, te dyja ato rruge janë njëkahore me zbrit prej Ismail Qemalit, neve si banor te kësaj rruge jemi dikund 40 shtëpi a për me u ngjitë ne rrugën tonë duhet rreth e rreth me i ra gati 1.5 km rruge kot, sidomos ne kohë e dimrit na paraqet bajagi problem. Në vitin 2019 kemi bërë peticion rreth 100 nënshkrime, edhe e kam dorëzuar , por asgjë, kam shkuar edhe disa here vet personalisht, por asgjë. Ju kisha lutë qe te na e rregulloni këtë çështje. E dyta për shkak te kanalizimeve te cilat ne Prishtinë nuk janë pastruar prej se është themeluar ky qytet, nxenja e kanalizimeve kur ka rrebeshe të shiut nuk e përballon, unë di disa raste qe disa here janë vërshuar shtëpitë nga uji e kanalizimi. E treta do te ishte mirë qe te krijohet një Site zyrtar i Komunës, ky qytetaret mund te i japin vrojtimet e veta, vërejtjet dhe dikush sipas detyrës zyrtare te përgjigjët ne këto ankesa e kërkesa.

MIMOZA SYLEJMANI- e kemi, është Prishtina Online, edhe ju kisha lute qe për kërkesën për rruge te vini ne Komunën e Re, të martën e të enjten e kemi punën me palë, është Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe aty te parashtroni kërkesën e juaj.

SYLEJMAN KRASNIQI-banor i lagjes rr. Stambollit, kemi problem me kanalizimin.

RAMADAN AHMETI-banor i lagjes Arbëria 2, është një pjese përfundi ambulantes, para disa viteve kemi marre iniciative me banoret e lagjes qe me e shëndrru ne park atë pjese, edhe USAID ka shpreh dëshirë për me e sponzorizu, mirëpo kanë qene disa profesorë qe nuk e kanë dhënë nënshkrimin. Nëse ka mundësi qe me e marrë parasysh atë pjese edhe me e ba një park aty kish me qene shumë bukur. Ju faleminderit.

MIMOZA SYLEJMANI- është pikërisht ajo qe e thash me herët qe mungon ndarja kadastrale e qe jemi tu e hulumtu edhe tu u mundu qe me e kthy atë pjese për qytetaret, edhe do te përfshihet ne Plan zhvillimor.

Shaban Kurtolli-banor i lagjes Arbëria 3. Rruga Gjirokastra dhe rruga Mramori janë ne gjendje te mjerueshme, se pari shaktat janë te hapuna, shtyllat elektrike janë ka rrezohen, ujë te pijshëm nuk kemi, s'ka shtypje, ne këtë shekull kemi mungese te ujit te pijshëm, edhe kemi problem me kanalizim, edhe nuk kemi transport publik, edhe rruga është e pakalueshme andej. Ju kisha lut me dal ne terren me pa.

SHEFQET JAHJAGA banor i lagjes-prej vitit kur është planifiku legalizimi, krejt dokumentacionin e kam bërë gati, unë kom apliku, kam ba pagese te një takse edhe ende s'kam përgjigje, ju kisha lutë qe sa me shpejt te bëni legalizimin e pronave, e dyta është çështja e ujit, ne rrugën Gjergj Balsha, është sistemi i vjetër i ujësjellësit, atë ujë nuk mundesh me e pi se e ka një erë, atë ujë e përdorim vetëm për me pastru, ne ujin për pije e blejmë.

Ardian Gashi- banor i lagjes rr. Kosturi, Arbëria 3, kemi shumë probleme, do ti ceki disa, se pari çështja e ujit e kemi vetëm një rezervar tri objektet, jemi te lidhur me ujësjellës po kemi shumë pak shtypje, kemi problem me kanalizim, mandej me mbeturinat mungojnë kontejnerë, mungon trafiku urban ne pjesën tonë, më urgjentja është te lidhemi me ujë dhe me ujësjellësin.

Ilmi Reka-e kam token qe 100 vite përballë ambasadës amerikane, këtu me planet ekzistuese është parapare gjelbërim para pronës tonë , e qe mua me pengon qasjen ne pronën time, e dyta është stacioni policor qe është paraparë ne pronën time, kërkoj qe te zhvendoset, a sa i përket koeficientit

ne jemi dëmtu shumë, pjesa jone është 1.5, a veç pak me tutje e kanë 2.1,nëse mundeni me e korrigju, ne mendojmë qe është padrejtësi kjo.

Afrim Gashi-nuk pajtohem me koeficientin ka qene 2.4 ka ra ne 1.2 a me poshtë neve e kanë koeficientin më te madh, ju lutem te bëni diçka, e jo vetëm shkel e shko koeficientet.

Abdurahman Haxhija rr. Ahmet Krasniqi ,parcela me numër 6176-0 qe 12 vite jam i bllokuar ne parcelën time qe e kam qe 250 vite. ( te bashkëlidhur e gjeni ankesën e qytetarit)

Driton Zhushi- unaza e jashtme a do te devijoj a jo.

KRYETARI- po unaza e mesme ndryshon, lidhet tashme me dy autostradat ekzistuese, rruga prapë ka me ekzistu.

Driton Zhushi – e a do te lejohet ndërtimi aty.

KRYETARI- atë e rregullojmë me plan rregullativ.

ARBËR SADIKI-për punën e unazës, ka qene e parapame ne zonën ekonomike, tash unaza lëviz e tani po lidhemi me autostradën ekzistuese, mirëpo ne pjesët ku veç janë lëshuar lejet ndërtimore ne baze te planeve ekzistuese neve na obligon qe ato rruge kah ka kalu unaza me i mbajt prapë, por jo te karakterit te unazës, d.m.th.-në askush nuk ka nevoje me u shqetësu. Pat edhe shumë pyetje për pjesët ku janë dedikuar shkollat, rrugët, planet ekzistuese nuk e kanë pa saktë se ku do te kompensohet një dedikim publik, p.sh është parapare një parcele privatë për shfrytëzim publik mirëpo nuk është kalkuluar ku mundet me u kompenzu, atë çka ne po mundohemi me e ba, edhe arsyeja pse jemi këtu është qe me i marrë krejt këto vërejtje prej juve, se edhe ne kemi parapare hapësira publike, ndoshta edhe me shumë, mirëpo kemi me i kalkulu saktë qe pjesët privatë qe i marrim për përdorim publik me u kompensu ne vlerën e njëjte, edhe na e bëjmë ma te lehte implementimin e planit edhe nuk ja bllokojmë pronën tjetrit.

Bujar Zeqiri- kryetar i këshillit te prindërve dhe banor i lagjes( te bashkëlidhur e gjeni ankesat dhe kërkesat edhe si kryetar i këshillit te prindërve edhe si banor i lagjes)

Ilir Hasani- banor i lagjes rr. Gjergj Balsha, ARBËRIA 3, kërkojmë qe te kemi transport publik, gjithashtu te mirret ne konsideratë rritja e koeficientit, gjithashtu kërkojmë qe te kemi kontroll te policisë për vozitje te shpejte ne rrugën tonë.

Visar Xheladini-te rritet koeficienti ne 2.4 nga 1.2.

Blerta Shujaku- banore e lagjes Arbëria 1, kemi shumë probleme  por me e rëndësishmja është qentë endacake ne këtë pjese e qe ndihemi te rrezikuar ne çdo kohe, sidomos fëmijët tanë.

Ramë Sadiku-banor i lagjes rr. Gjergj Balsha, Arbëria 3-kam disa kërkesa, te kemi transport publik ne pjesën tonë, kemi problem edhe me mbeturinat, është bërë një mini deponi , kam bërë ankese.

Arbën Sela-po me intereson ne planin rregullues a ka diçka për lumin Prishtevka ka Ramiz Sadiku.

Bahri Sejdiu- banor i Shkabaj rr Agron Rama, rruga është shumë e ngushte, ka qene ne propozim për zgjerim e ende asgjë, gjithashtu është folur për një çerdhe qe do te ndërtohet, qendra rekreative, dhe hudhja e mbeturinave ne rrugën e Panairit, na është premtuar qe do te ndërtohet Ambulanta, po shpresojmë qe këto kërkesa do i merrni parasysh edhe do te realizohen.

Visar Zariqi-banor i lagjes Arbëria 3-pronar i parcelës 7278-49 qe është e destinuar për qendër te mjekësisë familjare, edhe rruga është e destinuar ne parcelën time, tash a kanë me vazhdu njëjte a ka me u ndërpre ky projekt.

Agron Hamiti-kryetar i bashkësisë lokale- kabllot e rrymës nuk janë kthyer ne gjendjen e mëparshme nga KEDS-i edhe punën nuk e kanë përfunduar edhe shpejtësia e veturave ne rrugën Ahmet Krasniqi është alarmante, duhet urgjent te vendosen policet aty.

Banor i lagjes – unë jetoj ne rrugën Qemal Stafa, në planin e juaj rregullues varrezat a do te vijnë deri te Xhamia a jo.

Ilaz Baci- banor i lagjes prej viteve te 70-ta ne rr. Afrim Gashi, rruga jone është ne gjendje te mjerueshme, kanalizimi çdo te dytën dite del prej tokës, fëmijët kanë me kalu andej, kemi ba ankese dhe kërkesë disa here por asgjë, edhe kemi mungese te ujit te pijshëm.

ARBËR SADIKI-shumica e problemeve janë te ngjajshme këtu, unë edhe vet jetoj ne Arbëri i di edhe shumicën se cilat janë. Shumica e këtyre problemeve qe janë grumbulluar këtu është se nuk ka pas ndonjë planifikim afatgjatë, por janë zgjidh problemet duke intervenuar aty për aty. Në çoftë se nuk planifikohen mirë projektet që me funksionu në tërësi problemet mbesin aktuale, u fol për kanalizimet, për bllokadën te Ambasada Austriake, ajo bllokohet me poshtë dhe era vjen mandej lart. Ne tash se bashku me Bankën gjermane jemi duke e bërë një analize komplet te kanalizimit ne Komunën e Prishtinës, është e vërtetë qe kanalizimet as 50% nuk e përballojnë kapacitetin ekzistues, por është duke u bërë ekspertiza me mjetet me bashkëkohore, qe këtë problem te kanalizimit me e zgjidh përgjithmonë e jo përkohësisht. Ju tere kohës po flisni për koeficienta ne rritje te ndërtimit, te njëjtit koeficienta sot na kanë lënë pa ujë , pa kanalizim, sepse nuk është mendu te parametrat baze qe duhet me u përcaktu për një zhvillim te tillë. Ne e dimë qe ka dallim te koeficientave pa ndonjë sens, por këto gjëra do ti balancojmë me një qasje te integrume. Puna e parkut, momentalisht ajo zone ne kadastër figuron si hapësirë publike, jemi duke e shqyrtuar si mundësi se si me e zgjidh këtë problem te kufinjve kadastral, qe me realizu atë park. Për punën e legalizimit procedura është shumë e lehte, ne kuptimin procedural ekziston vetëm një takse për legalizim, për ndërtesat 2 euro për m2 dhe për shtëpitë 1 euro për m2. Për ndërtime individuale legalizimi është duke shkuar bukur shpejt. Pyetët për rrethrrotullimin qe lidhet me rrugën Tirana e cila e zhbllokon jashtëzakonisht shumë qarkullimin jo vetëm për Arbërinë por për Prishtinën ne përgjithësi. Nuk është aq e lehte se aty një pjese është ne pronësi te Hekurudhave qe nuk është ne kompetence te Komunës, e qe duhet bukur shumë negociata dhe një pjese është e varrezave ortodokse e qe ju e dini shumë mirë sa konsultime na duhen për me u ofru ne atë pjese, përndryshe mjetet financiare për atë rruge ka kohe qe janë ndare, ne momentin qe i zgjidhim këto probleme administrative ajo rruge fillon ndërtimin. Sa i përket gjelbërimit dhe pjesës ku është parapare stacioni policor qe tha zotëria, aty nuk është analizuar fare se si mundet personi me e kapitalizu pjesën mbrapa sepse ti për një rryp te vogël nuk mundesh me e blloku komplet pronën mbrapa. Ja kisha dhënë fjalën Ilirikut qe është me ne rrjedha për planin e mobilitetit.

ILIRIK MUSLIU- përshëndetje të gjithëve, unë jam Ilirik Musliu drejtor i Shërbimeve Publike, i ndëgjova ankesat e juaja për transportin publik, edhe rrugët dhe për policet te shtrire,. Për transportin publik ne jemi duke punuar shumë ngushte me BERZH-in, prej shtatorit kemi me e pas edhe një flote te re me autobusë , gjithashtu jemi duke punuar edhe me sektorin privat qe edhe ata me u trajtu njëjte si Trafiku Urban, gjithashtu jemi duke e bërë rimodelimin dhe riorganizimin e te gjitha linjave ne Prishtinë dhe ne zonat rurale. E dimë problemin e Arbërisë sa i përket transportit publik, jemi duke punuar ne atë drejtim. Sa i përket policeve te shtrire, jemi ne vlerësim te projektit besoj qe brenda 2 jave do te kemi gati kontratën, ne momentin qe kryhet shumë shpejt jemi ne terren, gjendjen veç e

kemi analizuar se me vendim te kryetarit është formuar një Task Force e cila non-stop ka qene ne terren dhe i ka marre te gjitha shënimet, vërejtjet, ankesat me qellim qe ne momentin qe te kryhet kontrata me dal menjëherë me implementim. Gjendjen me sinjalistike, shenjëzim e kemi mese te qarte e dimë qe asnjëherë s'ka qene me keq, për arsye se OSHP-ja nuk ka qene ne funksion. Sa i përket ndriçimit publik, ne qe 3 jave veç jemi ne terren me mirëmbajtje, 2 vjet nuk ka pas kontratë për mirëmbajtje te ndriçimit publik, ka shumë nevoje për ndërhyrje, punëtorët janë tërë kohës ne terren, shumë shpejt do te jemi ne lagjen e juaj, a sa i përket për zgjerim jemi ne vlerësim te projekteve, për zgjerim te ndriçimit publik nëse s'keni bërë kërkesë ju kisha lute qe ta bëni kërkesën. Për qentë endacake veç e kemi nda Prishtinën ne 7 zona, 7 operator qe kanë me reagu, gjithashtu e kemi ne plan edhe strehimoren qe do te jete ne nivel lokal dhe regjional. A për transportin publik, një prej kushteve te BERZH-it e kemi qe ne janar te 2024 transporti publik duhet me u mbyll si teme ose i humbim fondet e po flas për projekt deri ne 200 milion euro. Deri ne fund te vitit mendohet te kryhet kontrata me sektorin privat, komplet kalon nen menaxhim te Komunës. Ne kryeqytet krejt autobusat kanë me qene një lloj, gjithqysh sektori privat me kushtin e BERZH-it autobusi me i vjetër duhet me qene i vitit 2018.

ARBËR SADIKI-për punën e ndërlidhjes se Arbërisë me qytetin është projekt qe mundet me zgjatë disa vite por ne kemi marre masa qe te bëhet një ndërlidhje e përkohshme, besoj qe javën e ardhshme del ne prokurim, një ndërlidhje do te jete prej Arbërisë ne pjesën poshtë dhe tjetra prej Grandit, Qendra Rinore e qe vazhdon për Aktash. A sa i përket për rastin qe jeni bashkëpronar , ato landë mendojmë me i zgjidh me një rigjenerim urban , me mundësi te një ngritje qe secili me i marr metrat katrore por tani ne pronësi. Ne zonat te tilla ka me u parapa me u ba plane rregullative te hollësishme.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 14.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | FAIK HASANI | faik-universal@hot... | | |
| 2 | Argjent Pacolli | argjentpacolli@gmail.com | | M |
| 3 | Aziz Pacolli | azizpacolli@gmail... | | M |
| 4 | Besnik Rexhepi | besni...@hotmail.com | | M |
| 5 | Hasan Dushi | | | M |
| 6 | Fgokim [illegible] | | | M |
| 7 | [illegible] | | | |
| 8 | DHURATA SAHAD KETKOCERI | | | F |
| 9 | MENSURE SADIKI | | | M |
| 10 | SHEFQET SHAJAGA | | | M |
| 11 | Sylejman Krasniqi | | | |
| 12 | GENTRIT KRASNIQI | gentrit...@gmail.com | | M |
| 13 | Enver Olloni | enverolloni@g... | | M |
| 14 | MEHMET HASANI | Shkabaj | | |
| 15 | [illegible] Zeka | 043-200057 | | M |
| 16 | [illegible] Pacolli | 044/112-273 | | M |
| 17 | ISMET PACOLLI | 044 158 947 | | M |
| 18 | GEZIM MAROCCI | 044392999 | | M |
| 19 | FISNIK RAMADANI | 044 277 337 | | F |
| 20 | Merlinda Shulli | | | M |
| 21 | ARIANIT REXHEPI | 045 505 077 | | M |
| 22 | AGIM REXHEPI | 045 505 071 | | |
| 23 | Nazmedin Krasniqi | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 14.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Islam [illegible] | 044 112 589 | [signature] | |
| 2 | ARSIM SYLEJMANI | 044 178-007 | [signature] | |
| 3 | Florent Vesoli | 045-590-587 | [signature] | M |
| 4 | AGON BARUTI | 049610106 | [signature] | M |
| 5 | Fatbardha Kolgeci | 049 601 955 | [signature] | F |
| 6 | Mushin Nimani | 044897349 | [signature] | |
| 7 | [illegible] | 044-755-777 | [signature] | |
| 8 | ILIR HASANAJ | 044 354 252 | [signature] | M |
| 9 | BESA TALLA | 049-395-157 | [signature] | F |
| 10 | BLERTA HALIMI | 045 238 883 | [signature] | F |
| 11 | SHKODRAN BAJGORA | | [signature] | M |
| 12 | EGZON KRASNIQI | 044-661-001 | [signature] | M |
| 13 | Leart Trimballi | 049 705 001 | [signature] | M |
| 14 | BAJRAM KRASNIQI | 044 123 968 | [signature] | M |
| 15 | AVNI ZEKA | 044-692-696 | [signature] | |
| 16 | ISAK MENXHIQ | 044 237 935 | [signature] | |
| 17 | KADRI KRASNIQI | | [signature] | |
| 18 | GEZIM PACI | 044/799 534 | [signature] | |
| 19 | [illegible] ZEKA | 044 929 900 | [signature] | |
| 20 | [illegible] | 044 159 066 | [signature] | |
| 21 | Florian Shala | 049 634 413 | [signature] | |
| 22 | LIBERT [illegible] | | [signature] | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 14.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | ~~M~~/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AGRON HASANI | agronhasani@hotmail.com | | |
| 2 | DRITON NEZIRI | | | |
| 3 | Fidolim Zemeli | | | |
| 4 | Herta Manxhuka | herta.m.sh@gmail.com | | |
| 5 | KHEVAT RRAHMANI | | | |
| 6 | BUJAR ZEQIRI | BUJARQZEQIRI@gmail.com | | |
| 7 | RAGIP RUGOVA | ragiprugova@gmail.com | | M |
| 8 | FEHMI TOVERLANI | | | |
| 9 | [illegible] | | | |
| 10 | VISHA BAJRAI | | | |
| 11 | [illegible] Talla | 44/371109 | | |
| 12 | FATON HALIMI | 45 804580 | | M |
| 13 | Sabri Rexhepi | 045-316-447 | | |
| 14 | Muhamet Rexhepi | 044-622-281 | | M |
| 15 | Enis Kasumaj | 048-277-774 | | M |
| 16 | Visare [illegible] | 049 888288 | | M |
| 17 | Blerim Pacolli | 044-932-230 | | |
| 18 | Bahri Sejdiu | 044 600 502 | | |
| 19 | FISNIK ZEKA | 045534100 | | |
| 20 | DRITON ZHUSHI | | | |
| 21 | MILAZIM VEZIU | 044183106. | | |
| 22 | [illegible] | | | |
| 23 | NAZIFE GASHI | | | |
| 24 | [illegible] | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 14.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | ABDURAHMAN HAXHIJA | 044/307-643 | [signature] | M |
| 2 | ARDIAN GASHI | 044/555-531 | [signature] | M |
| 3 | NEXHAT ZEJNULLAHU | 044332 244 | [signature] | M |
| 4 | VETON KRASNIQI | 045-547-185 | [signature] | |
| 5 | AFRIM TOPLICI | 044 843 220 | | M |
| 6 | Agron Hamiti | 044111117 | [signature] | M |
| 7 | ILMI REKA | 044 105-471 | [signature] | M |
| 8 | Bujar Reka | 045-402-402 | [signature] | M |
| 9 | AFRIM GASHI | 049 958 603 | [signature] | M |
| 10 | ENI REKA | 044-335 735 | [signature] | M |
| 11 | Reis Gllogu | 049220024 | [signature] | |
| 12 | Sami Rrahmani | 049 339-933 | [signature] | M |
| 13 | Adi Berisha | 049-168-260 | [signature] | M |
| 14 | MUHAMET SADIKU | 046 189 289 | [signature] | M |
| 15 | Ardian Imeri | 049 187-334 | [signature] | M |
| 16 | Gentrit Menxhiqi | 049-191-101 | [signature] | |
| 17 | KASIM MENXHIQI | 044 239 410 | [signature] | |
| 18 | Ali Fe[illegible] | 044 900 946 | [signature] | |
| 19 | Cerqiz Lutolli | 044 809 118 | [signature] | |
| 20 | RAMADAN AHMETI | 044 417 773 | [signature] | M |
| 21 | ARSIM KRASNIQI | 049 88 89 83 | [signature] | M |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

KOMUNA E PRISHTINËS

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRIŠTINA

# HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

## RAPORT 6

TAKIMI ME QYTETARË

DATA, KOHA DHE VENDI:

**18 korrik**, në SHFMU "Shkëndija", duke filluar nga ora **16:30 - 18:00**

**PËRMBAJTJA**

1. QËLLIMI I TAKIMIT
2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM
3. PROCESVERBALI

## 1. QËLLIMI I TAKIMIT

Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Drejtorinë e Urbanizmit, kanë organizuar punëtori me qytetarët e Komunës së Prishtinës për të diskutuar me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartën Zonale.

## 2. LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIM

1. Përparim Rama - Kryetar i Komunës
2. Alban Zogaj - Nënkryetar i Komunës
3. Vllaznim Osmani - Shef i Kabinetit
4. Mimoza Sylejmani - Drejtore në Drejtorinë për Planifikim Strategjik
5. Arbër Sadiki - Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit
6. Granit Rugova - Drejtor në Drejtorinë e Sportit dhe Rinisë
7. Izet Sadiku - Drejtor në Drejtorinë e Shëndetësisë

## 3. PROCESVERBALI

MIMOZA SYLEJMANI-përshëndetje të gjithëve, faleminderit qe keni ardhë, sot me mua është Arbër Sadiki drejtor i Urbanizmit, dr. Izet Sadiku drejtor i Shëndetësisë, edhe kryetari na bashkangjitet shumë shpejt. Ne sot kemi ardhë me shumë me bisedu për problemet, shqetësimet e ankesat e juaja sesa me prezentu ndonjë projekt. Ju e dini qe Hajvalia nuk ka pasë plan rregullues asnjëherë, lejet qe janë marre, janë marre vetëm me plan zhvillimor urban, dhe komunal. Ne jemi ne fazën e hartimit te Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, jemi ne proces te punës andaj edhe jemi këtu, qe te ju ndëgjojmë juve, se ju me se miri i dini nevojat e juaja, dhe çdo informacion qe marrin ne nga ju, për ne është ndihme e madhe ne këtë rrugëtim. Kjo pjese ka me u pasuru shumë, do te ndërtohet këtu spitali i qytetit gjithashtu ne bisedime e sipër i tere blloku i ambasadave do vie ne këtë lagje. Pa humbur kohe ia jap fjalën drejtorit te Shëndetësisë z. Izet Sadikut dhe mandej Arbër Sadikit.

IZET SADIKU- përshëndetje për të gjithë ju, faleminderit qe keni ardhë siç e përmendi edhe Mimoza, zhvillimi i Prishtinës do te jete ne këtë pjesë. Kemi pasë shpresa edhe me herët por ka pas plane qe janë diskutu dhe nuk janë realizu, kemi pas pengesa dhe shpesh pronat tona kanë mbet peng i atyre planeve. Kryetari Rama e ka si prioritet zhvillimin e këtyre planeve të reja urbanistike, Hajvalia do te jete pjesa e Prishtinës se Re. Përveç objekteve qe janë te dedikuara ne pjesën e Hajvalisë shumica e Institucioneve Qeveritare do te jene ne këtë pjese, ju e keni pa që veç ka filluar ndërtimi i tyre. Ne jemi ne fazën e pare te hartimit te planit te fleksibilitetit te Spitalit te Prishtinës dhe propozimit qe e kemi

dhënë si Komunë, e qe do te shtrihet ne mes te Gjykatës dhe Burgut. Jemi ne fazën fillestare te propozimit te ri dhe qëllimi ynë ka qene qe me diskutu me ju, edhe për interesat e juaja si qytetar te Hajvalisë. Këto janë projekte madhore qe do te i detajizoj me hollësisht Arbëri dhe Kryetari kur te na bashkangjitet e ju mos hezitoni, ndjehuni te lire te na e thuani atë çka ju propozoni, çka ju shqetëson, ankesat te gjitha ,ky është takimi ynë i pare por s'do te jete i fundit, se ne do te takohemi edhe shumë here te tjera, ju faleminderit.

ARBËR SADIKI-përshëndetje, këtu jam ne cilësinë e drejtorit te Urbanizmit, besoj qe e dini qe Urbanizmi është departament qe e bënë implementimin e planeve, drejtoria e Planifikimit është bartëse e hartimit te planeve e drejtoria e Urbanizmit i implementon. Arsyeja pse ne jemi ne këto takime bashkë është se konsiderojmë qe një mase e madhe e planeve ekzistuese kanë shumë probleme ne implementim, dhe rishikimi i këtyre planeve parashihet edhe me ligjin e planifikimit hapësinor qe me u hartu Harta Zonale e re , mirëpo me shumë edhe përtej asaj qe e kërkon ligji për ti bërë këto plane te implementueshme. Ka zona ne Prishtinë qe ekzistojnë plane rregullative por janë problematike për me u implementu, për pjesën e juaj përveç pjesës se Prishtinës se re, plan rregullativ për pjesën tjetër te Hajvalisë nuk ka. Hajvalia është zhvillu përmes planit zhvillimor urban ku përcaktohen disa dispozita te përgjithshme te zhvillimit te zonës por jo edhe ato konkrete siç i parasheh një plan rregullativ ku përfshihen edhe rrugët e kategoritë e rrugëve. Është edhe moment i mirë për kryetarin Rama qe ne fillim te mandatit e ka mundësinë me i hartu planet sipas vizionit qe e ka paraparë për Prishtinën. U tha edhe me herët qe Hajvalia është penalizu si mungese e këtyre planeve ne një mënyrë ndoshta është edhe fat qe nuk ka pasë plane te cilat ma shumë kanë sjelle probleme ne zhvillim se qe kanë ba ndonjë zgjidhje. Ne sot këtu kemi ardhë me shumë me ju ndëgju juve edhe me marr informata nga ju për zonën e juaj qe këto plane me i ba te implementueshme dhe me benefit për vet qytetaret. Ndihuni te lire për çdo lloj ideje, kërkesë, ankese me e thane para nesh, se ju ndoshta e keni vërejt qe ne nuk jemi duke shkuar askund me propozime para se me i ndëgju fillimisht palët, pastaj ne baze te asaj se çfarë ndëgjojmë me fillu mandej me ngrit propozime e me hartu plane qe realisht i shërbejnë se pari njerëzve qe jetojnë aty. Prishtina nuk ka pas deri tash Hartë Zonale, si dokument i ri i planifikimit na jep mundësi me e planifiku Prishtinën ne tërësi. Dallimi i hartës zonale ne raport me planet rregullative qe kanë qene deri tash është se Harta zonale e përfshinë komplet kryeqytetin me rrethine. Kjo jep mundësi qe vizioni për qytetin me qene i integrum me qene i tille qe funksionon ne tërësi edhe mos me ekzistu me zona si p.sh me Hajvalinë tani ku pjese te qytetit kanë mbete pa fokus te caktuar, pa zhvillim ne mungese te një plani rregullativ. Ne problematikat ekzistuese i dijmë por po duam qe me i diskutu me ju, me vete qytetaret. Një problem qe i ka lënë shumë sende peng është edhe pjesa e unazës qe kalon ne pjesën e juaj, token qe ju e posedoni, edhe unaza është ne rishqyrtim, sepse është parapare edhe ne planin e 2006 edhe ne planin e 2013, kanë kaluar dekada prej asaj kohe. Ndryshimi i unazës do te jete ne përputhshmëri me zhvillimet ekzistuese. Gjithë parametrat e zhvillimit qe lidhen me koeficientin e ndërtimit, me shputën, me lartësinë e ndërtesave janë pjese e rishikimit, dhe kjo zone normal do te zhvillohet ne bashkëpunim me juve si posedues te tokave , dhe gjithmonë duke e mbajte një balanc ne mes te dendësisë qe do te zhvillojmë dhe kualitetit te jetesës. Ne konsiderojmë se duke u fokusuar vetëm ne koeficienta jashtëzakonisht te mëdhenj për pjese te caktuara te qytetit kanë rezultuar me probleme te mëdhaja qe i kemi sot ne qytet. Ne nuk po duam te bëjmë gabimet e njëjta sidomos ne pjesët e qytetit ku akoma ka mundësi me u planifiku mirë, Hajvalia e ka këtë mundësi. Ju e dini qe ka lagje qe ka qene toke dhe sot pas 20 viteve askush nuk dëshiron me jetu ne atë pjese, për shkak se nuk është planifiku mirë dhe nuk i plotëson as kushtet elementare. Ne nuk duam me e ba te njëjtin gabim ne pjesët ku akoma ka mundësi me u planifiku mirë. Këtu me ne është edhe drejtori i Sportit , besoj qe edhe ai ka me i thane disa fjale, ka pjese qe janë te dedikuara për sport, ka projekte konkrete, për çka do qe keni me e thane ju lutem thuajeni.

GRANIT RUGOVA –përshëndetje të gjithëve, unë jam Granit Rugova, drejtor ne Drejtorinë e Sportit, para se me fillu me pyetje dua ta ndaj një lajm me juve, Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Sport veçse e ka nda një parcele për ta bërë stadiumin e Hajvalisë, ku do t'i zhvillojnë stërvitjet tri ekipet e Hajvalisë, dy te meshkujve edhe një i femrave. Është për keqardhje qe ky komunitet i ka tri ekipe dhe nuk e kanë hapësirën e vet ku t'i zhvillojnë stërvitjet dhe ndeshjet. Besoj qe pasi te aprovohet buxheti, bartja nga niveli qendror shumë shpejt do te fillojmë me projektin dhe deri ne fund te vitit shumë shpejt komuniteti i Hajvalisë do ta këtë fushën e vet te futbollit. Një lajm tjetër i mirë është qe te këndi i lodrave do ta rrisim atë hapësirë do ta shtojmë edhe një kënd për fitnes, qe do te jete i përshtatshëm edhe për moshat me te vjetra edhe për fëmijë. Jemi te hapur për çfarëdo ideje apo kërkesë qe ka te bej me sportin, ju faleminderit.

ILIR GASHI-banor i lagjes- kryetar e kam një pyetje për unazën e tretë nëse mundesh me na sqaru pak a shumë meqë na kanë mbajt peng qe sa vite.

KRYETARI- se pari ju kërkoj falje qe u vonova pak, problem trafiku qe po mundohemi me e rregullu ,sa i përket unazës se tretë, nuk do te këtë unaze te tretë për arsye se unaza e mesme dhe unaza e trete kanë qene aq afër njëra tjetrës, edhe mbasi qe nuk janë bërë kur është dashtë me u ba, se ju e dini qe është projekt i vitit 2004 d.m.th.-në para 18 viteve. Përgjatë këtyre viteve ka pasur zhvillime te ndryshme dhe si rezultat e kemi rianalizu të gjithë procesin dhe për shkak te afërsisë, ne e kemi vetëm unazën e mesme. Çdo gjë qe është mbajt peng ne jemi duke i rianalizu, duke i zhvilluar rregulloret për zonat ku kalon unaza e mesme, për zonat qe kanë mbete te pazhvilluara, jemi duke e krijuar Planin zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale për këtë edhe jemi këtu, dhe ne raste specifike do te këtë edhe Plane rregullative. Ka me qene një zhvillim i mirëfilltë i Prishtinës, ne këtë rast po flas specifikisht për Hajvalinë. Problemet kyçe qe ende i kemi këtu , faktikisht kemi vendos me i zgjidh ne mënyrën e menjëhershme, është pikërisht edhe arsyeja pse e kemi zhvendos fokusin ne Hajvali dhe problemeve këtu. Problemet e ujërave te zeza, ne te njëjtën kohe me e zgjidh problemin e rrugëve, te qafores dhe mandej te shtimit te shtigjeve shtese te këmbësorëve, te çiklizëm, mandej edhe lirimi i qasjeve sa me te shpejta te Hajvalisë me zonat tjera te Prishtinës. Është një intervenim Strategjik qe i zgjidh shumë probleme për Hajvalinë ne te njëjtën kohe te i shfrytëzojmë ato fonde qe janë te dedikume prej Bankës Evropiane Për Zhvillim rreth 250 milion për krijimin e kësaj unaze te mesme, dhe paralelisht jemi edhe ne planifikim te koeficientit ne baze te zonave te ndryshme. Vetëm një gjë me ju shpjegu ne relacion me koeficientin, me statistika te vitit 2011-2012 thuhet se jemi rreth 198 mijë banore ne Komunën e Prishtinës por ne baze te matësve te rrymës e ujit jemi rreth 350 mijë, mirëpo ne baze te trendit te ngritjes mendohet qe deri ne vitin 2030 do te mbërrijmë ndoshta 400 mije ose 450 mije, e ne duhet me ju përshtat edhe trendit te koeficientit edhe rritjes. Ne mënyrën qysh është planifiku ne vitin 2004 apo vitin 2013 nuk janë bërë këto analiza te mirëfillta, dhe sipas atij planifikimi qe është rreth 54 milion metra katrore janë te parapara për një qytet me 1.2 milion njerëz. Nëse ne vazhdojmë me atë planifikim bëhet një kolaps total dhe plus nuk ka as treg për me ble. Për këtë arsye ne jemi duke e rishiku krejt kryeqytetin edhe me e ba një zhvillim te mirëfillte, se nuk do te thotë ne vetëm me ba ngritje te koeficienteve, e metrave katrorë kur s'kemi vlera dhe zhvillim te mirëfillte, rreth 15 000 mije banesa ne kryeqytet janë te zbrazëta, është një trend i rrezikshëm. Se bashku ne mundemi me e kriju këtë këtu, ne Hajvali qe me e kriju një jetese te mirë, qe edhe juve me ju ngrit vlera e tokës po edhe me u ngrit vlera shoqërore, për fëmijët tanë për gjeneratat me radhë.

NASER RAMADANI- banor i lagjes rr. Dëshmorët e Gollakut, lagjet qe veç kanë fillu me u ndërtu a janë brenda a jashtë Planit Zhvillimor.

KRYETARI-për fat te keq gjërat qysh janë zhvilluar deri tash, ne duhet me fillu me parametrat ekzistues edhe me vendos një kontroll një balanc te zhvillimit, neve na duhet një ekipe shumë shumë e madhe se realisht jemi duke punuar paralelisht me gjitha zonat e kryeqytetit, ideja është me e pasë saktë

gjendjen ekzistuese, sa njerëz jetojnë saktë, sa metra katrore i kemi ,dendësia, kah po shkojmë ne si trend, se është edhe rritja e popullsisë, te gjitha këto janë baze për një planifikim te mirëfillte. E kam përmend disa here qyteti i 7 minutave qe do te thotë qe brenda vendit ku ne jetojmë me e pas një jete te mirë, me pasë shkolle, qendër mjekësore familjare, qendra rekreative, kulturore, sportive, hapësira te gjelbëra, e te gjitha këto ia ngritin vlerën vendit ku jetojmë, pa pasë nevoje me mendu vetëm për koeficient.

XHAVIT FETAHAJ-banor i lagjes rr. Arbën Ukshini, ka prona te palegalizuara dhe infrastruktura është e pazhvillume, s'ka ndriçim, kanalizim, vërshojnë ujërat e zeza.

KRYETARI- ne jemi me një hov te shtuar me një ekipe te shtuar duke e shtyer përpara Planin komunal zhvillimor dhe hartat zonale qe me i parapri zhvillimeve, me kriju infrastrukturën qe mos me qene siç ka qene deri tash, qe është ndërtu por pa planifiku. Ne momentin qe ne i definojmë te gjitha këto, ne mendojmë me i ndërtu, por te gjitha normal ne bashkëpunim me qytetaret e atyre zonave, se bashku se qyteti është i yni.

VESEL GASHI-banor i lagjes rr. Minatori, pjesa ku jetoj unë nuk e di a jemi me Hajvalinë apo me Graçanicë, po du me dite a ka me hi pjesa jone ne këtë plan, e dyta, prej mbas lufte rruga nuk është shtruar me, po flas për nja 120 metra rruge, jemi rreth 200 shtëpi, prej 2013-tës kemi bërë kërkesë 2 here me mbi 100 nënshkrime, kemi problem me kanalizim, edhe me ujë.

KRYETARI-si strategji kyçe e kemi pasë edhe decentralizimin e sistemit qe mos me pasë nevoje me ardhë ne Komunë por çdo gjë, por me e kry përmes Bashkësisë Lokale, ne Hajvali veç e kemi hap, ideja është qe çdo ide apo kërkesë me e ba ju përmes Bashkësisë Lokale edhe ne si Komunë me i fut ne buxhet financat ne relacion me problemet e komunitetit.

IZET SADIKU-shumica e projekteve qe janë duke u zhvilluar janë projekte qe veç i kemi gjet si plan, por ne disa raste qe i kemi vërejt ne kemi intervenuar menjëherë, shumë shpejt kanë me fillu intervenimet edhe këtu, drejtori veç e ka dërgu stafin përgjegjës qe kanë dal ne terren, edhe deri ne fund te vitit këto rruge do te finalizohen.

ARBËR SADIKI-ne e kemi pas edhe një takim para 1 muaji me Drejtorin e Urbanizmit te Graçanicës pasi edhe ata janë në hartim të PZHK-së, këtë problem e kemi diskutuar se edhe ne kohën kur ka qenë Graçanica si fshat nuk janë përputhur kufinjtë e fshatit me kufinjtë kadastral, këtë problem e kemi edhe ne shumë zona te Prishtinës ku nuk përputhen kufinjtë kadastral me bashkësitë lokale. Planet qe jemi duke i bërë tani, ne i kemi përfshire komplet zonat kadastrale, edhe pse mundet mos me qene pjese e bashkësisë lokale, besojmë qe te gjitha këto kanë me u rregullu me këto hartat e reja, e qe është hapi i pare para se me fillu me e ba planifikimin e dedikimin funksional te hapësirave.

MILAZIM VITIA-e kam një pyetje, sa i përket Hajvalisë a keni ndonjë projekt te zhvillimit për përmirësim te infrastrukturës edhe dua ti bej disa kërkesa, shtëpi te kulturës na kanë premtuar, asgjë s'është bërë ne atë drejtim, kemi mungese te shportave te mbeturinave ne dy rrugët kryesore, te mbillen drunjë për freskim te ambientit, te bashkësia lokale rr. Bej Vitia deri aty është punuar kanalizimi dhe është ndërpre puna, ujërat kalojnë ka rruga jonë, gjithashtu për ambulanten e kemi një kërkesë qe ambulanta duhet me punu 24 orë, se ne për çdo rast duhet me shku në Prishtinë.

IZET SADIKU-ne kemi shumë plane e projekte por normal qe ju japim çdoherë përparësi projekteve qe janë ne urgjencë për qytetaret, për Hajvali sa i përket kërkesës se ambulantes do ta bëjmë një analize qe me e pa sa është numri i pacienteve, por ne Hajvali do te lokalizohet Urgjenca e Qytetit, mjekësia urgjente e qytetit i ka tri kujdestari gjatë natës 24 ore, dhe ne kemi propozuar qe një te lokalizohet ne

Hajvali qe do ta mbuloje edhe Matiqanin dhe një pjese te Bregut te Diellit, e do te realizohet ne vitin e ardhshëm.

KRYETARI-ma herët e përmenda idenë dhe misionin tim personal dhe te institucionit qe e përfaqësoj qe me kriju qytet 7 minutësh. Qyteti 7 minutësh e ka pikërisht ne baze ngritjen e vlerës shoqërore duke i krijuar mundësitë e secilit qytetar ne secilën pjese te Prishtinës me i pas te gjitha këto funksione për 7 minuta, o ne këmbë , o me veture, o me trafik urban. Kjo është ideja qe jemi duke e rishiku krejt kryeqytetin ne këtë rast Hajvalinë te cilën veç e kemi vendos ne aspektin e urgjencës. Këtu po e ndërlidhi edhe sistemin e rrugëve, unaza e mesme ndërlidhja e rrugëve kryesore me unazën e brendshme edhe me pika kyçe brenda qytetit qe me pas një qasje shumë te mirë, te shpejte e te lehte ne rast urgjencë. Ne baze te analizave e dijmë qe një numër i madh i qytetareve qe jetojnë ne këtë zone duhet me e pas një pike te urgjencës mjekësore dhe këtë e kemi ne plan për ta bërë. A s ai përket shportave duhet te bëjmë një analize dhe vijmë me një përgjigje, unë po ju la juve si komunitet me e marr një vendim e bëni si projekt propozim përmes bashkësisë lokale dhe ne e marrim dhe e caktojmë sa është financimi dhe e financojmë. Ju lutem bënë propozimin.

NASER RAMADANI-Unë e kam biznesin dhe i kam 2 kontejnerë te mëdhenj por kontejnerët e mi mbushen nga qytetaret, kështu qe unë ndodh i thërras me ardhë extra me mi zbraze kontejnerët, fshati ka nevoje për kontejnerë te mëdhenj shtese, e zgjidhni një vend ku mundeni me i vendos.

KRYETARI-jemi duke e rishiku edhe një mundësi te një platforme paralele për mbeturina, qysh me e ba riciklimin e mbeturinave. Ne Maqedoni veç është duke e bërë një kompani riciklimin e tyre dhe krijimin e energjisë nga ky riciklim. Është edhe pak komplekse kjo puna e mbeturinave se është një proces qe jemi duke u mundu me ja gjetë zgjidhjen, edhe ne vetëdijesimin e qytetareve, edhe ne krijimin e mundësive me praktike te mbledhjes e te gjitha këto.

ILMI BERISHA- banor i lagjes rr. Brigada 153, Hajvalia është anashkaluar ne zhvillim, trafiku është kaos, mungon shumëçka këtu, infrastruktura tmerr, pa kanalizim, rrugët periferike te pa shtruara, jemi rreth 15 mije banor ndoshta edhe me shumë dhe se kemi një Shtëpi te kulturës.

VULLNET BERISHA- kam një pyetje për lagjen Ulpiana e Re, ka rruge qe janë shtruar ende pa u ndërtuar shtëpitë a ka dalje apo jo s'di, dhe deshta me e dite kanë mbete 2 rruge te pashtruara këtu te ne (rr. Ilmi Bajrami) , ka qene projekti por nuk është bërë asgjë.

REMZI PACOLLI-banor i lagjes rr. Tepelena, ujërat e zeza derdhen ne oborr te shtëpive privatë ,rr. Oda ti keni parasysh ne Planin Zhvillimor Komunal.

MASAR DUSHI-kryetar i Asociacionit te Arkitekteve-lagjja Hajvalia do te jete lagje shumë interesante dhe atraktive, spitali, stadiumi , ambasadat qe do te jene te lokalizuara ne këtë pjese e bëjnë me atraktive. Kryetari veç e përmendi qe i mungon kadastri , punë ka shumë por është investuar pak. Nisma është shumë e mirë me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale do te trajtohen dhe zgjidhen shumë probleme, është ekipe shumë e madhe qe po mirret me këtë, kërkon kohe e diskutime por sa ma shumë te diskutohet e debatohet rreth tyre rezultati veç me i mirë do të jetë, për ne si qytetar dhe për institucionet qe do e implementojnë.

ARBËN VITIA-e kam një kërkesë qe te bëhen pritore nëpër stacione te autobusëve, për shkak se vetëm tek ne mungojnë, dhe ne si banor te kësaj pjese na shkakton bajagi problem nëpër stinët e vitit, edhe kur bie shi e kur është ftohte, edhe kur është shumë vape, edhe një stacion duhet me u identifiku me pritore dhe tabela e rrethoje.

KRYETARI- deri tani ka qene problem kontrata me operatorin, tani e kemi zgjidh problemin, i kemi propozu 3 lloje te pritoreve, qe do te ndahen sipas zonave, shumë shpejt do te jemi me pritore te reja.

SKENDER VITIA- a keni ndonjë projekt, se ka qene një prej unazës se mesme, përmes liqenit ne anën e kundërt përmes Zllatarit me u lidh me unazën e jashtme qe i bie për Magure qe gjithë ajo pjese qe vjen prej fshatrave te Gollakut ka me pas qasje me te lehte për me ardhë ne qytet, p.sh ne për Gjilan kemi shumë problem rrugës , e për ne si qytetar është shumë me rëndësi me u ba një lidhje qe prej Zllatarit me dal drejt ne Mramor, nëse keni mundësi me e ba projektin, se e hap një mundësi.

KRYETARI-deri ne fund te muajit duhet me u rrumbullakesu projekti i unazës se mesme qe do te jete 120 dite ne diskutim publik ku edhe do te kemi mundësi ne mënyrë te drejtpërdrejtë me projekt me diskutu.

DARDAN BRAHIMI- Hajvalia ka shumë probleme, unë kisha pas dëshirë qe me e diskutu çështjen e sigurisë publike. Hajvalia ka nevoje për një stacion policor dhe mendoj qe është çështje prioritare.

KRYEATRI- do te marrim ne konsiderim, është çështje qe duhet te diskutohet me organet e policisë, por nga ana jone për me e ofru mundësi te hapësirës, te ndërtesës gjithsesi qe mundemi me e ba.

SELIM PACOLLI- faleminderit shumë qe keni ardhë, unë i ndëgjova bashkëqytetaret e mi, janë probleme qe kanë qene edhe me herët sa kam qene edhe vet nënkryetar, nuk po du me hy ne çështjen e unazës se është projekt qe sa por është një projekt ideor sa ka qene Isa Mustafa, vetëm iniciative ka qene ne 2008-tën qe e ceki edhe z. Vitia qe nga qafa e Zllatarit te lidhet unaza, që kish me qene shumë me e lehte qasja dhe kish me e liru dukshëm trafikun. U përmenden pritoret, janë 17 pritore nga këtu deri te kolektori, janë pa ulëse pa strehim te anshëm. Është inicu çështja e Shtëpisë se Kulturës, është marr parcela mirëpo nuk kemi arrite ta finalizojmë, është kërkesa, parcela afër qe është mendu për çerdhe, kopsht për fëmijë dhe për shkak te pozicionit është pak rrezik për fëmijët dhe aty mund te bëhet Stacioni Policor. Ne kohë sa kam qene nënkryetar fshati Hajvalia nuk ka pas klub publik te futbollit, ne veri te fshatit është parcela qe është parapare për stadium , dhe për qendër stërvitore, gjithashtu janë planifikuar 2 kolektorë, po shpresoj zoti Kryetar qe do te realizohen te gjitha këto, nëse ju duhet do te keni mbështetjen time gjithmonë, ju dëshiroj punë te mbare.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 18.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | LUTFI BERISHA | 044-265-064 | [signature] | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |
| 6 | | | | |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 18.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Vesel Gashi | 045 377247 | [illegible] | |
| 2 | Ilmi [illegible] | 044805021 | [illegible] | |
| 3 | Valmir Berisha | valmir_34 @hotmail.[illegible] | [illegible] | |
| 4 | Vullmet Berisha | – | [illegible] | |
| 5 | [illegible] Dashi | " | [illegible] | M |
| 6 | | | | |
| 7 | ARBEN VITIJA | 045908423 | [illegible] | |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 18.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | [illegible] | | [illegible] | |
| 2 | LIRIDON GAJTANI | 049-606-246 | [illegible] | |
| 3 | [illegible] | 044 402 872 | [illegible] | |
| 4 | NASER BERISHA | 044-860-146 | [illegible] | |
| 5 | [illegible] | 044-149-044 | [illegible] | |
| 6 | IDRIZ Copani | 048-999-102 | [illegible] | |
| 7 | LEUTRIM Sopjani | | [illegible] | |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

## Lista e pjesëmarrësve

**Tema:** Problematikat e lagjes
Datë: 18.07.2022

| Nr | Emri dhe Mbiemri | E-mail dhe tel. | Nënshkrimi | M/F |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Naser Ramadani | naseramadani@h... | [illegible] | M |
| 2 | BEKIM AJETI | bekimajeti.81@... | [illegible] | M |
| 3 | AVDULLA DEMI[illegible] | | [illegible] | |
| 4 | Burim [illegible] | burim-k@live.com | [illegible] | M |
| 5 | XHAVIT FETAHAJ | xhavitfetahaj@gmail.com | 044/539-244 | M |
| 6 | HALIM DEMIRI | Halim Demiri | 044 556-617 | |
| 7 | FATMIR DEMIRI | [illegible] | 045 [illegible]5670 | |
| 8 | FADIL JASHARI | [illegible] | 044 150514 | |
| 9 | Ramzi Pacolli | pacolli.r@hotmail.com | [illegible] | M |
| 10 | NAZIM VITIJA | | 044 611 593 | |
| 11 | BEKIM GASHI | Bekim.gashi@[illegible] | 045 401013 | M |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |
| 28 | | | | |
| 29 | | | | |
| 30 | | | | |
| 31 | | | | |
| 32 | | | | |
| 33 | | | | |
| 34 | | | | |